

Koha

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3203 • E martë 24 tetor 2017 15 DEN



Në 25 vjeç i japim fund shkollimit

Shkup, 23 tetor - Pjesa më e madhe e atyre që arsimohen në Maqedoni janë të rinj të moshës deri 25 vjeç. Pas kësaj, duket se nuk ka një motiv edhe shumë të fortë për të vijuar me shkollimin (pas studimeve ose masterit) apo për të ndjekur trajnime të kohëpaskohshme

përgjatë gjithë jetës. Mbi 87 për qind e të shkolluarve, e mbyllin këtë kapitull në çerekun e parë të jetës së tyre, e shumta me përfundimin e studimeve universitare, të cilat nëse ndiqen pa ndërprerje dhe përfundojnë në moshën 23 vjeçare. Këtu nuk llogaritet kategoria

e atyre që vazhdojnë studimet njëvjeçare të masterit profesional dhe dyvjeçare të masterit shkencor. Në rastet kur studentët që mbyllin ciklin deridiplomik, vazhdojnë menjëherë magistraturën dhe kanë mundësi të kapin moshën rekord të përfundimit... **Faqe 2**

Mbi gjysma e popullatës në Maqedoni janë të varfër

Ta kalosh ditën me 50 denarë!



Të dhënat e fundit të ESHS-së tregojnë se 51 për qind e popullatës në Maqedoni jetojnë në varfëri të plotë, një anëtar i një familje katër anëtarëshe me një të punësuar mbahet gjallë me më pak se 100 denarë në ditë, ndërsa një anëtar i një familje prej katër anëtarësh më asistencë sociale mujore prej 6000 denarësh në muaj e mbijeton ditën me më pak se një euro apo 50 denarë **FAQE 6**

Fushatat vetëm në maqedonisht



Shkup, 23 tetor - Fushatat senzibilizuese të Këshillit Republikan për Siguri në Komunikacion, vazhdojnë të realizohen vetëm në gjuhën maqedonase. Kjo mënyrë e ngritjes së vetëdijes qytetare për respektimin e rregullave të komunikacionit, siç mund të shihet nga organizimet e KRSK-së, bëhet në kohë

kur viktimat dhe të lënduarit nga aksidentet në komunikacion vijnë nga shtresat e ndryshme të popullatës. Shpejtësia e madhe nga njëra anë dhe kalimi i rrugëve nga qytetarët në vendet e pashënjestruara nga ana tjetër, sipas hulumtimeve të KRSK-së, janë arsyt më të shpeshta se pse ndodhin aksiden-

te në komunikacionin rrugor, një pjesë e të cilëve me pasojë të kobshme. Ndonëse kanë mbetur edhe disa muaj deri në përfundim të këtij viti, numri i viktimave që kanë humbur jetët nëpër asket rrugore të Maqedonisë ka arritur deri në 91 të vdekur. Në kuadër të raporteve ditor, të cilat i publikon... **FAQE 5**

RAJON

Kush me kë shkon në balotazh dhe kush fitoi garën?



Në bazë të rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të publikuara online, mund të dihet tashmë se shumica e komunave të mëdha do të shkojnë në balotazh për zgjedhjen e kryetarëve të rinj. Derisa, në disa komuna... **FAQE 14**

RAJON

Fituesi i zgjedhjeve kundër refugjatëve

FAQE 15

KULTURË

Hungaria nderon Mbretëreshën Geraldinë

FAQE 18

DOSSIER

Kampioni i demokracisë



FAQE 16



Grupi i katërt që përfshin moshën nga 55 deri 64 vjeç (261.577 persona) ka në proces arsimi 14.055 veta dhe që përbën 5.4 për qind të grup moshës së vet dhe rreth 9 për qind të gjithë atyre që janë në proces të shkollimit

Pjesa dërmuese e popullatës në Maqedoni mbyllin kapitullin e arsimit dhe trajnimit të tyre në moshën 24 vjeçare. Në kategorinë e personave nga 25 deri 64 vjeç dhe që është 1.180.558 banorë, vetëm 150.111 ose 12.7 për qind janë duke u shkolluar ose duke ndjekur ndonjë program trajnimi. Por edhe brenda kësaj kategorie dallohen tendenca të ndryshme sa u takon grupmoshave të ndryshme. Ndërkaq, ende më i thellë është hendeku mes atyre që jetojnë në zona urbane dhe rurale, edhe atë 76.5 për qind kundrejt 23.5 për qind

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 23 tetor - Pjesa më e madhe e atyre që arsimohen në Maqedoni janë të rinj të moshës deri 25 vjeç. Pas kësaj, duket se nuk ka një motiv edhe shumë të fortë për të vijuar me shkollimin (pas studimeve ose masterit) apo për të ndjekur trajnime të kohëpaskohshme përgjatë gjithë jetës. Mbi 87 për qind e të shkolluarve, e mbyllin këtë kapitull në çerekun e parë të jetës së tyre, e shumta me përfundimin e studimeve universitare, të cilat nëse ndiqen pa ndërprerje dhe përfundojnë në moshën 23 vjeçare. Këtu nuk llogaritet kategoritë e atyre që vazhdojnë studimet njëvjeçare të masterit profesional dhe dyvjeçare të masterit shkencor. Në rastet kur studentët që mbyllin ciklin deridiplomik, vazhdojnë menjëherë magistraturën dhe kanë mundësi të kapin moshën rekord të përfundimit të studimeve me master 4+1 apo 3+2 në moshën 25 vjeç.

Shkollimi i përzgjedhëm, që në vendet e Bashkimit Evropian, është kthyer në model jetese për një pjesë të konsiderueshme të popullatës që jeton atje, nuk është bërë sa duhet popullor edhe në Maqedoni. Nga 1.180.558 banorë sa llogaritet të jetë popullata nga 25 deri 64 vjeç, vetëm 150.111 janë në proces të shkollimit ose ndjekin programe trajnimi dhe specializimi në profesionin që ushtrojnë. Pra, vetëm 12.7 për qind e kësaj popullete shkollohet në Maqedoni, sipas të dhënave për strukturën shkollorë të popullatës në vitin 2016, përdërisa 1.030.447 ose 87.3 për qind nuk kishin të bënin fare me procesin e mësimin. Madje, të dhënat e Entit Shtetëror të Statistikave tregojnë trendin e rënies së intensitetit të këtij shkollimit me rritjen e moshës. Kështu, brenda kategorisë së popullatës në proces të shkollimit (150.111) thuhet gjysma e tyre janë nga 25 deri 34 vjeç, ndërsa me të shkuar më pas në moshë kjo përqindje zbrit

Arsimi në moshë të rritur vetëm për 13 për qind të popullatës

Në 25 vjeç i japim fund shkollimit



POPULLATA 25-64 VJEÇ	ARSIMOHEN/TRAJNOHEN	NUK ARSIMOHEN/NUK TRAJNOHEN
1.180.558	150.111 (12.7%)	1.030.447 (87.3%)
MJEDIS URBAN 653.019	114.784	538.235
25-64 vjet (55.3%)	17.6% e pop.urbane	82.4% e pop.urbane
	76.5% që ars./trajn	52.2% që nuk ars./trajn
MJEDIS RURAL (527.539)	35.327	492.212
25-64 vjet (44.7%)	6.7% e pop.rurale	93.3% e pop.rurale
	23.5% që ars./trajn	47.8% që nuk ars./trajn

VITET	POPULLATA	SHKOLLOHEN
(25-34)	324.820	67.046 (20.6% e grup moshës) ose 44.7% e atyre që janë në proces
(35-44)	306.714	41.993 (13.7% e grup moshës) ose 28% e atyre që janë në proces
(45-54)	287.447	27.018 (9.4% e grup moshës) ose 18% e atyre që janë në proces
(55-64)	261.577	14.055 (5.4% e grup moshës) ose 9% e atyre që janë në proces

në rreth 30, 20 apo deri rreth 10 për qind të grupmosha e fundit.

Ekspertët e lidhin këtë situatë me gjasat që shohin njerëzit të tregu i punës varësisht moshës që ata përfaqësojnë, ndërsa ende më i thellë është hendeku i popullatës në proces shkollimi parë sipas mjedisi ku ata jetojnë. Konkretisht, ka një epërsi të madhe të personave që jetojnë në zonat urbane sa i përket përfshirjes në proces në vazhdueshëm shkollimi, çdo herë në kategorinë e atyre që janë nga 25 deri 64 vjeç. Kështu, nga 150.111 që janë në proces të shkollimit, 114.784 ose 76.5 për qind jetojnë në mjedise urbane, kurse 35.237

ose 23 për qind në mjedise rurale. Ndërkaq, nëse popullata urbane (653.019) përbën 55.3 për qind të popullatës së përgjithshme të moshës nga 25-64 vjeç, në proces të arsimimit apo trajnimit janë të përfshirë 17.6 për qind e llojit të vet. Ndërkaq te popullata rurale (527.539) e cila përbën 44.7 për qind të popullatës së përgjithshme të moshës nga 25-64 vjeç, në proces të arsimimit apo trajnimit janë të përfshirë vetëm 6.7 për qind e llojit të vet, pra të popullsisë rurale.

Në kategoritë e ndërprerjes së popullatës nga 25 deri 64 vjeç, e cila gjendet në ndonjë nivel të caktuar shkollimi apo është në proces të

trajnimit, specializimit, e kështu me radhë, përqindjen më të madhe e bën grupi i moshën nga 25 deri 34 vjeç. Në numrin e përgjithshëm të popullatës në këtë moshë janë 324.820 persona. Prej tyre, 67.046 pra 20.6 për qind e asaj grup moshe janë duke ndjekur ndonjë shkollë të caktuar. E krahasuar me numrin e atyre që janë në proces arsimimi (150.111) i bie që gati gjysma e tyre ose më saktë 44.7 për qind të jenë të moshës nga 25 deri 34 vjeç. Te grupmosha nga 35 deri 44 vjet (306.714 persona) në proces arsimimi janë 41.993 veta, pra 13.7 për qind e grup moshës dhe 28 për qind e atyre që përgjithësisht anë në proces shkollim. Grupmosha nga 45 deri 54 vjeç (287.447 persona) ka në proces arsimimi 27.018 veta, konkretisht 9.4 për qind të grup moshës së vet dhe 18 për qind të atyre që janë në proces shkollim. Grupi i katërt që përfshin moshën nga 55 deri 64 vjeç (261.577 persona) ka në proces arsimi 14.055 veta dhe që përbën 5.4 për qind të grup moshës së vet dhe rreth 9 për qind të gjithë atyre që janë në proces të shkollimit.

Bullgaria dhe Greqia do t'i ndihmojnë Shkupit në zbatimin e reformave

Sofje, 23 tetor - Bullgaria dhe Greqia janë të gatshëm t'i ndihmojnë Maqedonisë për zbatimin e reformave për fillimin e negociatave për anëtarësim në BE, deklaroi zëvendës kryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme e Bullgarisë, Ekaterina Zaharieva. "Në fillim nevojitet të ndërtohet besim ndërmjet udhëheqësive politike. Ata kanë rrugë të gjatë para tyre dhe shumë reforma për të zbatuar para se të fillojnë negociatat për anëtarësim në BE. Biseduam me Greqinë dhe jemi të gatshëm të dërgojmë ekspertë për të ndihmuar Qeverinë të zbatojë reformat e detyrueshme", tha Zaharieva në intervistë për radion bullgare "Darik". Sipas saj, pengesë për pranimin e Maqedonisë në BE ishte "Politika e vendit që është kundër fqinjëve të vet, kundër Bullgarisë, kundër Greqisë". "Mbajtja e qëndrimit 'ne jemi më të mëdhenjtë' nuk ndihmon. Qytetarët e Maqedonisë duan të jenë të integruar. Ajo është një nga arsyet pse ende nuk janë filluar negociatat. Nuk ekziston mundësi që shtetet evropiane të pajtohen me politikë të tillë", tha Zaharieva. Ajo vlerësoi se Qeveria e re e Maqedonisë ka plan shumë të qartë për reformat dhe mendohet se shpejti të mbahet seancë e përbashkët e qeverive të Maqedonisë dhe Bullgarisë.

Pacientja më e vjetër që ka caktuar termin shëndetësor është 106-vjeçe

Shkup, 23 tetor - Pacientë të moshës 100 vjeçare kanë termin të caktuar në kontrollime mjekësore, tregon sistemi elektronik për caktim "Termini im". Sipas të dhënave të këtij sistemi, për momentin 18 pacientë të cilët kanë mbi 100 vjet, kanë udhëzime aktiv për kontrollim. "Pacienti më i vjetër që është regjistruar në sistemin "Termini Im" është një grua nga Shkupi e cila ka 106 vjet, dhe sipas sistemit ka qenë në kontrollime në periudhën qershor-shtator", thonë nga Ministria e Shëndetësisë. Pjesë e pacientëve të cilët tre muajt e fundit kanë pasur termin për kontroll ankohen se nuk kanë mundur të kontrollohen ose kanë pritur me orë të tëra për kontroll, sepse edhe pse kanë arritur në kohë në terminin e caktuar, nuk ka ardhur mjeku ose është vonuar shumë. Sipas të dhënave të kompetentëve, tre muajt e fundit 948 mjekë kanë paraqitur se nuk do të mund të shkojnë në ambulancë dhe të kontrollojnë pacientët. Nga Ministria e Shëndetësisë thonë se problem paraqesin edhe ata pacientë të cilët kanë termin të caktuar, por nuk paraqiten në mjek, dhe nuk e anulojnë terminin. "Sipas të dhënave të "Termini Im" më së shumti kontrollime të lëshuara ka në spitalin e përgjithshëm "8 Shtatori", në klinikën e Tetovës si dhe në Klinikën për Onkologji dhe radioterapi. 135 pacientë mbi 10 herë nuk kanë shkuar në terminin e caktuar", thonë nga Ministria e Shëndetësisë.

MBI 1.5 MILIONË QYTETARË SHFRYTËZOJNË INTERNET, NJË MILION FEJSBUK

Në Maqedoni internet shfrytëzojnë 1.503.000 njerëz apo 72.2 për qind e popullatës, ndërsa një milionë janë të kycur në rrjetin social Fejsbuk, tregojnë të dhënat e ueb sajtit të specializuar "Internet World Stat". Nga vendet e rajonit, më shumë se qytetarët e Maqedonisë përdorin internetin në Slloveni (75.5 për qind) dhe në Kroaci (74.4 për qind). Pas Maqedonisë renditen Mali i Zi (69.9 për qind), BeH (69.3), Greqia (69.1), Serbia (67.1), Shqipëria (66.4) dhe Bullgaria (59.8 për qind). Në Evropë, internet përdorin 659.6 milionë njerëz, ndërsa Fejsbuk 343.2 milionë. Rrjeti global onlajn më shumë përdoret në Islandë dhe në Norvegji, pothuajse 100 për qind e banorëve, kurse më pak përdoret të internetit ka në Ukrainë 52.5 për qind. Sipas Internet "World Stat", në botë ka 3.88 miliardë përdorues të internetit, ose 51.7 për qind e popullsisë së përgjithshme të botës, ndërsa 1.7 miliardë njerëz kanë profile në Fejsbuk.



Osmani në Paris

Presim hapa konkret nga BE dhe NATO

Paris, 23 tetor - Zëvendëskryetari i Qeverisë së Maqedonisë, përgjegjës për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, në kuadër të vizitës së tij në Paris, realizoi takim me ministren për Çështje Evropiane pranë Ministrisë për Evropë dhe Punë të Jashtme të Francës, Natali Loazo. Në takim, zëvendëskryeministri Osmani dhe ministrja Loazo diskutuan për procesin e integritetit euroatlantike të vendit, si dhe për bashkëpunimin bilateral mes dy vendeve. Osmani informoi Loazon për rrjedhën e zbatimit të Planit 3-6-9 dhe theksoi se implementimi i pjesës së parë të Planit - pjesa 3 është në fund të realizimit, në të cilën më shumë se 80% e masave tani më janë realizuar, ndërsa për 20% tjetër ende punohet. Ai shtoi se zgjedhjet kredibile lokale paraqesin kurorë të pjesës 3 nga Plani 3-6-9, dhe duke i pasur parasysh vlerësimet të cilat për zgjedhjet nga ana e OSBE/ODHIR, që u konfirmuan edhe nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shkup, kishim kushte të drejta garuese, ditë të qetë zgjedhore, gjë që presim të realizohen edhe në rrethin e dytë të zgjedhjeve. Osmani theksoi se me realizimin e pengesave të shumta të cilat qëndrojnë në rrugën e Republikës së Maqedonisë në rrugën e integritetit evropiane, si që janë Marrëveshja për fqinjësi

të mirë me Bullgarinë, propozim ligji i ri për shfrytëzimin e gjuhëve, si dhe fillimi me masat për ndërtimin e besimit me Republikën e Greqisë. Me të cilën, theksoi Osmani, Qeveria vërtetoi përkushtueshmërinë e sajë deklarative drejt integritetit evropiane dhe euroatlantike, dhe për të cilën mori mbështetje të qartë nga qytetarët në zgjedhjet të cilat janë në vazhdim. Zëvendëskryeministri Osmani shprehu kënaqësinë e tij nga bashkëpunimi i deritanishëm nga Franca për integritetin e vendit në BE dhe NATO, si dhe rrolin pozitiv të vendit në integritetin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. "Në përputhje me zbatimin e suksesshëm të detyrimeve nga ana e Republikës së Maqedonisë, pres edhe hapa konkrete nga Bashkimit Evropian, si dhe nga vendet anëtare të unionit, të cilat do të ishin në drejtim të përfundimit të perspektivave evropiane të Maqedonisë dhe dukshmërisë së progresit drejt BE-së dhe NATO-s", theksoi Osmani. Ai përsëriti ambicidet e Qeverisë, deri në fund të vitit, në Samitin e dhjetorit, të hiqet rekomandimi i kushtëzuar, më tej Raport pozitiv dhe rekomandim të pastër nga ana e Komisionit në Prill, vitin e ardhshëm, si dhe marrjen e datës për fillimin e negociatave deri në fund të vitit të ardhshëm.

Shumica e padive të VMRO-së kishin të bënin me kërkesën për përsëritje të votimeve, nga shkaku se siç pretendonte ajo, nuk përputhet numri i votave në kutitë e votimeve me numrin e personave që janë evidentuar si votues në Listën zgjedhore në vendvotime të caktuara

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 23 tetor - Të hënën Gjykata Administrative në seancë publike ka shqyrtuar 10 padi, nëntë nga VMRO-DPMNE dhe një nga Aleanca për Shqiptarët të parashtruara nga këto parti kundër vendimeve të Komisionit Shtetëror Zgjedhor për rrethin e parë të zgjedhjeve lokale që u mbajtën më 15 tetor. Shumica e padive të VMRO-së kishin të bënin me kërkesën për përsëritje të votimeve, nga shkaku se nuk përputhet numri i votave në kutitë e votimeve me numrin e personave që janë evidentuar si votues në Listën zgjedhore në vendvotime të caktuara. Njëjtë si seancat tjera, dhe në dy seance e ditës së hënë njëri nga pesë këshillat gjyqësor të caktuara enkas nga Gjykata Administrative për lëndët që kanë të bëjnë ankimimet zgjedhore, shqyrtoi paditë e VMRO-së - njëra për vendvotimin numër 2806/1 në kutinë për kandidatët për kryetar të Komunës Qendër, e ku pretendohet se nga 351 fletëvotime më shumë të kryetarit të Komisionit, në kutitë e votimeve është evidentuar një më shumë - 352 fletëvotime, tjetra seancë kishte të bëjë me votimin nr. 2461/1 në Komunën e Sarajit, ku gjithnjë sipas pretendimeve të VMRO-së, në kutitë e votimit për Këshilltar komu-

Të hënën u shqyrtuan dhjetë padi tjera nga partitë politike

VMRO me shpresë të Gjykata Administrative



nal janë evidentuar 597 vota, ndërkaq kryetari i Komisionit ka volorur 596 fletëvotime. Ndërkaq në padinë e partisë Aleanca për Shqiptarët që u shqyrtua nga Këshilli Gjyqësor kishte të bënte me vendvotimin nr. 0387/1 në Komunën e Gostivarit, ku sipas pretendimeve të kësaj partie që ka kërkuar përsëritjen e votimeve në këtë vendvotim, një personi nga ana e nënkryetarit të Komisionit i janë dhënë dy fletëvotime për këshilltarë e jo sipas rregullave ligjore, njëra duhej të merrej për këshilltar dhe tjetra për kryetar. Këshilli gjyqësor i përbërë prej pesë gjyqtarëve, u tërhoq për të marrë vendime, por siç tha kryetarja e këtij Këshilli, Diturije Elezi Neziri, vendimet do të bëhen publike gjatë orëve në vazhdim të ditës së hënë. Sipas përfaqësuesit ligjor të VMRO-së, Alen Dereban, parregullsitë janë evidente dhe gjyqtarët, siç tha ia, nëse

do të vendosin sipas ligjit - presin që ato të jenë pozitive për këtë parti. "Shumica e padive kanë të bëjnë me parregullsi të procesit të votimit, konkretisht mospërputhja e numrit të votave të numëruara me fletëvotimet e nënshkruara nga komisionerët, gjë që automatikisht paraqet shkelje të Kodit Zgjedhor. Presim përgjigje pozitive për përsëritje të votimeve. Nëse Gjyqtarët do të shikojnë çfarë thotë Ligji, nuk duhet të mendohen shumë dhe të vendosin pozitivisht ndaj padive tona", tha për mediat Dereban. Në të njëjtën vijë me të ishte edhe deputetja e VMRO-së, Nevenka Stamenkovska. Ajo, në një prononcim të shkurtër për gazetën KOHA, thotë se "procesin ankimor nuk duhet të kalojë si farsë ashtu siç kaloi në KSHZ, meqë faktet janë evidente dhe prandaj presim me interes çfarë do të vendos Gjykata", tha Stamenkovska. Në pyetjen e gazetës

KOHA se në cilat prej 24 padive kanë fakte më të forta e që nuk do të mund të shmangeshin gjykatësit, ajo tha shkurt se "të gjitha paditë kanë të bëjnë me shkelje konkrete të ligjit zgjedhor e që KSHZ fatkeqësisht nuk i mori parasysh". Ndryshe nga përfaqësuesit ligjor të VMRO-së që ishin prezent gjatë shqyrtimit publik, përfaqësues ligjor i Aleancës për Shqiptarët, Xhezmi Selimi, nuk ishte prezent gjatë shqyrtimit të padisë nga kjo parti. Të dielën, pesë këshilla gjyqësore të Gjykatës Administrative shqyrtuan gjithsej 19 padi tjera, 16 nga VMRO-DPMNE, 2 nga TMRO dhe 1 nga E MAJTA, por që vendimet nuk u bënë publike në faqen elektronike të Gjykatës as të hënën deri në orën 16. Përbërja e Këshillave Gjyqësor vendoset sipas shortit, ndërsa seancat - bazuar në ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor, janë publike.

Zaev për dilemat e fundit pas koalicionit ASH-BESA

Vazhdojmë me BDI-në, të hapur për bashkëpunim me të gjithë

"Nuk ka pasur takim të hapur, debat, dilema apo çfarëdo qoftë, nëse Aleanca del ose jo. Gjithsesi, është e drejtë e Aleancës si do të vendosin ata. Unë pres që koalicioni qeveritar do të qëndroj dhe do të vazhdoj ta përforcohet në periudhën që vjen. Por jam i bindur se shumica parlamentare është stabile dhe kjo do të rritet", deklaroi Zaevi



Shkup 23 tetor - Kryeministri Zoran Zaev pret që koalicioni qeveritar të qëndroj edhe pas zgjedhjeve lokale, ndërsa shumica parlamentare të mbetet stabile dhe të rritet. Thotë se është i hapur për bashkëpunim me të gjithë, përfshirë edhe me individë

nga VMRO-DPMNE-ja opozitare, në interes të qytetarëve dhe të shtetit. "Vazhdojmë së bashku me BDI-në, i mbështesim kandidatët e BDI-së dhe besojmë se kjo do të jetë më e mira për qytetarët e Maqedonisë", deklaroi Zaev gjatë vizitës të hënën në Draçevë. Për koalicionin e Aleancës për Shqiptarët të Zijadin Selës dhe BESËN e Bilall Kasamit për raundin e dytë dhe nëse rigrupimi do të thotë edhe dalje të saj nga Qeveria pas 29 tetorit,

Zaev tha se kjo është e drejtë legjitime, sepse ka kundër kandidat nga BDI-ja në Gostivar dhe në Strugë. "Nuk ka pasur takim të hapur, debat, dilema apo çfarëdo qoftë, nëse Aleanca del ose jo. Gjithsesi, është e drejtë e Aleancës si do të vendosin ata. Unë pres që koalicioni qeveritar do të qëndroj dhe do të vazhdoj ta përforcohet në periudhën që vjen. Por jam i bindur se shumica parlamentare është stabile dhe kjo do të rritet", deklaroi Zaev. Ai

tha se nuk janë dakorduar me PDSH-në e as ka pasur takim me liderin e partisë Menduh Thaçi për koalicionin për shumicë të re parlamentare apo pjesëmarrje në pushtet. Nuk ka pasur takim as me reformatorët e VMRO-DPMNE-së. Përkujtoi se PDSH-ja në mars ka qenë e interesuar të hyjë në pushtet, si edhe BESA, e cila tha, vendosi të mos hyjë me për shkak të çështjeve të pranueshme. "Të hapura janë dyert për

bashkëpunim me të gjithë. Shumica qeveritare duhet të rritet dhe duhet të jetë më stabile sepse para Maqedonisë janë vendime serioze të cilat duhet t'i sjellim. Mbetemi të hapur për bisedë me të gjithë, përfshirë edhe për individë nga opozita e udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Flas në përgjithësi si njerëz me njerëz. Maqedonia është e drejtë para reformave serioze, na duhen bashkëpunime. E di se mjaft deputet të tyre deri tani kanë shfaqur pakënaqësi me politikën e VMRO-DPMNE-së dhe ngadalë po distancohen. Unë nuk pretendoj kjo se do të thotë kalim i tyre në LSDM, vetëm kërkoj bashkëpunim në interes të qytetarëve dhe të shtetit", theksoi kryetari i LSDM-së dhe kryeministri Zaev. TV intervistën e liderit të VMRO-DPMNE-së Nikolla Gruevski e vlerësoi si aktorike, ndërsa në akuzat e tij për par-

regullsi zgjedhore tha se në hyrjen e vetë fushatës të gjitha anketat tregojnë kryesisht të LSDM-së dhe koalicionit. Në akuzat për përgjigje të udhëheqësisë së VMRO-DPMNE-së, Zaev u përgjigj se me ndryshimin e pushtetit nuk ka përgjigje të kundërligjshme në Republikën e Maqedonisë, posaçërisht jo, siç tha, ndaj kundërshtarit politik. Lidhur me paralajmërimin e VMRO-DPMNE-së për referendum për marrëveshjen me Bullgarinë pas zgjedhjeve, Zaev tha se është demokrat dhe se e drejta demokratike çdoherë duhet të shfrytëzohet, por të jetë në pajtim me procedurat, ligjin dhe dispozitat që i definojnë Kushtetuta. "Njëkohësisht edhe në pajtim me përkushtimin tonë të krijimit të miqësive me vendet fqinje. I hapur jam për debat dhe dua t'i shoh të gjitha mendimet e ndryshme", shtoi Zaev.



Ekonomistët vlerësojnë se është koha e fundit që Maqedonia ti kushtojë vëmendje më të madhe mërgimtarëve që dërgojnë shumë të mëdha të hollash për çdo vit në vendlindjen e tyre pa kërkuar asnjë shërbim për këtë ndihmë të madhe që i japin ekonomisë së shtetit që paraqet injeksion financiar për stabilitetin ekonomik, politik dhe makroekonomik të vendit.

Koha **Fisnik PASHOLLI**

Shkup, 23 tetor - Në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, mjetet që hyjnë në emër të remitancave janë shumë më të mëdha se mjetet që hyjnë në emër të investimeve të huaja. Sipas të dhënave të Bankës Botërore për vitin 2015, remitancat në Maqedoni të dërguara në mënyrë zyrtare paraqesin 2.7 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto apo afër 300 milionë euro, ndërsa nga ana tjetër janë realizuar investime të huaja në vlerë prej 215 milionë euro. Nëse këtu i llogarisim edhe disa qindra milionë euro të remitancave që hyjnë përmes kanaleve joformale, atëherë llogaritet se prej 500 milionë euro deri në një miliardë euro, është shuma e të hollave që mërgimtarët dërgojnë në vendlindje që si shumë është pesë herë më e madhe se niveli i investimeve të huaja.

Në Maqedoni një pjesë e madhe e vendbanimeve në të vërtetë jetojnë nga të hollat që pranojnë nga familjarët e tyre jashtë shtetit. Një pjesë e konsiderueshme e familjeve në vend vështirë se mund ta mbijetojnë muajin pa ndihmën financiare të mërgimtarëve. Remitancat apo dërgesat e mërgimtarëve jo vetëm në Maqedoni, por edhe në shtetet e rajonit, në të vërtetë mundësojnë që si shoqëri të harxhojnë më shumë se sa prodhojnë, duke ruajtur paqen sociale dhe zbutur me të madhe edhe shkallën reale të varfërisë. Njëherazi, analizat e ndryshme tregojnë se remitancat kryesisht përdoren për konsumin mujor si pagesa e ushqimit dhe komunale dhe në përqindje shumë të vogël shfrytëzohen për investime të ndryshme.

300 milionë euro

Njohësit e rrethanave financiare në Maqedoni, thonë se po të grumbullohet shuma prej 300 milionë euro së bashku me mjetet që këmben në këmbim, atëherë kjo shumë është shumë më e lartë. Në vitin 2015 ka qenë 1.5 miliardë euro.



Megjithatë, nëse merrret parasysh se në të hollat që këmben në këmbimore hyjnë edhe mjetet që nxirren nga jastëku, mjetet e kompanive private, donacionet e ndryshme nga jashtë e kështu me radhë, atëherë si një shumë që është mesatare dhe e përafërt me realitetin, mund të merrret ajo që shuma që mërgimtarët dërgojnë në shtet, është së paku dhjetë për qind e Prodhimit të Brendshëm Bruto apo afër 900 milionë euro. Ekonomistët vlerësojnë se është koha e fundit që Maqedonia t'i kushtojë vëmendje më të madhe mërgimtarëve që dërgojnë shumë të mëdha të hollash për çdo vit në vendlindjen e tyre, pa kërkuar asnjë shërbim për këtë ndihmë të madhe që i japin ekonomisë së shtetit që paraqet injeksion financiar për stabilitetin ekonomik, politik dhe makroekonomik të vendit.

Sipas analistit ekonomik, Arben Halili, në Maqedoni ekziston nevoja e patjetërsueshme e përgatitje të një sistemi adekuat që do të identifikojë shumë që në emër të remitancave hyn për çdo vit në shtet si dhe ridedikimit të një pjesë të tyre në investime për biznese të vogla familjare, në vend për konsum apo mbulimin e

nevojave mujore të familjare.

“Është koha e fundit që Maqedonia t'i kushtojë një vëmendje më të madhe mërgimtarëve në tërësi, por edhe ndihmesës së madhe që ata i japin shtetit dhe familjarëve të tyre në vendlindje. Nevojitet të ofrohen masa dhe garanci konkrete që kapitali i tyre jo vetëm financiar, por edhe ai njerëzor të ndjehet i respektuar, i mirëseardhur dhe i sigurt në vendlindje me qëllim që së paku një pjesë e mërgimtarëve të mendojnë seriozisht të investojnë këtu”, thekson Halili.

Sipas tij, shteti nevojitet të përgatisë një strategji serioze që të joshë mërgimtarët edhe të brezit të dytë dhe të tretë të mërgimtarëve që të kenë leverdi të investojnë në vendlindje duke shfrytëzuar edhe lidhjen emocionale të tyre me vendlindjen. Në këtë mënyrë do të mundësohet hapja e vendeve të reja të punës, mos-ikja e një pjesë të konsiderueshme të rinisë që e ka mendjen të ikë në mërgim, por edhe kthimi i një pjesë të caktuar të mërgimtarëve në Maqedoni. Halili më tej shton se si shtet nuk duhet të harrojmë se në të ardhmen mund të presim ulje të mëtejshme të totalit të re-

Investimet e huaja

Diaspora me pesë herë më shumë para

ARBEN HALILI

“Është koha e fundit që Maqedonia t'i kushtojë një vëmendje më të madhe mërgimtarëve në tërësi, por edhe ndihmesës së madhe që ata i japin shtetit dhe familjarëve të tyre në vendlindje. Nevojitet të ofrohen masa dhe garanci konkrete që kapitali i tyre jo vetëm financiar, por edhe ai njerëzor të ndjehet i respektuar, i mirëseardhur dhe i sigurt në vendlindje me qëllim që së paku një pjesë e mërgimtarëve të mendojnë seriozisht të investojnë këtu



mitancave si rrjedhojë e bashkimit të familjeve në perëndim.

Në ndërkohë, sipas të dhënave të Bankës Botërore për vitin 2015, në Kosovë remitancat paraqesin 11 për qind të PBB-së. Me fjalë të tjera në Kosovë hyjnë 971 milionë euro remitancat, ndërsa janë realizuar tre herë më pak apo 343 milionë euro investime. Në Bosnjë e Hercegovinë niveli i investimeve të huaja është 293 milionë euro që është gjashtë herë më pak në raport me 1.8 miliardë euro të remitancave.

Gjithnjë sipas të dhënave për vitin 2015, investitorët e huaj në Serbi kanë investuar afër 2.4 miliardë euro, ndërsa nga ana tjetër mërgimtarët kanë dërguar 3.4 miliardë euro, në shtetin më të madh të rajonit që ka edhe numrin më të madh të mërgimtarëve si nga periudha komuniste ashtu që daton nga periudha e më e re. Dallimet të mëdha midis nivelit të investimeve të huaja dhe parave që dërgojnë kurbetçinjtë ka edhe në shtetin anëtar të BE-së dhe NATO-s, Kroacinë, e cila ballafaqohet me probleme dhe sfida të ndryshme ekonomike dhe ikje të madhe të popullatës jashtë shtetit edhe në vitet e fundit.

sovike e popullatës nga rajoni i Evropës Juglindore në Evropën Perëndimore nga njëra anë ndihmon rritjen ekonomike të shteteve perëndimore, ndërsa nga ana tjetër pengon përmirësimin e mirëqenies në shtetet e rajonit. Të dhënat të përafërta të Bankës Botërore tregojnë se nga shtetet e Evropës lindore, qendrore dhe juglindore janë shpërngulur mbi 20 milionë njerëz. Nga ana tjetër, të dhënat po nga ky burim, tregojnë se jashtë Maqedonisë jetojnë afër një të tretat e banorëve të saj. Sipas raportit të Bankës Botërore lidhur me efektet e shpërnguljes ndaj ekonomisë, del se efektet pozitive për shtetet më të zhvilluara ekonomike janë më së evidentë, ndërsa vendet më pak të zhvilluara humbin potencialin e madh për rritje më të madhe ekonomike.

Kroacia jo vetëm që ka një numër shumë të madh të mërgimtarëve që nga vitet 60 dhe 70, që tani gëzojnë pensionin kryesisht gjerman, por ka edhe mërgimin në rritje në shtetet e ndryshme evropiane. Andaj edhe nuk cudit fakti se në Kroaci për çdo vijnë në emër të remitancave vijnë afër 2.1 miliardë euro përkundër investimeve të vogla të huaja me vlerë prej afër 160 milionë euro.

Maqedonia rrezikon të humbë bile 800 milionë euro në vit

Në ndërkohë, analizat e Bankës Botërore tregojnë se Maqedonia rrezikon të humbë bile 800 milionë euro në vit apo 9 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto të vlefshëm afër 9 miliardë euro, si rrjedhojë e migrimit të madh deri në vitin 2030. Këtë e tregon raporti i Bankës Botërore, kështu edhe efektet e shpërnguljes ndaj ekonomisë, i cili merr parasysh humbjen e potencialit për zhvillim ekonomik si rrjedhojë e migrimit të më shumë se 600 mijë banorëve. Shpërngulja ma-



Të dhënat të përafërta të Bankës Botërore tregojnë se nga shtetet e Evropës lindore, qendrore dhe juglindore janë shpërngulur mbi 20 milionë njerëz. Nga ana tjetër, të dhënat po nga ky burim, tregojnë se jashtë Maqedonisë jetojnë afër një të tretat e banorëve të saj



Roli i KRSK-së dhe organeve tjera shtetëror në edukimin e popullatës në drejtim të respektimit të rregullave në komunikacion, është i pakontestueshëm, megjithatë video porositë, pankartat, reklamata dhe të gjitha materialet tjera edukative, deri më sot kryesisht janë bërë në një gjuhë

Koha Omer XHAFFERI


Shkup, 23 tetor - Fushatat senzibilizuese të Këshillit Republikan për Siguri në Komunikacion, vazhdojnë të realizohen vetëm në gjuhën maqedonase. Kjo mënyrë e ngritjes së vetëdijes qytetare për respektimin e rregullave të komunikacionit, siç mund të shihet nga organizimet e KRSK-së, bëhet në kohë kur viktimat dhe të lënduarit nga aksidentet në komunikacion vijnë nga shtresat e ndryshme të popullatës. Shpejtësia e madhe nga njëra anë dhe kalimi i rrugëve nga qytetarët në vendet e pashënjestruara nga ana tjetër, sipas hulumtimeve të KRSK-së, janë arsye të shpeshta se pse ndodhin aksidente në komunikacionin rrugor, një pjesë e të cilëve me pasoja të kobshme.

Ndonëse kanë mbetur edhe disa muaj deri në përfundim të këtij viti, numri i viktimave që kanë humbur jetët nëpër asket rrugore të Maqedonisë ka arritur deri në 91 të vdekur. Në kuadër të raporteve ditore, të cilat i publikon Ministria e Punëve të Brendshme, aksidentet më të shpeshta në komunikacionin rrugor ndodhin në akset rrugore të Veles-Demir Kapi. Ndërkohë, situata aspak më e mirë nuk është regjistruar në autostradën lidhëse Shkup-Tetovë-Gostivar, me çka vetëm gjatë sezonit të verës që kaloi kanë ndodhur dhjetëra aksidente. Roli i KRSK-së dhe organeve tjera shtetëror në edukimin e popullatës në drejtim të respektimit të rregullave në komunikacion, është i pakontestueshëm, megjithatë video porositë, pankartat, reklamata dhe të gjitha materialet tjera edukative, deri më sot kryesisht janë bërë në një gjuhë.


Për të pasur një pasqyrë më reale për aktivitetet e këtij Këshilli, qytetarët mjaftojnë ta vizitojnë adresën zyrtare në internet, e cila përmban materiale të bollshme, duke filluar nga këshillat për fëmijët parashkollor e deri të kategoria më e prekure e shoqërisë, e që në këtë rast janë personat e shtyrë në moshë. Në bazë të informacione që i ofron kjo adresë, mund të vërehet se nga fillimi i këtij viti KRSK-ja ka realizuar disa fushata edukative për fëmijët në ko-

KRSK-së me aktivitete jo gjithëpërfshirëse

Fushatat vetëm në maqedonisht



Животот е полн со бои само кога е безбеден – нова едукативна активност на РСБСП и „ЛУКОИЛ“ Македонија, ДООЕЛ



Совети за безбедно патување во лето



Најопасни работи кои ги прават возачите



Зошто страдаат пешаците во Република Македонија?



Зошто страдаат пешаците во Република Македонија?



Зимски совети за безбедност на пешаците во сообраќајот

munikacion, respektivisht takimet me nxënës dhe organizata tjera të fëmijëve, ky Këshilli i ka zhvilluar kryesisht në shkollat e komunave Gazi Babë, Qendër, Karposh, Gjorçe Petrov e kështu me radhë.

Ndryshe, në raportin e publikuar vitin e kaluar KRSK-ja, mes tjerash, Bulevardin "Cvetan Dimov" në Çair, e ka cilësuar si rrugën më të rrezikshme për këmbësor, gjegjësisht në këtë rrugë është e pozicionuar shkolla fillore "Liria", e cila disponon me një numër të konsiderueshëm të nxënësve. Njëherit rekomandimet dhe këshillat që i

jep ky Këshilli, varësisht prej stinës së vitit janë tejet të rëndësishme, mirëpo të njëjtat punëtorët medial duhet që vetvetiu t'i përkthejnë, për arsye se shumica prej tyre lëshohen vetëm në maqedonisht. Pjesë e projekteve të këtij Këshilli janë motoçiklistët, ciklistët, këmbësorët dhe të rinjtë. Kësisoj, kampanjat e ndryshme, takimet dhe apelet realizohet vetëm për një shtresë të popullatës. Me qëllim ngritjen e vetëdijes te qytetarët për kujdesin më të madh, të cilët duhet të kenë gjatë kohës kur janë në komunikacion, Këshilli Republikan për Siguri në Komunika-

cion, gjatë periudhës së kaluar ka realizuar aktivitete edhe në bashkëpunim me shumë fytyrat publike, epike të ndryshme sportive dhe aktivistë të ndryshëm. Por, edhe kësaj radhe, me qëllim ose jo, mund të vërehet se janë anashkalluar fytyrat publike dhe ekipet sportive shqiptare.

Sidoqoftë, angazhimet e KRSK-së në drejtim të uljes së aksidenteve tragjike në komunikacion, ndonëse janë shumë të shpeshta dhe përmbajtjesore, prapë se prapë ato deri më sot kanë qenë të pjesërishme, me çka u janë dedikuar vetëm një kategori të popullatës.

Kronikë

Lëndohen dy punëtorë në autostradën Kërçovë-Ohër

Dy punëtorë ndërtimi janë lënduar gjatë kryerjes së punëve ndërtimore tek vendi Lavçani në aksin rrugor Kërçovë-Ohër, kumtoi MPB. Punëtorët M.A. (53) nga Dibra dhe L.V. (957) nga f. Mogorçe, rrethi i Dibrës, janë goditur nga një zorrë që është që ka qenë nën ndikim të ajrit të kompresuar. Ata janë dërguar në Qendrën mjekësore në Kërçovë ku u është dhënë ndihmë mjekësore. Tek M.A janë konstatuar lëndime të rëndë trupore në kokë, pas së cilës është dërguar në Qendrën klinike në Shkup, ndërsa tek V.L janë konstatuar lëndime trupore dhe pas ndihmës së dhënë mjekësore është lëshuar në mjekim shtëpiak. Ekspertizë në vendngjarje ka kryer Zyra e jashtme e punëve kriminalistike Kërçovë. Ndërmerren masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Digjet vikend-shtëpiza e funksionarit të BDI-së!

Natën mes se premtës dhe së shtunës, në rrethana misterioze është djegur vikend shtëpizë në Kodrën e Diellit. Sipas policisë së Tetovës, vikend shtëpiza është pronë e 41 vjeçarit H.Xh nga Tetova. Sipas denoncimit, zjarri fillimisht është përhapur në katin përdhese dhe më pas është përhapur edhe në pjesët tjera të vikend shtëpizës, në ndërkohë zjarri është shuar ndërsa dëmi është llogaritur rreth 1 milion e 800 mijë denarë. Policia ka kryer hetim, e ka fotodokumentuar vendin e ngjarjes dhe punon në zbardhjen e plotë të shkaqeve të këtij zjarri. Në rrjetet sociale dhe në disa portale është përhapur lajmi se vikend shtëpiza është pronë e një funksionari të lartë të Bashkimit Demokratik për Integrim nga Malësia e Tetovës.

Gjashtëvjeçarja goditet në Shtip

Një vajzë gjashtëvjeçare ka marrë lëndime të rënda trupore pasi atë e ka goditur një automjet motorik "Reno" me targa të Shtipit, të drejtuar nga K.T. (32) nga Shtipi. Siç kumtoi MPB-ja, aksidenti ka ndodhur të dielën në orën 8:45 në udhëkryqin e rrugës "Çerenja" dhe rrugën "Kosovska" në Shtip. Vajza është transferuar në Qendrën mjekësore Shtip. Pas ndihmës së dhënë mjekësore është transferuar dhe mbajtur në Qendrën klinike Shkup. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i SPB Shtip.

Bombë artizanale në Gazi Babë

Disa adoleshentë kanë gjetur bombë artizanale në rr. "Ordan Çopella" në Komunën e Shkupit, Gazi Babë. Siç kumtoi MPB-ja, ngjarjen të dielën në orën 14.05 minuta në Njësitin për informacione dhe komandë Shkup e ka paraqitur H.S. Në vendin e ngjarjes kanë dalë ekipi i Sektorit për antiterrorizëm, i cili e ka marrë bombën e dorës. po merren masa për zbardhjen e rastit.

Në "Bogorodicë" zbulohen 13 emigrantë ilegalë

Shkup, 23 tetor - Një grup prej 13 emigrantëve ilegalë nga Iraku ka zbuluar të dielën policia kufitare në bunkerin e bërë special në automjetin transportues me targa bullgare, të drejtuar nga një shtetas grek. Siç kumtoi MPB-ja, grupi i emigrantëve është

zbuluar rreth orës 20:45 minuta në Vendkalimin kufitar "Bogorodicë" nga ana e nëpunësve policorë në bashkëveprim me nëpunësit doganorë, gjatë kontrollit të automjetit transportues "Reno" me targa bullgare, të drejtuar nga S.A. (45) nga Re-

publika e Greqisë. "Emigrantët janë gjetur në një bunker special të bërë në pjesën e përparme të rimorkios, menjëherë pas kabinës së automjetit. Qendra rajonale për punë kufitare Jug pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme deri te

Prokuroria Themelore Publike për ndjekje të krimit të organizuar Shkup parashtrori kallëzim penale kundër S.S. për shkak të ekzistimit të bazave të dyshimit për vepër të bërë penale 'fshehje të emigrantëve', theksojnë nga MPB-ja.



Të dhënat e fundit të ESHS-së për varfërinë në Maqedoni nuk janë diçka e re për ekspertët ekonomik, të cilët Maqedoninë e vendosin si një nga vendet e paktë në Evropë ku shtresa më e varfër e popullsisë, gati gjysma e saj, po bëhet edhe më e varfër

Një 57-vjeçari i konfiskohen armë dhe municion

Shkup, 23 tetor - Sektori për Punë të Brendshme në Shkup - Njësi për tregti të palejuar, deri te Prokuroria Themelore Publike parashtrori padi penale kundër Z.G (57) nga Shkupi për shkak dyshimit të bazuar se ka kryer dy vepra penale "përpunim të paautorizuar, mbajtje, ndërmjetësim dhe tregti me armë dhe materie shpërthyes" dhe "fshehje të mallrave të cilat janë lëndë kontrabandimi dhe mashtrimi doganor", janë paraparë dhe ndëshkuara edhe sipas nenit 396 dhe nenit 278-b nga Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë. Siç kumtoi MPB, pas masave të ndërmarra operuese-taktike, Njësi për tregti të palejuar ka ardhur deri në informacione se Z.G ka blerë sasi më të mëdha armësh dhe municion. Një pjesë prej tyre i ka bartur në motoçikletë të cilin e ka drejtuar, ndërsa një pjesë është gjendur në shtëpinë e tij. Armët e marra janë dorëzuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme për ekspertizë.



Një i vdekur në rrugën Manastir-Prilep

Manastir, 23 tetor - Banorja 18-të vjeçare e Manastirit K.J e humbi jetën, ndërsa bashkudhëtarja M.K.O është transferuar në Klinikën Spitalore të Manastirit pas aksidentit të rëndë të sotëm të komunikacionit që ndodhi në aksin rrugor rajonal Manastir-Prilep. Leliftaria Milenovska, zëdhënëse e SPB-Manastir informon se aksidenti ka ndodhur sot paradite në orën 11:25 në afërsi të fshatit Topollçani kur një automjet motorik për udhëtim me targa të Manastirit "Fiat Brava" ka dalë nga rruga. Për shkak aksidentit, komunikacioni në rrugën magjistrale Prilep-Manastir pranë fshatit Topollçan prej orës 11:30 riorientohet nëpër rrugën e vjetër, informon LAMM. Në aksin Manastir-Prilep, megjithatë, komunikacioni zhvillohet në një korsi. Hollësitë për aksidentin nuk janë kumtua.

Mbi gjysma e popullatës në Maqedoni janë të varfër

Ta kalosh ditën me 50 denarë!

Të dhënat e fundit të ESHS-së tregojnë se 51 për qind e popullatës në Maqedoni jetojnë në varfëri të plotë, një anëtar i një familje katër anëtarëshe me një të punësuar mbahet gjallë me më pak se 100 denarë në ditë, ndërsa një anëtar i një familje prej katër anëtarësh me asistencë sociale mujore prej 6000 denarësh në muaj e mbijeton ditën me më pak se një euro apo 50 denarë



Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 23 tetor - Raporti i fundit i Entit Shtetëror të Statistikave në Maqedoni (ESH) tregon se 51 për qind e familjeve totale të vendit, ato që përbëjnë dhe pjesën më të varfër, jo vetëm që nuk kanë pasur rritje mirëqenieje gjatë këtyre 10 vitet e fundit, por janë përballur edhe me mungesë të gjërave elementare për ushqim. "Në Maqedoni, 450.000 qytetarë jetojnë në varfëri të skajshme apo një familje me nga 3 apo 6 anëtarë e kalojnë muajin me 6000 denarë. Me problemin e varfërisë më së shumti ballafaqohen familjet që janë bartës të ndihmave sociale me nga 3 apo 4 fëmijë", thuhet në raportin e fundit të ESHS-së. Mirëpo, në varfëri të skajshme nuk jetojnë vetëm familjet me ndihma sociale, por edhe një numër i madh i të punësuarve në Maqedoni, të cilët edhe pse marrin rroga të rregullta - kanë vështirësi të përballojnë harxhimet mujore të nevojshme për një familje katër anëtarësh me një të punësuar. Të dhënat e fundit zyrtare të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale tregojnë se 220.000 mijë të punësuar, gjegjësisht çdo i treti i punësuar në Maqedoni është i varfër edhe përkundër faktit se të njëjtit marrin pagë mujore.

MPPS vlerëson se të varfrit nuk janë vetëm të papunët, por edhe të punësuarit dhe opsion i vetëm për të zbutur sadopak varfërinë - është rritja e rrogës minimale. "Rritja e rrogës minimale nuk do të thotë se do të ulë varfërinë të një numër i konsiderueshëm i të punë-

BESNIK FETAI

Maqedonia, gjegjësisht qeveritë e mëparshme gati 20 vite me të gjitha përpjekjet fisnike për të ndryshuar gjendjen sociale të qytetarëve në Maqedoni, më shumë se gjysma e popullatës vazhdon të bëhet edhe më e varfër se sa kanë qenë 10 viteve më parë. Nuk them se asnjë qeveri deri më tani nuk është përpjekur të bëjë diçka për gjendjen e mjerë të të varfërve. Ka pasur propozime të ndryshme, por deri më sot nuk është përpiluar asnjë strategji e mirëfilltë qeveritare për të përmirësuar varfërinë, e cila vazhdon dita ditës të rritet edhe më shumë

suarve që deri më sot kanë marrë rroga më të ulëta se rroga minimale. Përlogaritjet e fundit tregojnë se në një familje katër anëtarëshe duhet të ketë rrogë më të lartë se 12 mijë denarë në muaj që të mund të del nga varfëria e skajshme", thotë ministrja Milla Carovska. Sipas saj, sistemi për mbrojtje sociale deri më sot nuk ka thënë rezultate sa i përket uljes së përqindjes së personave të varfër në vend, prandaj paralajmëron se deri në fund të vitit të ardhshëm - do të fillohet me masa konkrete, të cilat parashohin që çdo familje të ketë të ardhura më të larta se 12 mijë denarë. "Planifikojmë që deri në fund të vitit 20120, varfërinë nga 21.5 për qind sa është për momentin, ta zvogëlojmë deri më 16 për qind. Kjo do të arrihet me shkurtimin e të gjitha shpenzimeve joproduktive që të mund të ketë më shumë para për qytetarët e kategorive të rënda sociale. Megjithatë, nuk zgjidhet problemi nëse këta persona

nuk i përfshijmë në tregun e punës. Është e rëndësishme që ne - patjetër të bëjmë aktivizimin e të gjitha personave që marrin asistencë sociale dhe të mos lejojmë që ndihmat sociale të jenë mënyra e vetme e jetesës. Ndihma sociale nuk është vetëm rrjet që ju ndihmon në momente të krizës ekonomike si familje apo individ, e më pas duhet t'ju kthehen në tregun e punës", thotë ministrja Carovska.

Të dhënat e fundit të ESHS-së për varfërinë në Maqedoni nuk janë diçka e re për ekspertët ekonomik, të cilët Maqedoninë e vendosin si një nga vendet e paktë në Evropë ku shtresa më e varfër e popullsisë, gati gjysma e saj, po bëhet edhe më e varfër. "Maqedonia, gjegjësisht qeveritë e mëparshme gati 20 vite me të gjitha përpjekjet fisnike për të ndryshuar gjendjen sociale të qytetarëve në Maqedoni, më shumë se gjysma e popullatës vazhdon të bëhet edhe më e varfër se

sa kanë qenë 10 viteve më parë. Nuk them se asnjë qeveri deri më tani nuk është përpjekur të bëjë diçka për gjendjen e mjerë të të varfërve. Ka pasur propozime të ndryshme, por deri më sot nuk është përpiluar asnjë strategji e mirëfilltë qeveritare për të përmirësuar varfërinë, e cila vazhdon dita ditës të rritet edhe më shumë", thotë Besnik Fetai, profesor universitar. Sipas tij, të dhënat e fundit të ESHS-së flasin se 51 për qind e popullatës në Maqedoni jetojnë në varfëri, një anëtar i familjes katër anëtarëshe me një të punësuar mbahet gjallë me më pak se 100 denarë në ditë, ndërsa një anëtar i familjes prej katër anëtarësh me asistencë sociale mujore prej 6000 denarë apo 100 euro në muaj, e mbijeton ditën me më pak se një euro apo 50 denarë. Njëhersh, të dhënat e fundit të ESHS-së tregojnë se 28 për qind e popullatës në Maqedoni brenda një muaji nuk mund të mbulojnë harxhimet e nevojshme siç është ushqimi. Në anën tjetër, 42 për qind e amvisërive në Maqedoni me rrogat që marrin brenda muajit - nuk arrijnë të paguajnë të gjitha faturat komunale, derisa vetëm 16 për qind e popullatës arrijnë të paguajnë të gjitha faturat komunale si dhe të ushqehen mirë. Ndërsa sa i përket pagave mujore, sipas ESHS-së, 40 për qind e popullatës marrin rrogë në vlerë deri më 20.000 denarë, 49 për qind marrin rroga prej 12.000 denarë deri më 25.000 denarë dhe vetëm 8 për qind e popullatës e Maqedonisë marrin pagë mujore mbi 25.000 denarë.

Edhe Zaevi pret ekstradimin e Grujevskit dhe Boshkoskit

Shkup, 23 tetor - Kryeministri Zoran Zaev të hënën deklaroi se pret që për shkaqe politike të pengohet ekstradimi i Goran Grujevskit dhe Nikolla Boshkoskit nga Greqia në Maqedoni. Duke u përgjigjur në pyetjen e gazetarëve gjatë vizitës në Draçevë. Zaev tha se Maqedonia ka vendosur bashkëpunim me Greqinë

dhe pret që të zbatohet e drejta ndërkombëtare, ndërsa ish-shëfi i Drejtorisë së pestë në MPB, Grujevski dhe kolegu i tij Boshkoski, të cilët akuzohen nga PSP të ekstradohen. "Nuk pres që të paraqitet shkak politik që të zbatohet e drejta ndërkombëtare. Maqedonia ka lidhur marrëveshje të këtitilla me Greqinë.

Edhe në të kaluarën, me pushtetin paraprak, Maqedonia nuk ka pasur probleme në të gjitha aspektet tjera, përveç problemit me emrin. Me të vërtetë kemi bashkëpunim me Greqinë nga çdo aspekt i mundshëm. Ministritë e punëve të brendshme dhe ato e drejtësisë bashkëpunojnë dhe besoj se do të tregojnë

bashkëpunim në vepër, sepse ato janë kompetente. Sinqerisht nuk pres nevojë nga çfarëdo qoftë intervenimi politik, sepse bëhet fjalë për dy vende fqinje, që janë mike. Ekziston një problem i hidhur politik, i cili besoj se në periudhën e ardhshme do ta zgjidhim së bashku", deklaroi Zaevi.





207 nxënës mbetën pa shkollë

Novosellë, zgjidhje e përkohshme

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Renata Deskoska, ka thënë se janë koordinuar me zëvendëskryeministrin Hazbi Lika, që i njëjti të vizitojë këtë shkollë dhe njëkohësisht ka dhënë mbështetje për zgjidhje të shpejtë të këtij problemi

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 23 tetor-Pas shpërthimit të zjarrit në shkollën fillore 11 tetori të fshatit Novosellë, kur për pasojë në tërësi u dogj objekti bashkë me mjetet mësimore brenda, në opion janë tre lokacione alternative ku nxënësit përkohësisht deri ne gjetjen e një zgjidhje afatgjate, do të duhet të vijojnë procesin edukativo arsimorë. Njëri prej lokacioneve është një pjesë ndihmëse e objektit të shkollës, e cila fatmirësisht i ka shpëtuar zjarrit dhe plotëson kushtet minimale për vijimin e procesit edukativo arsimorë, gjithashtu edhe hapësirat e bashkësisë lokale të fshatit, si dhe mektebi i xhamisë së këtij fshati. Këtë e bëri të ditur



të hënën përgjegjësi i Sekretorit për arsim pranë Komunës së Bogovinës, Nurban Tefiku.

Përndryshe, ministria e Arsimit dhe Shkencës, Renata Deskoska, ka thënë se janë koordinuar me zëvendëskryeministrin Hazbi Lika, që i njëjti të vizitojë këtë shkollë dhe njëkohësisht ka dhënë mbështetje për zgjidhje të shpejtë të këtij problemi. Ajo tha se në mëngjes është dëgjuar edhe me drejtorin e kësaj shkolle dhe punohet që të gjendet zgjidhje e përkohshme, ndërsa Ministria e Arsimit

dhe Shkencës, do të përpunojë projekt dhe do të mbështesë ndërtimin e një objekti të ri shkollor. Po ashtu gjatë ditës së hënë në këtë shkollë ka qëndruar zëvendëskryeministri Hazbi Lika, me ç'rast është formuar një grup pune për sistemimin e nxënësve deri sa të rregullohet shkolla e re. Ai ju premtoi banorëve të Novosellës se Qeveria menjëherë do të nisë fazën e parë për rindërtimin e kësaj shkolle dhe fshati do të ketë një objekt të ri, ku edhe nxënësit do të mësojnë në kushte edhe më të

mira.

Ndryshe, zjarri shpërtheu të dielën në mesditë në objektin shkollor të këtij fshati të Komunës së Bogovinës. Në shuarjen e zjarrit kanë marrë pjesë tre automjete dhe 8 zjarrfikës, të cilëve iu deshtë më shumë se dy orë për ta vënë nën kontroll zjarrin. Zjarrfikësit arritën, por nuk mundën të bëjnë më shumë për të parandaluar djegien e tërë objektit.

"Me të marrë lajmin ne kemi dalë në terren dhe kemi arritur në vendngjarje me tre automjete kundër zjarrit dhe me tetë

zjarrfikës. U nevojiten dy orë e gjysmë për ta vendosur nën kontroll zjarrin. Deri sa intervenonim në shkollë, flakët kapluan edhe një objekt tjetër, por bashkë me zjarrfikësit dhe banorët e fshatit Novosellë që na ndihmuan gjatë gjithë kohës, zjarri vë shpejt nën kontroll", tha Uka Aliti, kryeshef i Njësisë së zjarrfikësve në Tetovë.

Në këtë shkollë mësimin e kanë ndjekur 207 nxënës. Tani për tani nuk dihet se çfarë do të ndodhë me procesin edukativ arsimor të këtyre

nxënësve. Kjo është shkollë territoriale me 207 nxënës të shpërndarë në 13 paralele. Momentalisht ende nuk e kemi idenë se si do e organizojmë procesin edukativo arsimor", deklaroi Aziz Jakupi, drejtor i shkollës qendrore "11 tetori". Shkolla periferike është rinovuar për herë të fundit në vitin 2011, në kuadër të projektit shkollor me efikasitet energjetik, nga fondet e Bankës Botërore. Përveç shkollës është djegur edhe një veturë dhe një pjesë e një kasolleje që ndodhej afër godinës së shkollës.



Shkup, 23 tetor – Të hënën, në orët e para të mëngjesit, ka ndërruar jetë profesori i shquar dhe i nderuar, Profesor Xhevat Gega. Prof. Dr. Xhevat Gega u lind në Strugë në vitin 1934. Shkollimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa Normalen në Tetovë dhe Shkup. Pas mbarimit të Narmales, punon si mësues në fshatin Kishavë të Manastirit, ndërsa një vit më vonë në fshatin Veshhtë të Strugës. Në vitin 1953, profesor Xhevat Gega regjistrohet në Fakultetin Filozofik në Beograd ku diplomohet në degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare. Më pas punoi si profesor në Normalen "Zef Lush Marku" të Shkupit, ndërsa si bashkëpunëtor i jashtëm ka ligjruar edhe në Grupin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare pranë Akademisë së Lartë Pedagogjike "Kliment Ohridski" të Shkupit. Nga tetori i vitit 1969 e deri më 1974 ka punuar si profesor i lëndëve historike e letërsisë shqiptare dhe teori e letërsisë pranë Akademisë Pedagogjike "Kliment Ohridski" në Shkup, ndërkaq në periudhën 1974 – 1978 ka qenë kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i gazetës "Flaka e Vëllazërimit" si dhe i edicioneve të

Shuhet profesor Xhevat Gega

Xhevat Gega do të mbetet simbol i përkushtimit ndaj punës, sidomos do të mbete i paharrueshëm për shumë e shumë gjenerata, të cilët ose ai i edukoi ose u edukuan duke mësuar nga veprat e tij, sidomos i veçantë do të mbetet me Abetaren e tij, nga e cila e mësuan ABC-në me mijëra e mijëra nxënës shqiptarë

tjera në gjuhën shqipe, të cilat botohen në Republikën e Maqedonisë. Si bashkëpunëtor i jashtëm, ka ligjruar metodikën e mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqiptare pranë Fakultetit Filologjik në Shkup. Që nga viti 1978 e deri sa u pensionua (tetor 1996), profesor Xhevat Gega punoi pranë Fakultetit Filologjik në Shkup si ligjruar i lartë e në fund edhe si profesor i historisë së letërsisë shqiptare, duke kryer vite të tëra edhe detyrën e shefit të Katedrës së Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare. Profesor Gega me sukses do ta mbrojë punimin e disertacionit të doktoratës në temën Letërsia e nacionalitetit shqiptar në Republikën e Maqedonisë 1945 – 1985 dhe do ta fitojë titullin shkencor doktor i shkencave filologjike.

Dr. Xhevat Gega brenda aktiviteteve të tija pedagogjike e profesionale – shkencore zhvilloi edhe një veprimtari të rëndësishme lidhur me tekstet mësi-

more për nevojat e nxënësve shqiptarë në Maqedoni e Kosovë. Ndër veprat e tij më të rëndësishme është ABETARJA – botimi i parë në vitin 1970 e që do të pësojë shumë ribotime. Ai është autor i fletoreve të punës për klasat I – IV me disa ribotime, Letërsia me teorinë e letërsisë për klasën e parë të shkollave të mesme, Gramatika për klasën IV dhe V, Letërsia me shembuj për klasën e parë të arsimit të mesëm. Ka qenë bashkëpunëtor në përgatitjen e planeve e programeve mësimore për gjuhën dhe letërsinë shqiptare, bashkëpunëtor dhe pjesëmarrës në seminare për ngritjen permanente të arsimtarëve për shkollat e mesme me tema të ndryshme nga fusha e letërsisë dhe metodikës së mësimdhënies së gjuhës dhe letërsisë shqiptare të organizuar nga ana e Entit Pedagogjik Republikan të Maqedonisë. Është autor i një veprimtarie madhore përkthyes, ka me dhjetëra tituj të përkthyer nga maqedonishtja dhe letërsitë jugosllave. Xhevat Gega ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në zgjedhjen dhe përkthimin e materialeve për Mbrëmjet Strugane të Poezisë, Takimet e Racinit, Institutin e letërsisë pranë Fakultetit Filologjik në Shkup (si udhëheqës i projektit), etj. Si anëtarë i Komisionit të ortografisë i vitit 1963, i themeluar për të dhënë kontributin në vendosjen e rregullave dhe shmangies së lëkundjeve në drejtshkrimin e

gjuhës shqipe, Xhevat Gega jep kontributin profesional për përgatitjen dhe merr pjesë aktive në punën e Konsultës gjuhësore të Prishtinës mbajtur në vitin 1968, duke mbështetur qëndrimin: "Një komb – një gjuhë letrare!"

Në pasqyrën e bibliografisë të profesorit dr. Xhevat Gega, përfshihen mbi 100 punime profesionale dhe shkencore. Ai ka marrë pjesë në mbi 30 simpoziume shkencore në vend dhe në botë. Ka përkthyer 20 libra nga maqedonishtja dhe serbokroatishtja në shqipe si dhe nga shqipja në maqedonishtje

Dr. Xhevat Gega në veprimtarinë e tij shumëvjeçare pedagogjike e shkencore, ka treguar interes të theksuar, afinitete të veçanta në paraqitjen, kërkimin dhe shpalljen e rezultateve nga proceset zhvillimore të letërsisë shqiptare me tërësinë e saj, nëpërmjet përfaqësuesve të saj më të spikatur. Vëmendje të veçantë meritojnë punimet mbi Jeronim De Radën, Fan Nolin, Naim Frashërin, Luigj Gurakuqin, S. Spasen, etj. Vend qendror në këto punime zë studimi shkencor mbi poezinë origjinale të Fan Nolit dhe gjenezën e saj politike, të botuar në "Jehona", 4-5/1965 dhe e përfshirë në vëllimin mbi kritikën e Nolit, botuar në veprat e tij të zgjedhura në botim të "Rilindjes", Prishtinë 1968. Në këtë studim të rëndësishëm, me pothuajse ndërmarrje monografike për Fan Nolin, person-

alitetin qendror në historinë e re shqiptare dhe të letërsisë shqiptare në përgjithësi, Xhevat Gega arrin t'i caktojë vlerat universale të poezisë së tij, tiparet e saj motivore – stilistike në kontekst të traditës letrare shqiptare, por edhe origjinalitetin e këtij personaliteti të spikatur të historisë, kulturës dhe letërsisë shqiptare. Me këtë studim Xhevat Gega është cituar nga shumë studiues të cilët janë marrë me këtë figurë tek ne dhe jashtë. Vëmendje të veçantë meriton edhe studimi shkencor i Xhevat Gegës Filip Shiroka – Luigj Gurakuqi, në kuadër të zgjedhjes së krijimtarisë së tyre (në zgjedhje dhe redaksi të tij), të botuar në Beograd më 1962, me çka vërehet përpjekja, bashkë me studimet mbi Naim Frashërin, De Radën, S. Spasen etj., për ta rrumbullakuar prezantimin e përhershëm të letërsisë shqiptare në dimensionet më të gjera dhe monografike.

Xhevat Gega do të mbetet simbol i përkushtimit ndaj punës, sidomos do të mbete i paharrueshëm për shumë e shumë gjenerata, të cilët ose ai i edukoi ose u edukuan duke mësuar nga veprat e tij, sidomos i veçantë do të mbetet me Abetaren e tij, nga e cila e mësuan ABC-në me mijëra e mijëra nxënës shqiptarë. Varrimi i të ndjerit profesor Gega u bë po të hënën në varrezat e qytetit në Strugë. I përjetshëm qoftë kujtimi për profesor Xhevat Gegën.



Ai kishte një fytyrë të gjatë si rozë, jo me tipare mesdhetare, që vinte në formë konike nga balli i gjerë tek mjekra e ngushtë. Balli ishte i lartë dhe mund të kishte qenë më i lartë po të mos ishte për flokët e krehur në anën e majtë. Më pas, vihej re, sado e çuditshme që të ngjajë, se mjekra nuk ishte aq e mprehtë sa dukej në fotografi. Tipari që binte më shumë në sy ishte hunda e drejtë, e cila në profil shkrihej me ballin në vijë të drejtë. Herë pas herë vetullat e rëna i jepnin një pamje zyrtësisht të përvuajtur që ngjante simpatike dhe lehtësisht komike

Jason TOMES

Vendi më i harruar i Evropës, Shqipëria. Në vitet '30 tragetet zbrakonin çdo ditë nga taka e Italisë dhe një avion pesë vendesh i “Adria-Aero-Lloyd” fluturonte tre herë në javë drejt aeroportit të Tiranës, por shërbimet ishin nën standardet e përdorimit dhe nuk viheshin dot në punë pa subvencione. Në vendin më të vogël ballkanik, të huajt ishin aq të rrallë sa bëheshin menjëherë të famshëm. Një anglez, francez apo amerikan i respektuar, i cili shfaqte interes të kënaqshëm ndaj vendit mund ta kishte relativisht të lehtë të përfortonte një pritje nga mbreti-politikan. Ekzistonte një histori sipas të cilës kur Zogu mërzhitej u telefononte hoteleve për të gjetur ndonjë të huaj interesant që të shkëmbente dy llafe me të. Pallati i tij ishte më pak se pesë minuta larg dhe gjuha e përbashkët gjendej shumë kollaj. Mbreti nuk ishte kozmopolitan, por ai fliste turqisht shumë mirë, gjermanisht mirë dhe frëngjisht mjaftueshëm për të biseduar. Anglishtja nuk ishte opsion, ai refuzonte të humbiste kohë me një gjuhë, e cila i bindej gramatikës vetëm dhjetë për qind. Një roje me një “Z” të ndritshme në pelerinë shoqëronte vizitorët përmes rrugës me tulla të kuqe në kompleksin mbretëror, në juglindje të sheshit qendror. Një sekretar, mbase Sotir Martini, apo adjutanti energjik Zef Sereqi shfaqeshin para të ftuarve për t'i informuar mbi disa pika të protokollit. Dymbëdhjetë hapa më tej shfaqej vila dykatëshe me stuko të verdhë, e cila ishte ndërtuar për një tregtar turk para luftës.

I drejtuar në sallonin e vogël të pritjes me pasqyra të ndritshme dhe llambadarë venecianë vizitori mund të shihte stallierin e oborrit nëpërmjet perdeve përpara se të shfaqeshin kanatet e xhamit. Një burrë me flokë kafe dilte menjëherë në skenë, i ulur në fund të një dhomë të gjatë dhe të ndriçuar mirë, e mobiluar në stil modern me letër muri ngjyrë të gjelbër. Mbreti dukej i vogël dhe thuajse i padukshëm ndër-

Një audiencë me mbretin Zog

Edhe më i varfri i shqiptarëve ka një nuancë mbretërore



mjet tryezës së madhe prej druri të kuq dhe portretit të madh të varur në murin mbas. Syprina e tryezës ishte e rregullt dhe me shkëlqim. Në pikturë shfaqej një grua e ashpër meso-moshë me një paraqitje jo dhe aq mbretërore. Vizitori hynte në dhomë dhe kollitej lehtë.

Kishte gjithnjë një shtëllunge tymi duhani dhe rrallëherë ndonjë dritare të hapur. Ai përkulej tre herë (siç ishte udhëzuar) dhe ecte përpara me hapa të kujdesshëm. Ata më me pak fat janë penguar shpeshherë në qilimat dekorativë të shtruar në dyshemenë e lëmuar. Teksa i afrohej tryezës, sytë e tij përqneshin në tiparin më ekstravagant në horizont: Mustaqet e Mbretit. Edhe pse shumë të mëdha, ato ishin gjithmonë të rregulluara dhe të stiluara me maja të holla të rregullta. Tundimi për t'u ngulur sytë mustaqeve duhej nënshtruar teksa mbreti ngrihej avash dhe pëshpëriste disa fjalë përshëndetje me zë të ulët e të qartë. Ai ishte rreth 1 metër e 80 i gjatë, qëndrimi i tij i drejtë dhe figura e tij thatime. Ai bënte çmos që të dukej i mbajtur: Një kostum ngjyrë gri dopiopet nga Savile Roë, një këmbisë e bardhë nga Sulka, Paris, këpucë të prodhuara me dorë në Itali. Një buzëqeshje e qetë shoqëronte shtrëngimin e fortë të dorës dhe vizitori ulej.

“Një cigare?”

Me një gjest mospërfilës, Mbreti ofronte një sërë markash cigaresh nga tavolina e tij. Ai merrte gjithnjë një për vete (i

kërkonte falje jo duhanpirësve) dhe tekta cigarishtja e mbante të zënë për një moment, vizitori mund të skanonte në mendje mbretin. Ai kishte një fytyrë të gjatë si rozë, jo me tipare mesdhetare, që vinte në formë konike nga balli i gjerë tek mjekra e ngushtë. Balli ishte i lartë dhe mund të kishte qenë më i lartë po të mos ishte për flokët e krehur në anën e majtë. Më pas, vihej re, sado e çuditshme që të ngjajë, se mjekra nuk ishte aq e mprehtë sa dukej në fotografi. Tipari që binte më shumë në sy ishte hunda e drejtë, e cila në profil shkrihej me ballin në vijë të drejtë. Herë pas herë vetullat e rëna i jepnin një pamje zyrtësisht të përvuajtur që ngjante simpatike dhe lehtësisht komike. Vizitori më pas pyeste veten nëse aristokracia 38-vjeçare ishte vërtet prijësi i pamëshirshëm malësor, i cili kishte shkatërruar rivalët e tij dhe themeluar mbretërinë. Zogu ulej në karrigen e tij, buzëqeshte sërish lehtë, a thua se po i zbulonte vizitorit hijen e një sekreti që veç ai vetë e dinte. Pavarësisht plogështisë që i shfaqej në portret, sytë blu në gri ishin gjithmonë në gatishmëri. “Shkrepini pyetjet tuaja të pavend”, thoshte duke qeshur përpara se të vazhdonte të jepte përgjigje krejtësisht të matura. Pse e ktheu Shqipërinë nga republikë në monarki para disa vjetësh? Kishte vetëm një arsye për këtë. Ndryshimi ishte bërë në përputhje me shpirtin dhe dëshirën e shqiptarëve, themeli politik i të cilëve kishte qenë gjithnjë ndarja në prijës e baronë, secili i udhëhequr nga një shef suprem. In-

tonacioni i zërit të tij ngjante çuditërisht i ri; një lloj rezervimi adoleshent davariste menjëherë idenë e një gjarpri dhome.

“I vetmi ndryshim për mua është se, në vend që të punoj tetë orë në ditë tani punoj 18 dhe mbaj përgjegjësi për gjithë shtetin. Jam një punonjës i vetëm që bëj punën time. Ky është kuptimi i mbretërisë për mua”, thoshte me një ngërdheshje komike. Mbreti sigurisht nuk e mohonte faktin se Shqipëria kishte probleme të mëdha financiare. Si mund të përballojë një familje mbretërore një komb aq i varfër? Ky kundërshtim zhvendosej me mirësjellje nga atmosfera. “Financiarisht, një mbret nuk i kushton një vendi asnjë qindarkë më shumë se një president”. Të dy kanë nevojë për një pallat.

Të dy kanë nevojë për roje. Me një buzëqeshje tjetër – e ngjyrosur me një nuancë të pavend melankolie romantike – Zogu i referohej uniformës së tij të bardhë me zbukurime floriri, e lidhur ngushtë me të. Ajo ishte blerë para se ai të merrte fronin: “Kur isha president duhej të vishesha siç ma kërkonte posti, por edhe më i varfri i shqiptarëve ka një nuancë mbretërore, ndaj tani që jam mbreti i tyre nuk është e nevojshme që ta theksoj në një ndonjë mënyrë”. Në një mënyrë kokëfortë dukej sikur ai kërkonte aprovim, edhe intimitet. Ai kishte një intonacion intim të alternuar me përmbajtjen aspak personale të përgjigjeve të tij dhe i mbante sytë e ngulur me ngulm tek i ftuari, i pavëmendshëm ndaj gumëzhimave të ndihmësve të tij që depërtonin mes dyerve të xhamit. Ishte gabim i zakonshëm që monarkia të konsiderohej si luksoze, vazhdonte më tej ai. “Adoptimi i një regjimi që i shkon më shumë për shtat vendit garanton stabilitet më të madh të brendshëm, i cili si pasojë garanton dhe mbështetje më të madhe të huaj”. Një republikë ballkanike s’kishte qenë ndonjëherë anomali. Sigurisht, mbreti i shqiptarëve nuk mendonte se i takonte e drejta hyjnore. Ai ishte një monark kushtetues, i cili e kuptonte se pushteti i tij vinte nga njerëzit.

Kjo nënkuptonte një regjim të lirë dhe demokratik?

Zogu ishte gati të tundte kokën në shenjë miratimi, kur i kujtohej se të huajt kishin zakonisht ngatërrueshëm të ulnin e ngrinin kokën për të pohuar dhe të tundin kokën

anash për të mohuar. Ai sforcohej për të lëvizur kokën poshtë-lart. “Si mbret i popullit tim unë nuk kam asnjë interes se cila parti fiton dhomën e lartë përmes metodave kushtetuese. Kjo do të ndihmojë në edukimin e njerëzve sipas linjave demokratike, si në SHBA dhe do të sigurojë liri më të madhe për të gjithë”.

Kishte parti politike në Shqipëri?

Jo në kuptimin formal për momentin, rrëfente ai. Për momentin, mbreti i shqiptarëve duhej të ishte lideri dhe mësuesi i popullit të tij. Zhvillimi i vërtetë politik, do kohë. “Nuk mund të mësohet një fëmijë pesë vjeç njësoj siç mund të mësohet një i rritur. Vetëm me vazhdimin e luftës ndaj analfabetizmit, fuqitë dhe përgjegjësitë e njerëzve të zgjedhur si përfaqësues, mund të rriten.” Progres i konsiderueshëm ishte bërë në arsim, theksohej ai. Jo shumë kohë më parë, jo më shumë se dy mijë fëmijë shkonin në shkollë. Sot, ky numër ishte rreth 60 mijë.

Kur do të fitojnë femrat shqiptare të drejta të barabarta politike?

“Statusi i lartë e femrave është një prej faktorëve kryesorë në forcimin e një shteti”, deklaronte me bindje Zogu. “Mendoj se do të ndjej përmbushjen e misionit më të madh të jetës sime, kur statusi dhe kultura e femrave në Shqipëri të arrijë majat, fillimisht në lartësinë e vendeve të tjera ballkanike e më pas në nivelin e femrave të botës perëndimore”. Të drejtat politike ishin vetëm një segment i procesit. “Unë dua t’i arsimoj femrat, por dua dhe t’u mësoj të jenë nëna e shtëpiake të mira. Unë dua që femrat shqiptare të jenë gra të mira si ajo”. Ai e kthente karrigen dhe përkulej lehtësisht ndaj portretit që varej në murin pas tij, i vetmi portret në dhomë në fakt.


Mbreti Zog me Nënë Mbretëreshë dhe tre nga motrat e tij, të veshur me kostumin kombëtar “Ajo është nëna ime”, shpjegonte ai me ndjenjë dhe ndalej një moment për të vënë rregull në mendimet e tij e për të ndezur një cigare tjetër. Poligamia dhe fejesa në djep ishin ndaluar tashmë dhe shumë shpejt do hiqej dhe perçja. “Do jetë një proces i gjatë sepse na duhet të çrrënjosisim shumë paragjykimet e menjëherë më pas do të vijë dhe e drejta e votimit për femrat. E drejta e votës për gratë është një fenomen i ri dhe në shoqëritë më të

avancuara, kujtoni. “Ne jemi shekuj pas Evropës për sa i përket civilizimit”, vërente Mbreti me një rruddhje vetullash. Kushdo mund ta dallonte se subjektet e tij të bisedës ishin injoranca dhe progresi. Nuk ishte faji i tyre. Sundimi turk deri në vitin 1912 i kishte lënë ndjenjat, moralin dhe metodat bujqësore të Mesjetës. Nëse vizitori udhëtonte në male, ai do shokohej me kushtet më të varfra të jetesës që mund të gjendeshin në Evropë. “Më vjen shumë turp nga kjo ndonjëherë”, psherëtinte ai. “Justifikimi ynë i vetëm është se nuk i bëjmë dot të gjitha njëherësh”. Pesëqind vjet qëndrim në vend, duhej të ç’bëheshin në një farë mënyre. “Është qëllimi im që të civilizoj njerëzit e mi dhe t’i bëj me sa të mundem që të përftojnë zakonet dhe traditat perëndimore”. Gjakk marrja mund të jetë e pranishme në vende të ndryshme të mbretërisë, por ligji dhe rregulli kishin bërë progres të madh së fundmi. Mbreti thoshte ftohtë se dhe ai vetë ishte objekt i shumë armiqësive, e asnjë prej tyre s’kishte pasur sukses. Në një pikë të intervistës, Mbreti e linte cigaren dhe përkulje lehtë me vështrim reflektues ndër sy.

Duke vënë duart e bardha delikate në tryezë, ai fliste butë dhe ndershmërisht: “Unë do u mbetem besnik interesave të Shqipërisë dhe mirëqenies së popullit të saj, edhe nëse më duhet të sakrifikoj jetën. Nëse këto fjalë nuk justifikojnë veprimet e mia, atëherë gjithçka kam bërë deri tani për vendin tim, është thjesht shtirje”. Kushdo që s’ishte bindur nga ndershmëria e Zogut deri në këtë pikë, mbase s’do bindet kurrë. Sidoqoftë, vizitori i sjellshëm i uronte suksese në misionin e tij. Ministër i Brendshëm në moshën 24-vjeçare; Kryeministër në moshën 27-vjeçare; President në moshën 29-vjeçare dhe mbret në moshën 32-vjeçare – ai me siguri që kishte punuar fort për konsolidimin e kombit shqiptar. Sovrani i kënaqur falënderonte më pas vizitorin për mendjemprehtësinë e tij. Qeveritë e huaja, fatkeqësisht nuk ishin gjithnjë aq të shpejta për të vlerësuar punën e tij. Shqipëria ishte një vend i vogël, thuajse aq sa Uells apo Nju Xhersi: 354 kilometra e gjatë dhe 144 e gjerë. Por Zogu insistonte se pozicioni në hyrje të detit Adriatik, i jepte rëndësi strategjike të rëndësishme.

“Pavarësia e Shqipërisë është thelbësore për paqen në Evropë”, pohonte ai. Duhet të jetë një shtet neutral, i përhershëm si Zvicra. Ky krahasim mund të çohet dhe më tej. Ëndrra e tij ishte që një ditë, rrugët dhe hotelet e reja e të bukura, do ta kthenin “Hirushe” e tij në një destinacion turistik të lakmuar, duke ofruar edhe ski alpine, edhe plazhe mesdhetare.

(Shkëputur nga libri “King Zog: self-made monarch of Albania”)



Të tjerët për ne

Shqiptarët sipas penave të arta franceze

Në krahasim me britanikët, gjermanët dhe italianët, politikisht apo për arsye gjeostrategjike, gjykimi francez për ne është më pak i ngarkuari me interes deformues të imazhit. Që në vitin 1877, një shekull e gjysmë shkuar, francezi Lui Bonljë (Louis Beonleë), kur botoi librin e tij interesant “La Grèce avant les Grecs” (“Greqia përpara grekëve”), u shpreh se emri shqiptar ngjasonte me fjalën shqiptoj



Ylli POLOVINA

Fotaq Andrea, në fillim të viteve dymijë ambasador i Republikës së Shqipërisë pranë Këshillit të Evropës në Strazburg, është njëkohësisht një përkthyes e sidomos studiues mjaft original i historisë kombëtare. Njëri prej librave të tij, të cilit i ka ardhur koha të ribotohet, titullohet “Pena të arta franceze për shqiptarët”. Duhet thënë se, në krahasim me britanikët, gjermanët dhe italianët, politikisht apo për arsye gjeostrategjike, gjykimi francez për ne është më pak i ngarkuari me interes deformues të imazhit. Që në vitin 1877, një shekull e gjysmë shkuar, francezi Lui Bonljë (Louis Beonleë), kur botoi librin e tij interesant “La Grèce avant les Grecs” (“Greqia përpara grekëve”), u shpreh se emri shqiptar ngjasonte me fjalën shqiptoj, por kjo që një pikëpamje të cilën e braktisi shumë shpejt dhe nguli këmbë tek varianti shqiptar-shqiponjë. Doemos më shumë se saktësi shkencë që shprehje mirësie për ne. Në këtë mjedis dashamirës dramaturgu, romancieri dhe moralisti Charl-Jozef de Linjë (1735-1814) (Charles-Joseph de Ligne) në shkrimin “Batalioni i shqiptarkave”, përshkruan “dyqind gra dhe vasha bukurishte, me dyflekë, bajoneta dhe heshta, me flokë të gjatë e të gërshetuar hijshëm...”. Ai vë në dukje se popullit që ato i përkisnin “as që ka këtu lypsa apo përdërës”. Ambasadori i Francës në Kostandinopojë, Konti Shuasël-Gufjë (1752-1817) (Le Comte de Choiseul-Gouffier), spikaste për shqiptarët: “Janë të gjithë shtatllartë, të dobët, të shkathët dhe tërë nerv”.

Konti Lamartin në një rast tjetër definon: “Çdo qytet, çdo krahinë, çdo fshat, njëjhte një princ, një fisnik, një bej, që qeveris despotikisht, sipas traditave dhe zakonëve. Ky nënshtrim i qyteteve, krahinave, fshatrave, para fisnikëve apo princërve të tyre feudalë nuk cenonte aspak ndjenjën e lirisë së përgjithshme dhe pasionin e patriotizmit, qëllim i lartë tek shqiptarët”. Baroni Feliks de Bozhur (1765-1836) (Fe-

lix de Beoujour), emri i vërtetë i të cilit që Lui Ogyst Feri (Louis Auguste Feris), politikan i ngarkuar me misionë diplomatike por në kohën e vet edhe deputet i qytetit të Marsejës, në nderim të të cilit Akademia e Shkencave Morale dhe Politike të Francës jep një çmim, theksonte se “Shqipëria i ngjason Zvicrës për nga malet e saj dhe është më shumë e mbrojtur nga natyra se nga arti i luftës”.

Dijetari, historiani, natyralisti, arkeologu, diplomati, për shumë vite edhe konsulli francez pranë Ali Pashë Tepelenës, Fransua Pukëvil (1770-1838) (François Pouqueville), pa dyshim një ndër ata të huaj që na kanë njohur më mirë, ndërsa ka këmbëngulur se “Shqiptarët janë njerëz të maleve”, është shprehur po ashtu: “Nuk përdorin art për t’u maskuar”. Ai ka vënë re se “Sapo u krijohet mundësia të vendosen në një ofiq, mendjen e kanë tek të ardhurat që do nxjerrin...”

Pukëvil nuk ka harruar të vërë në dukje: “Gjithë entuziazëm për vendin e tyre, nuk flasin kurrë për të veç për ta nxjerrë mbi të tjerët...”. Ka theksuar ndërkohë: “Nuk shkojnë ndër mend vuajtjet që kanë kaluar..., rreziqet e vazhdueshme që i kanosnin, por pavarësinë që gëzonin...”

Fransua Pukëvili ka qenë i mendimit se “Shqiptarët krijojnë një trupë kombësie më vete”, se “në mërgim mbeten, gjithë mburrje, shqiptarë me zemër dhe me emër”. Ndërkohë spikat: “trupit i zakonit i këtij kombi të ashpër e të fortë... të nënshtruar, por pa qenë skllevër”. Ose nxjerr në pah për çdo lexues të huaj se shqiptarët janë “Më shpejt të nënshtruar ndaj autoritetit, më pak të lirë, por të pasur”.

Pukëvil nuk harron të

shkruajë se “Shqiptari i paaftë për mendje të zezë, nuk ushtron kurrfarë despotizmi ndaj grave; kurrë nuk i mbyll brenda dhe ato i qepen malit fytyrëzbuluar...”

Fransua Viktor Lamar-Pikò (1787-1865) (François Victor Lamare-Picquot), ndihmësmjek ushtarak me misionë në Korfuz dhe në Janinë, i dekoruar me Legjionin e Nderit, ka vënë dukje se “Gjithë banorët e tjerë të Epirit quhen përgjithësisht shqiptarë apo epirotë. Edhe pse janë me zemër të gurtë, nuk është se janë pa cilësi, sado të egra të shfaqen”. Spikat po ashtu: “Hakmarja e shqiptarit është e pamëshirshme, por miqësia e tij është më se e sigurt”.

Vëren: “Ka një guxim të pashoq në çdo sprovë. Asgjë nuk mund të krahosohet me shpejtësinë e marshimit të shqiptarëve dhe ushqimi më i paktë, një kokër hudhër, pak djathë dhe, u mjafton për të tërë ditën”.

Njëkohësisht ravijëzon se “Gratë shqiptare punojnë tokën dhe shpesh u bëjnë ballë rreziqeve për-rah burrave; por këta nuk i ndihmojnë asnjëherë në punët e vështira që bëjnë; madje rrinë dhe i vështrojnë në mundin e tyre, pa u dhënë kurrfarë ndihme...”

Fransua Viktor Lamar-Pikò ngul këmbë se “Luftarakë nga karakteri, shqiptarët vlerësojnë për zbulurim veç armët”. Po ashtu thekson: “Shqiptarët kanë një muzikë me ritëm shumë të thyer...Kjo muzikë me ashpërsinë e vet duket sikur vjen nga malet ku banojnë këta popuj barbarë”.

I lindur në 1807, një tjetër frank, studiuesi, gjuhëtar, profesori i letërsisë dhe i gjuhëve sllave në Kolegjin e Francës, Siprien Rober (Cyprien Robert), ka shpallur këtë mendim për

“homo albanicus”: “Naiviteti i tyre bie në sy në krejt veprimet që bëjnë: të pafuqishëm për t’u maskuar, ata e shpallin çiltërsisht si urrejtjen ashtu edhe miqësinë e tyre; shumë të butë në marrëdhëniet e zakonshme, ndonëse të zymtë dhe të heshtur, ata kanë të metën që s’dinë të falin”. Ndërkohë vë në dukje: “Kryesisht njerëz të punës, ata rrëmbejnë armët vetëm kur e shohin pisk”.

Agyste Mejlan (1840-1897) (Auguste Meylan), udhëpërshkruar dhe pamfletist, është i mendimit se “Fiset shqiptare kanë për prijtës kapitenë apo bajraktarë që gëzojnë një autoritet shumë më të gjerë se vajvodët e fiseve sllave...”. Në vijim: “Zakonet shqiptare janë tepër të çuditshme dhe nuk kanë lidhje me ato të popullatave të tjera të Ballkanit. I guximshëm, i pavarur, krenar për lirinë e tij, shqiptari, qoftë i krishterë, qoftë mysliman, kërkon të jetojë i lirë dhe i qetë në malet e veta. Nuk pranon as tiraninë e Kostandinopojës, as sundimin sllav. I përmbahet riteve, zakoneve e traditave të veta dhe-gjë e çuditshme-has në Shqipëri shqiptarë myslimanë, ortodoksë katolikë, grekë e katolikë romakë”.

Në vitet 1873-74 Alber Dymon (Albert Dumont), studiues e udhërrëfyes, botoi veprën “Ballkani dhe Adriatiku”. Në të thotë: “Shqipja është një gjuhë indoevropiane, që për nga rrënjët e fjalëve afrohet shumë më tepër me latinishten se sa me greqishten”. Ai ka vënë në dukje gjithashtu se “Shqiptarët e malit asnjëherë nuk i janë nënshtruar kujt”. Alber Dymon spikat edhe këto fjalë: “Vendi është i ndarë në klane që administrohen sipas dëshirës, ose më mirë që jetojnë sipas dëshirës nga që fjala administrohen nuk shkon në këtë rast”.

Zhak Elizé Reklus (1830-1905) (Jacques Élisée Reclus) ka qenë një gjeograf i famshëm francez, por edhe anarkist po aq i njohur. Pjesëmarrës në revolucionin e Komunës së Parisit, më pas shok i ngushtë me bolshevikun Sergej Bakunin, ai hartoi, përveç shumëvëllimëshit “Gjeografia e Re Universale” (“Nouvelle Géographie Universelle”, edhe botime mbi anarkizmin. Reklus ishte i bindur se komunizmi prej natyrës së tij që anarkist, popull dhe njerëz të lirë pa asnjë qeveri. Njerëzimi, ngulte këmbë ai, tërë jetën ka ndjekur dy qëllime të tij kryesore: lirinë ekonomike dhe politike. Pikërisht ky gjeograf shumë i njohur në botë dhe që për pikëpamjet e tij anarkiste dhe subversive pati qenë i burgosur vazhdimisht, ka shkruar për popullin tonë.

Dy nga formulimet e tij janë: “Shqiptarët dallohen në përgjithësi për mprehtësinë dhe finesën e shpirtit, për qartësinë e mendimit dhe forcën e karakterit” dhe “Mikpritës, të përkorë e të qëndrueshëm, këta janë në përgjithësi shqiptarët, popullsia e të cilëve, e shpërndarë mbi një territor gati sa ai i Zvicrës, nuk i arrin të një milion banorët. Po prapë, hijeshia e Shqipërisë nuk qëndron thjesht në bukurinë e pejsazheve dhe në karakterin simpatik të shqiptarëve”.

Rënë Pinon (René Pinon), shkrimtar, historian dhe analist, në vitin 1911 shkruante se “...shqiptari është mbret i maleve; gjuetar, bari, ushtar apo kaçak...ai i bindet vetëm zakoneve të tij dhe fatin e lidh me pushkën që mban. Roli i tij historik është i lidhur ngushtë me natyrën e vet dhe kjo me atë të vendit të tij”. Njëkohësisht Pinon është shprehur se “Vetëm shqiptari, nga tërë popujt e Evropës, ka përshkruar historinë dhe ka mbetur i ngjashëm me vetveten”. Sipas tij “Iliria nuk ka histori të veçantë, por njerëzit që lindin në të janë të famshëm për energjinë e tyre disi brutale, aftësinë e tyre për luftë dhe për funksione publike...” Pinon është i mendimit se shqiptari është “I shkathët për të arritur caqet e nderimit dhe të përfitimit, është njeriu i vendosmërisë dhe i pasurisë”. Shqipëria nuk është vendi më i varfër i Evropës, por një vend i pasur i varfëruar.

Baroni Pol d’Esturnel (Paul d’Estournelle de Co-

stant), senator e mbi të gjitha i vlerësuar me çmimin “Nobel i Paqes” në vitin 1909, i ndodhi që në 1914 të udhëhiqte një mision ekspertizë në Ballkan. Për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve në arenën ndërkombëtare ai bashkëpunoi shumë ngushtë me mikun e madh të popullit tonë, bashkëkombësin e vet Zhysten Godar (Justin-Godart). Senatori Pol në vitin 1914, në 15 mars, ditë e diel, në faqen e parë gazeta “Le Petit Journal” botoi editorialin “Pashallarët favorizojnë banditizmin...” Opinioni i redaksisë për shqiptarët ishte ky: “Kjo është racë energjike dhe e fortë, fatet e të cilës ndoshta do jenë të shkëlqyeshme në të ardhmen nëse qytetërimi i dobishëm vjen fatmirësisht për të ndryshuar karakterin dhe zakonet e tij”.

Profesori i historisë së mesjetës në Universitetin e Parisit X të Nanterres, specialist për çështjet e Mesdheut dhe drejtor i Qendrës së Historisë Shoqërore të Kulturave për Perëndimin, Henri Bresh (Henri Bresc) në vitin 1939 është shprehur: “E megjithatë ndjenja e origjinës dhe e veçantisë së tyre mbetet shumë e fortë; nuk ngatërrohen as me grekët, as me sllavët fqinjë”.

Natali Klejë (Nathalie Clayer), aktualisht studiuese e specializuar në Qendrën e Historisë të Studiimeve të Larta në Shkencat Shoqërore në Paris, vështuar historikisht, ka këtë opinion të palëkundur për shqiptarët: “Nuk ishin servilë, ishin të guximshëm dhe parapëlqenin zanatin e armëve”.

Zhilber Gard (Gilbert Gardes), historiani i artit, ish-sekretar i Përgjithshëm i Qendrës Kërkimore Kombëtare Shkencore, drejtor i promovimit të Kulturës së Shoqërisë Bashkimi Shqiptar, autor në 1995 i librit “Udhërrëfyes për Shqipërinë” (“Guide per l’Albanie”), botimi më i plotë dhe më i shitur i këtij profili për vendin tonë, shpall se “Shqipëria nuk është vendi më i varfër i Evropës”, por një vend i pasur i varfëruar. E pasur nga toka e nëntoka, e pasur me trashëgimi kulturore origjinale”. Po ashtu tërheq vëmendjen e çdo lexuesi se “Shqiptarët nuk janë hordhi leckamanësh të uritur e të krisur, që lypin deryve të Evropës. Shqiptarët janë një komb me diasporë të përherëshme, që gjithmonë i ka dhënë gjallëri vendeve që kanë përfutur. Ndershmëria, respektimi i fjalës së dhënë, mikpritja, siguria në marrëdhëniet e ndërsjella, vlera tradicionale që arrijnë kulmin më të lartë në qytetërimin shqiptar janë përherë të rrënjësura në shtresat e thella të popullsisë”. “Shtëpia e shqiptarit, ngul këmbë Zhilber Gard, është vatra e mikut dhe e udhëtarit”.

LAMARTIN

Konti Lamartin (1760-1869), një nga poetët më të mëdhenj romantikë të vendit të vet, autor i 30 librave dhe në të njëjtën kohë edhe politikan, diplomat e deputet, ka nxjerrë në pah se “E vetmja gjë e pandryshueshme tek shqiptarët është pasioni i tyre për pavarësi e lavdi. Ky pasion i lavdisë është tipari sundues i karakterit të tyre dhe burimi i heroizmit: është toka e heronjve në të tërë kohërat”. Po ashtu ai vinte në dukje: “Disiplina tepër e rregullt e ushtrive evropiane u rëndon, parapëlqejnë shkëlqimin e bëmave vetjake... qytetërimin që i lejon skllevërit të ngjiten, sipas trillit të të parit të tyre”.

DYMÀ

Aleksandër Dymà (1802-1870), autor i mbi 120 librave, ka përshkruar historinë dhe ka mbetur i ngjashëm me vetveten, kur përshkruan shqiptarët: “Shqipëria është një nga provincat më të vështira për t’u shfrytëzuar. Banorët e saj ishin mjaft të varfër, shumë të vendosur dhe, nga ana tjetër të fshehur natyrshëm në vargmalet të ashpra. Pashallarët e kishin shumë të vështirë të bënin aty pasuri, sepse secili e kishte zakon të mbronte energjikisht bukën e vet. Muhamedanë apo të krishterë, shqiptarët ishin të gjithë ushtarë”.

Deri ku do shkojë kriza e Katalunjës



Bernard GUETTA

Ka ardhur koha për të thënë mjaft. Duhet dialog. I shërben Spanjës, Katalunjës dhe Bashkimit Evropian, në të cilin Spanja është ekonomia e katërt

Është një mekanizëm që mund t'ju shpjerë larg, shumë larg. Të enjten në mëngjes, pak para skadimit të ultimatumit të nisur nga Spanja, presidenti i Katalunjës Carles Puigdemont tha se nëse Madridi vazhdon të kundërshtojnë rrugën e dialogut, "parlamenti i Katalunjës do të vazhdojë të votojë një shpallje zyrtare formale të pavarësisë, e cila nuk u votua" gjatë seancës së fundit.

Nëse fjalët kanë kuptim, Puigdemont sapo ka njoftuar kryeministrin spanjoll, për atë që Rajoy i kishte kërkuar të vinte në dukje, pra që nuk ka pasur asnjë shpallje të pavarësisë (gjë e cila është e vërtetë), që mund të vijë një e tillë, por që në ndërkohë, dialogu mes Madridit dhe Barcelonës mbetet i mundur.

Mariano Rajoy mund të propozojë hapjen e menjëhershme të negociatave, dhe në anën tjetër, duke qenë se Presidenti i Katalunjës vazhdon të mbajë një qëndrim të paqartë, Këshilli i Ministrave i Spanjës do të vendosë sot, se si të zbatohet nenin 155 të Kushtetutës, i cili do të pezullonte autonominë katalanase, në mesin e javës së ardhshme.

Nëse me të vërtetë do të shkohet kaq larg dhe papritmas parlamenti i Katalunjës do të shpallë pavarësinë, Madridi do të duhet të përballet me një lëvizje proteste dhe të vazhdojë me arrestime të reja, të cilat do të përforcojnë polemikat duke acaruar palët. Independentistët më radikalë, në atë pikë do të kenë fituar dhe do ta shtyjnë Madridin të sillet si një pushtues, duke e bërë Katalunjën një koloni, dy kushte të cilat do të lejonin Barcelonën të thërriste në ndihmë të drejtën për vetëvendosje.

Nëse gjërat do të shkonin kështu, jo vetëm Spanja dhe Katalunja do të mbërrinin në një qorrsokak, prej ku do të ishte e vështirë të dilnin, por kjo krizë mund të degjeronte shpejt në dhunë, pasi të dy palët do të udhëhiqeshin vetëm prej pasioneve të ndezura.

Kjo është një situatë shumë shqetësuese, sepse dialogu duket gjithnjë e më i paimagjinueshëm mes katalanasve dhe pjesës tjetër të Spanjës, me të parët që kanë shkelur ligjin dhe të dytët, që kanë bërë gjithçka për të justifikuar radikalizimin e independentistëve.

Ka ardhur koha për të thënë mjaft. Duhet dialog. I shërben Spanjës, Katalunjës dhe Bashkimit Evropian, në të cilin Spanja është ekonomia e katërt. Nëse ky dialog nuk arrin në një kompromis, do u takojë votuesve të marrin një pozicion, me shumicë të cilësuar, sepse një vendim i tillë nuk mund të merret me 51 për qind të votave. Ne duhet t'i braktisim këto qëndrime vetëvendosëse, dhe 26 udhëheqësit e tjerë evropianë duhet të kontribuojnë më shumë, në vend se të përqafojnë verbërisht intransigjencën e madrilenasve. (France Inter)



Shaban MURATI

Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë regjistruan në datën 19 tetor ndërhyrjen më flagrante në punët e brendshme të Shqipërisë nga qeveria e Athinës këto dhjetë vitet e fundit. Deri tani ndërhyrjet e Greqisë në punët e brendshme të Shqipërisë janë ndërmarrë nën pretekstin e mbrojtjes së interesave të pakicës greke. Por është hera e parë që Ministria e Jashtme e Greqisë në një komunikatë zyrtare ndërhyr në çështjet e brendshme të jetës politike shqiptare. Komunikata e MPJ të Greqisë në 19 tetor përfaqëson një ndërhyrje të pashoqe në zhvillimet e brendshme shqiptare dhe kjo dëshmohet me sulmin që nis qysh në paragrafin e parë të saj. Ja komunikata e MPJ të Greqisë e botuar në faqen e saj zyrtare: "Lidhja e dukshme midis krimin të organizuar dhe skenës politike në Shqipëri, siç tregon arrestimi i fundit i kreut të një rrjeti të trafikut të drogave, që ndodhi të jetë një kushëri i dikujt, i cili deri kohët e fundit ishte ministri kryesor në qeverinë Rama, krijon shqetësim". Është e pazakontë në praktikën diplomatike midis dy shteteve, që janë anëtare të NATO-s dhe të cilin Shqipëria e ka shpallur aleat strategjik, të ndërhyhet dhe të akuzohet zyrtarisht Shqipëria për lidhjen e krimin të organizuar me skenën politike. Nuk ka se çfarë i duhet MPJ të Greqisë se çfarë ndodh në skenën politike të shtetit tonë, gjë që është problem ekskluzivisht i brendshëm i shtetit tonë. Nuk ka tagër

Nuk bisedohet me Greqinë në këto kushte

I ashtuqajhuri shqetësim i Athinës për jetën e brendshme politike në Shqipëri është pretendim për rolin e protektorit mbi Shqipërinë

diplomatik MPJ e Greqisë të japë verdikte zyrtare dhe publike mbi "lidhjet e krimin të organizuar me skenën politike shqiptare". Është anormale nga pikëpamja diplomatike që MPJ e Greqisë sulmon me emër kryeministrin e Shqipërisë për anëtarët e kabinetit shqiptar, që ai ka zgjedhur. I ashtuqajhuri shqetësim i Athinës për jetën e brendshme politike në Shqipëri është pretendim për rolin e protektorit mbi Shqipërinë.

Rituali i komunikatave dhe i deklaratave të MPJ të Greqisë me ndërhyrje në punët e brendshme të Shqipërisë është bërë kaq frenetik nga qeveria Cipras-Kocias sa mund të thuhet se ka numrin më të lartë në krahasim me qeveritë e mëparshme greke. Vetëm në muajin tetor janë dy deklaratatë të MPJ të Greqisë kundër Shqipërisë. Në dy muajt e fundit Presidenti i Greqisë ka dalë tri herë me deklaratatë ndërhyrje të drejtpërdrejtë në punët e brendshme të Shqipërisë, madje duke sulmuar Shqipërinë dhe Kosovën bashkë. Ky është stili aktual i sjelljes së diplo-

macisë greke për marrëdhëniet me Shqipërinë. Ajo që tërhoqi vëmendjen tonë lidhur me komunikatën e 19 tetorit është së pari flagranca e ndërhyrjes në jetën e brendshme politike të Shqipërisë dhe së dyti, koha kur MPJ e Greqisë zgjodhi të shpallë zyrtarisht "shqetësimet" për zhvillimet e brendshme politike në vendin tonë. Pala greke ka njoftuar se muajin e ardhshëm MPJ e Greqisë dhe MEPJ e Shqipërisë do të zhvillojnë në Kretë të Greqisë bisedime dypalëshe për problemet e pazgjidhura në marrëdhëniet midis dy vendeve. Parimisht është pozitive të mbahen hapur kanalet e komunikimit diplomatik dhe të zhvillohen rregullisht takime e bisedime. Por, mësimi bazë i diplomacisë është se që të zhvillohen bisedime të suksesshme për kapërcimin e krizave dhe të problemeve të pazgjidhura historike dhe jo bisedime për hir të bisedimeve është e domosdoshme të krijohen kushtet dhe klima e përshtatshme për ato bisedime. A mund të thuhet se ekziston aktualisht kjo klimë dhe a e premtom ajo klimë një rezultat pozitiv të bisedimeve të ardhshme? Vështirë të pohohet kjo, pas dy deklaratave ndërhyrëse në punët e brendshme të Shqipërisë, që ka bërë MPJ e Greqisë në 19 dhe në 15 tetor. Veçanërisht deklarata e 19 tetorit 2017 me pretendimin për "shqetësimet" greke për çështjet e brendshme të jetës politike shqiptare dhe me një goditje

me emër ndaj kryeministrin shqiptar e ka mbushur me hithra rrugën e bisedimeve dypalëshe të muajit të ardhshëm.

Nuk është shenjë e vullnetit të mirë nga MPJ e Greqisë, zgjedhja e datës 19 tetor për shpalljen e komunikatës së saj, ku ndërhyrjen për një çështje të brendshme politike në Shqipëri nuk e ka dhënë ende fjalën e saj. Duke vlerësuar nga një pozicion jomiqësor se qeveria e Shqipërisë ndodhet në një moment të vështirë të brendshëm, diplomacia greke dhe qeveria greke nxitojnë të shfaqen si faktor i jetës politike dhe i zhvillimeve të brendshme në Shqipëri. Ata marrin rolin e palës në jetën e brendshme politike shqiptare, sikur të jenë një forcë politike shqiptare, që ka të drejtë të shprehë zyrtarisht vlerësime për çka po ngjet në jetën parlamentare dhe politike të vendit tonë.

Akti i MPJ të Greqisë është një presion i drejtpërdrejtë mbi drejtësinë shqiptare. Është një presion i drejtpërdrejtë mbi parlamentin e Shqipërisë, që atë ditë në 19 tetor zhvillonte mbledhjen e këshillit parlamentar të mandateve. Është presion mbi partitë politike shqiptare për të nxitur konfliktin politik midis tyre dhe për të diktuar qëndrimin e qeverisë greke. Është presion mbi Shqipërinë që t'i trajtojë çështjet e saj të brendshme politike, ashtu siç i don Athina. Është presion për ta bërë Shqipërinë që të shkojë

Europa ime: Ç'është atdheu?



Dana GRIGORCEA

Në një "Mauerparty" në një diskotekë me vulat "Lindje" dhe "Perëndim" shkrimtarja zvicerano-rumune Dana Grigorcea ka konstatuar, se atdheu është në radhë të parë vendi, në të cilin mund të vesh diçka në lëvizje.

Përkatesisht personit i vihej një vulë lindjeje ose perëndimi në kyçin e dorës. Pas kësaj secili futej në gjysmën "e vet të sallës". Në mesnatë me eufori të madhe muri rrëzohej, Lindja dhe Perëndimi përzheshin bashkë dhe të gjithë kërcenin me të njëjtën muzikë nga hitet aktuale.

Le të kthehemi në fillim. Kur mua më pyetën në hyrje, nga vij, për mua ishte e qartë:

Unë kam lindur në Rumani, pra nga bloku lindor. Mua më vunë vulën e lindjes dhe shkova në gjysmën lindore të diskotekës. E shpenguar unë kërcëja me muzikën e marsheve, tekstet patriotike të të cilave më bënin për të qeshur dhe më preknin njëkohësisht. Dikur pashë nga dera dhe më zuri syri studentët e mi, që ende të veshur me pardesy përpiqeshin të negocionin me rojen tek dera. Ata e kundërshtonin lojën me vulat dhe donin që për paratë që kishin paguar të kishin të drejtë të hynin si në gjysmën "lindore" ashtu edhe në atë "perëndimore" të sallës. "Ne vijmë nga Zvicra", tha njëri prej tyre, me shumë seriozitet dhe pa shaka, "ne jemi neutralë". Unë u kërkova atyre që të hyjnë në gjysmën perëndimore të diskotekës, sepse në mesnatë gjithsesi do të bashkoheshim

sërisht e do të kërcënim të gjithë bashkë.

"Çdo njeri ka identitete të ndryshme"

Por studentët u zemëruan me mua. Sepse unë kisha lejuar të më vinin vulën, përpara se ta kisha konsultuar këtë me ta. Unë bëja pjesë në grupin e tyre, dhe ne do të duhej që në frymën e zgjidhjes bashkarisht të problemit të ishim konsultuar për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme për të gjithë.

Ky episod më bëri mua që ta ripërkufizoj konceptin atdhe: përtej vulave dhe muzikës nga vendlindja, atdheu është vendi, në të cilin mund të vesh diçka në lëvizje, në të cilin mund të kontribuosh si qytetar. Si nënshtetase e dyfishtë rumuno-zvicerane unë dua të citoj këtu përkufizimin

kokulur në bisedimet e ardhshme me Greqinë. Me një fjalë, MPJ e Greqisë del në rolin e protektorit mbi politikën dhe mbi shtetin shqiptar. Ky raport asimetric, plagë e vjetër e marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Greqisë gjatë 25 viteve të tranzicionit shqiptar, shfaqet me megalomani jo rastësisht në prag të bisedimeve midis dy shteteve muajin e ardhshëm. Kjo është klima dhe këto janë konditat atmosferike diplomatike, me të cilat Greqia po përgatit mbajtjen e këtyre bisedimeve dypalëshe. Kjo është fryma dhe mentaliteti, me të cilat MPJ e Greqisë dhe ministri i saj i Jashtëm do të përipiqen të imponojnë drejtimin dhe përmbajtjen e bisedimeve. Ky është pozicioni hierarkik, me të cilin diplomacia greke dhe qeveria greke do të trajtojnë problemet e pazgjidhura midis dy shteteve. Kjo frymë tregon se i ashtuquajtur i mekanizëm dypalësh i zgjidhjes së problemeve të hapura midis dy shteteve, që ministri i Jashtëm grek Kocias e serviri që në vitin 2015 si çelësin magjik të zgjidhjes së problemeve, do të ndjekë fatin e komisionit të famshëm dypalësh, që krijuan në vitin 2004 dy qeveritë për të zgjidhur problemet e hapura midis dy shteteve. Ai komision jo vetëm nuk zgjidhi, por nuk u mblodh asnjëherë. Tani ka një përparim se komisioni i vjetër quhet nga Kocias "mekanizëm dypalësh", të cilin diplomacia greke dhe Kocias e kanë konceptuar si modelim i zgjidhjeve me formulat greke. Mjafton të shohësh kushtet dhe ofertat e tanishme greke, në prag të bisedimeve të ardhshme dypalëshe, për dy çështje jetike të pazgjidhura të dosjes shqiptaro-greke. E para është ligji i luftës për

të cilin Kocias që në vitin 2015 në Tiranë bëri propozimin absurd që, për hatër të shqiptarëve siç tha ai, ta përfshijë në Traktatin e ri të Bashkëpunimit midis dy shteteve, në një kohë që ai është ligj grek dhe duhet ta abrogojë parlamentin i Greqisë dhe shteti grek. E dyta, është çështja çame, të cilën Kocias e përjashton kategorikisht nga bisedimet jo vetëm si zgjidhje, por edhe si shtim çështjeje në tryezën e bisedimeve. Kërkesa e Shqipërisë duhet të jetë që çështja çame të përfshihet në Traktatin e ri të Bashkëpunimit dhe të Miqësisë midis dy vendeve. Një traktat pa përfshirjen e çështjes çame nuk ka asnjë kuptim dhe nuk do të zgjidhë asnjë problem, ashtu siç nuk zgjidhi edhe traktati i mëparshëm gjatë 20 viteve. Në prag të bisedimeve, diplomacia greke vazhdon taktikat bizantine për të ofruar 5 dhe për të marrë 95, për të dhënë apostilën dhe për të mos hequr ligjin e luftës dhe efektet e tij negative mbi shqiptarët, për të ofruar sigurimet shoqërore dhe për të marrë plantacione pafund të varrezave greke në jugun e Shqipërisë, për të premtuar njohjen e Kosovës dhe për të marrë marrëveshjen e zezë të detit dhe detin shqiptar. Komunikatat e njëpasnjëshme të MPJ të Greqisë dhe të presidentit grek me ndërhyrje flagrante në punët e brendshme të Shqipërisë, që nga ligji i ndarjes territoriale e deri ligji për pakicat, rivendikimet absurde mbi Përmetin apo Himarën etj. e deri tek deklarata e 19 tetorit, që sulmon direkt qeverinë e Shqipërisë, përbëjnë sinoptikën më të qartë se çfarë moti dhe rezultati po përgatit diplomacia greke për bisedimet

dypalëshe të muajit të ardhshëm. Kjo situatë duhet ta bëjë qeverinë e Shqipërisë të mendohet seriozisht. Iluzionet apo infantilizmat e "moderimit dhe konstruktivitetit", me të cilat është nanuritur (e vetmja në Ballkan) diplomacia shqiptare gjatë 25 viteve, duke i bërë lëshime strategjike Greqisë, nuk mendoj se duhet të jenë filozofi e politikës së jashtme shqiptare në rajon. Pa simetrinë e barazisë, të dinjitetit dhe të respektit të interesave reciproke shtetërore e kombëtare, as mund të mendohet se do të ngrihet guri i Sizifit i problemeve të pazgjidhura deri në majën e fundit të lumtur. Zyrave shtetërore vendimmarrëse u mjafton të analizojnë vetëm komunikatën e 19 tetorit të MPJ të Greqisë për të parë se sa e papërshtatshme është të zhvillohen bisedime serioze dypalëshe në këto kushte. Anashkalimi i kësaj situatë do të thotë pranim i nëpërkëmbjes së dinjitetit të shtetit, do të thotë që të shkosh në duel me shpatë të thyer. Situata të tilla kërkojnë përgjegjësinë e qeverisë, por kërkojnë edhe përgjegjësinë e partive politike shqiptare në opozitë, të cilat duhet të refuzojnë miklimet bizantine, që vijin nga Athina për këtë apo atë pozicion të brendshëm politik. Çështjet e pazgjidhura midis dy shteteve janë interes jetik kombëtar dhe jo partiak dhe kërkojnë konsensusin dhe bashkëpunimin e të gjitha partive politike shqiptare, pavarësisht nga rivalitetet e brendshme midis tyre. Është rasti të kujtoj këtu se kur Silvio Berlusconi ishte kryeministër i Italisë dhe Romano Prodi ishte president i Komisionit Europian në Bruksel dhe mediat bri-

tanike ndërmorën një fushatë të ashpër disamujore kundër Romano Prodit, kryeministri Berlusconi u ngrit me forcë në mbrojtje të tij. Kur gazetarët italianë e pyetën Berluskonin pse e përkrahu armikun e tij politik dhe personal, ai u përgjigj: "Romano Prodi në Bruksel është Italia". Në këtë vizion, për interesin kombëtar duhet të bashkohen edhe partitë politike shqiptare në politikën e jashtme të Shqipërisë me njërin apo tjetrin shtet fqinj. Diplomacia greke nuk ka krijuar kushte normale për bisedimet e ardhshme dypalëshe midis dy shteteve: - Ka një ndërhyrje frenetike të pashembullt në jetën e brendshme politike dhe përpjekje greke për t'u bërë palë politike në Tiranë. Qeveria duhet të ketë kaq dijeni sa të kuptojë se kjo ndërhyrje është pjesë e strategjisë së Athinës për ndryshim regjimi në Shqipëri, e afishuar nga diplomacia greke që në vitin 2015. - Ka një sulm direkt për qeverinë e Shqipërisë. - Nuk ka asnjë sinjal fleksibiliteti për çështjet kardinale historike të pazgjidhura midis dy shteteve. - Ka një shtim të kërcënimit publik të shtetit grek mbi Shqipërinë për vendosjen e vetos në BE kundër hapjes së bisedimeve europiane me Shqipërinë. Në këto kushte pabarazie, kujtimim im për Kryeministrin e Shqipërisë është që t'i shtyjë bisedimet deri në kohën kur Athina të pastrojë retë, që ka krijuar dhe kur të demonstrojë vullnetin e mirë për të zgjidhur realisht problemet e pazgjidhura në marrëdhëniet dypalëshe. (gsh)

Për Ana Kareninën e ditëve tona



Alda BARDHYLI

Regjisori rus Karen Shakhnazorov, e rikthen Anën, duke "provokuar" një sistem, e një industri ku gratë kanë pushtuar kopertinat e revistave jo vetëm të Vogue

Nuk ka asnjëherë një të vërtetë të vetme në dashuri. Më shumë se një shekull nga koha kur Tolstoi krijoi një prej personazheve më emancipuese në historinë e letërsisë, një personazh që do të dilte nga librat duke u bërë një pamflet feminist që do të shoqëronte lëvizjet e mëvonshme feministe pas Luftës së Dytë Botërore, që do t'i jepnin gruas të drejta të mohuara prej shekujsh, regjisori rus Karen Shakhnazorov, e rikthen Anën, duke "provokuar" një sistem, e një industri ku gratë kanë pushtuar kopertinat e revistave jo vetëm të Vogue. A pasqyrojnë të vërtetën e gjendjes së grave imazhet e pasarelave apo postet e larta politike që kanë marrë pjesë e tyre? A janë ato një lexim ndryshe i "revolucionit seksual", dhe realiteti i gruas sot vijon të jetë po aq emergjent sa në Lindjen e Mesme? Shakhnazorov nuk kërkon të flasë me gjuhën e sondazheve, me kuotat e rritura në parlament apo forumet e përvitshme mbi rolin e gruas në shoqëri që vijojnë të mbahen në të gjithë botën, as në shoqatat që sigurojnë se Rusi nuk mungojnë. Ai u beson gjuhës së personazheve dhe forcës së letërsisë që gjithnjë nuk harron të na tregojë të vërtetat. Pas ekranizimit të britanikëve të Ana Kareninës më 2012 një film që mbart një nga romancat më të bukura e njëkohësisht më të angazhuar në historinë e letërave, ai i rikthehet librit të Tolstois, duke ndjekur fatet e dy personazheve kryesorë në këtë histori pas vdekjes tragjike të Anës. "Historia e Vronsky-t" është pjesa e dytë e filmit prodhim i vitit 2017, i cili tashmë ka mbërritur dhe në kinematë shqiptare. Ndërsa Tolstoi e mbyll librin me fundin tragjik të Anës, një fund që do të hapte një botë të re në gjithë mendimin konservator të shekullit të 19-të, duke treguar tragjizmin e gjendjes së gruas dhe në shoqëri të larta siç ishte ajo ku jetonte Ana Karenina, Karen Shakhnazorov, e rimerr historinë pikërisht aty ku e ka lënë Tolstoi, për të na treguar se tragjizmi ende nuk ka mbaruar. Është Sergei, i biri i Anës i rritur me pyetjet torturose mbi ikjen fatale të së ëmës, dhe Vronsky, (i dashuri) që nuk mund të heqë dot nga kujtesa gruan që e persekutoi me mungesën dhe 30 vjet më vonë, që takohen në një fshat të largët në Mañcurian, gjatë luftës ruso-japoneze më 1904. Është ky një takim fati i dy burrave që mbahen peng nga kujtimi i një gruaje. E në këtë rikthim në kohë për të gjetur secili përgjigjet mbi pyetjet që i kanë munduar aq shumë, shikuesi ka mundësi të takoj sërish nën një shkëlqim tjetër gruan e veshur me fustanet e gjata ruse, e cila u hodh në shinat e trenit për dashurinë. Një Anë që mbart guximin e jashtëzakonshëm që bota do ta zbulonte vonë të grave. Një kujtesë për shqisat e mençura të qenieve që vijojnë të përballen me të tjera dogma sot. Teksa Sergei i duhet të largohet me karrocën e fundit për të shpëtuar nga japonezët që po bombardojnë Mañcurian, Vronsky vendos të qëndrojë duke dashur të shpëtojë përgjithmonë nga hija e një gruaje që i është ngjitur në trup. Në ato minuta lamtumire, ai do t'i thotë Sergeit të vërtetën që e ka ndërjerë çdo çast për 30 vite rresht. "Ana nuk ka vdekur, ajo duhet të jetë diku. Unë nuk hoqa batanijen për të parë trupin e saj në stacionin e trenit". Kjo metaforë e Karen Shakhnazorov, që kërkon të ringjallë personazhin që Tolstoi e hodhi në shinat e trenit pikërisht në stacionin ku u njoh për herë të parë me Vronskin, si shuplaka që do të trazonte konturet e shekullit XIX-XX, duke i dhënë femrës të tjerë ekuilibra, është ndoshta një prej të vërtetave më tragjike të këtij shekulli. Gratë vijojnë ende sot të përballen me të tjera diskriminime, në një botë ku aleanca mashkullore i ka rrënjët thellë në histori. Ana vijon të jetojë ende brenda nesh, e zhveshur nga fustanet e gjatë, vargonjtë e divorcit, por me të tjera mure që ngrihen çdo ditë para saj. (mapo)

për atdheun në zyrën e integritetit në qytetin tim Zyrih: "Çdo njeri ka identitete të ndryshme dhe atdhe të ndryshëm. (...) Detyra e Zvicrës është, që do të jetë atdhe. (...) Ne na duhen shumë zvicercane dhe zvicercanë, çfarëdo që të jenë ata." Sa keq që Zvicra nuk është pjesë e BE-së. Në demokracinë zvicercane një qytetar i ri është zhvilluar në mënyrë të tillë, që mund të kontribuojë thelbësisht në diskutimin aktual që po zhvillohet në mbarë Europën lidhur me atdheun - p.sh., që atdheun në radhë të parë përfaqëson një bashkësi vlerash.

Gjuha çalon pas realitetit

Si zvicercane dhe falë atdheut tim rumun unë ndihem njëkohësisht edhe si qytetare e BE-së në situatë të privilegjuar, duke marrë përsipër një funksion ndër-lidhës. Ne përjetojmë një krizë të rëndë, shoqëritë tona vuajnë nga vrulli maramendës dhe thirrjet e tregut të kohës. Ajo që duhet tani, është një kul-

turë diskutimi. Koncepti i atdheut është në diskursin publik të botës sonë të civilizuar i ngjashëm me atë të fesë apo besimit: Ka përlësi, po, e ka gjithmonë edhe shumë që janë në kërkim, ndërsa shumica e referuesve duan që këtë temë ta shpjegojnë menjëherë si me shkop magjik e si të vlefshme për të gjithë duke përdorur fjali të spikatura, e pastaj indinjohen me të madhe për injorancën e atyre, që nuk e ndjekin retorikën e tyre. Flasin për vete duke pasur parasysh të gjithë, frika dhe nostalgjia karakterizojnë diskursin dhe megjithatë flasin me zë të lartë për një "ne" dhe për të mirën e të gjithëve, duke pretenduar se e kanë kuptuar këtë. Por në këtë kontekst gjuha çalon pas realitetit, mendohet në kategori diferencuese me koncepte të tilla si vendi i pritjes, atdheu i dytë, apo qytetarë të rinj. Në trashëgiminë tonë kulturore ne gjejmë përkufizime bukur të sakta për atdheun. Një ndër trajtimet më të preferuar të mi për

këtë temë është filmi klasik "Citizen Kane". Atje rrëfëhet historia e manjatit të medie Charles Foster Kane, që nga fëmijëria e deri tek ngjitja sociale e politike e tij, dashuritë e tij marramendëse dhe lidhjet e tij deri tek vdekja në vetmi si një njeri jashtëzakonisht i pasur. Por se çfarë do të thotë fjala e fundit e Kanes, Rosebud, reporterit, që ne e ndjekim përgjatë gjithë filmit nuk do të arrijë ta mësojë kurrë. Sepse Rosebud ishte atdheu i dashur i Kanes, të cilin e shohim shkarazi vetëm në skenat e fundit, pak para se, ai në formën e një slite nga ditët e fëmijërisë bashkë me të tjerë sende në pronësi të Kanes të vlerësuar si pa vlerë hidhet në zjarr.

Atdheu mund të gjendet kudo

Këtë ndjesi të atdheut unë e kam përshkruar edhe në romanin tim të fundit "Ndjenja primare e pafajësisë". Unë tregoj për atë, që mund të përbëjë atdheun dhe topografinë emocionale të tij. Rosebud merr

tek secili formën e vet. Ndonjëherë unë zgjohem natën dhe kërkoj në erësi të tavolinën e lartë me një këmbë të gjyshes sime, në të cilën ndodhej një kanë me ujë dhe gotat. Uji në kanën e kristaltë vezulonte dhe lëshonte rreze të ndritshme nëpër mure. Gjithçka ishte e qetë dhe miqësore, unë sërish mund të shkoja të flija e qetë në shtrat. Asnjëherë tjetër unë nuk e kam rigjetur qetësinë e atyre netëve. Njeriu rritet me atë ndjesinë primare të pafajësisë si prej të qenit i mbrojtur e naiviteti. Prej kësaj bëhesh dikush, që mund ta formësojë botën tënde sipas imazheve të parajsës së humbur: atdheu - mund të gjendet pothuajse kudo. (DW)

(Dana Grigorcea, lindur më 1979, është një shkrimtare rumuno-zvicercane dhe filologe. Më 2011 ajo debutoi me romanin "Baba Rada", që e shkroi në gjermanisht. Së fundi më 2015 është botuar romani i ri i saj "Ndjenja primare e pafajësisë")



**NAZIKTERE SULEJMANI,
KËSHILLTARE SHTETËRORE NË MASH**

REFORMA NË ARSIM, E DOMOSDOSHME

Rezultatet nga matjet e të arriturave të nxënësve janë më se dëshpëruese. Hulumtimet tregojnë se nxënësit tanë dalin nga sistemi arsimor pa i arritur kompetencat bazë. Kjo nuk do të thotë se nuk kanë njohuri, por nuk janë të aftësuar që njohuritë e fituara t'i aplikojnë në praktikë. Niveli i ulët i të arriturave të nxënësve fillon qysh nga periudha e arsimit fillor kur ata edhe duhet që të aftësohen për shkrim lexim dhe të kuptuar

Koha Delvina KËRLUKU

Naziktere SULEJMANI u lind me 24 maj të vitit 1958, në fshatin Rahovicë, Komuna e Preshevës, ku edhe ka kaluar vitet e para të femërisë. Në vitin 1964 është shpërngulur në Shkup ku ka kryer arsimin fillor, në shkollën fillore "Liria", arsimin e mesëm në Gjimnazin "Zef Lush Marku", arsimin e lartë në Fakultetin e Shkencave matematiko natyrore, dega fizikë – Shkup. Nga viti 1981- 2002 ishte profesoreshe e fizikës në Gjimnazin "Zef Lush Marku" - Shkup, në shkollën e mesme "Cvetan Dimov" – Shkup dhe shkollën e mesme "Pançe Arsovski" – Shkup. Nga viti 2002 është e punësuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës si këshilltare, udhëheqëse e njësisë dhe së fundmi nga viti 2011 si këshilltare shtetërore. Ka qenë pjesëmarrëse e shumë projekteve, grupeve punuese, seminareve, konferencave nga sfera e arsimit.

KOHA: Znj. Sulejmani, cilësia në arsimin shqip në të gjitha nivelet, duke nisur nga shkollat fillore, të mesme deri tek ato të larta, është dëshpëruese. A pajtoheni me këtë dhe cila është këshilla juaj?

SULEJMANI: Pavarësisht se a pajtohem unë ose jo, fatkeqësisht nuk mund të flasim për nivel të lartë në cilësinë e arsimit. Si çdo dashamirës i çështjes së arsimit, edhe unë jam shumë e brengosur për një situatë të kështillë. Rezultatet nga matjet e të arriturave të nxënësve janë më se dëshpëruese. Hulumtimet tregojnë se nxënësit tanë dalin nga sistemi arsimor pa i arritur kompetencat bazë. Kjo nuk do të thotë se nuk kanë njohuri, por nuk janë të aftësuar që njohuritë e fituara t'i aplikojnë në praktikë. Niveli i ulët i të arriturave të nxënësve fillon qysh nga periudha e arsimit fillor kur ata edhe duhet që të aftësohen për shkrim lexim dhe të kuptuar. Nxënësit tanë kanë problem që t'i shfrytëzojnë njohuritë e fituara për t'u përgjigjur pyetjeve që kërkojnë lidhje të më shumë informacione nga teksti i njëjtë ose nga burime të ndryshme. Që të tejkalohet kjo gjendje, nevojitet reformë gjithëpërfshirëse, duke filluar nga arsimi fillor, i mesëm si dhe ai sipëror, sidomos në programet studimore që përgatisin kuadro për mësimdhënës.

KOHA: Jeni kryetare e një grupi punues, të formuar në ministrinë e Arsimit, për të zhvilluar politikën e arsimit të integruar. Cilat janë hapat që ju ndërmerri, për përmirësimin e arsimit?

SULEJMANI: Dekadat e fundit nxënësit që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme, qofshin ata në arsimin fillor apo në të mesëm sikur po funksionojnë si në bota të ndryshme. Të ndarë nëpër objekte dhe ndërrime të ndryshme. Edhe aty ku mësimi realizohet në më shumë gjuhë mësimore, fëmijët tanë nuk kanë kontakte me moshatarët e tyre të etnitetit tjetër, thuajse nuk dinë asgjë për njëri tjetrin. Andaj, edhe nevoja për të paraparë diçka që do të nxishte një inter-aksion më të madh mes fëmijëve të etniteteve të ndryshme për mes realizimit të aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të rritjes së kohëzimit, multikulturalizmit, tolerancës, është shumë e madhe. Me qëllim të promovimit të këtyre aktiviteteve, Ministria e Arsimit dhe Shkencës po i inkurajon shkollat fillore dhe të mesme që të organizojnë aktivitete të përbashkëta jashtë mësimore në mes nxënësve të cilët ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme në nivel të shkollës apo përmes lidhjeve të partneriteteve

mes shkollave ku mësimi zhvillohet vetëm në një gjuhë mësimore që të aplikojnë në thirrjen publike që Ministria e Arsimit dhe Shkencës e shpallë njëherë në vit. Vitin e kaluar, 51 shkollë fillore dhe 14 shkollat të mesme ishin fituese të granteve me vlerë deri në 30000 denarë për realizimin e aktiviteteve që do të kontribuojnë për përmirësimin e multikulturalizmit, integritimit ndëretnik, tolerancës etj. Kjo është vetëm një stimul i vogël që u jepet shkollave por ekzistojnë edhe shumë projekte që i përkrahin këto lloje të aktiviteteve e që janë të mbështetur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vazhdimësi do të punoj për promovimin e aktiviteteve të kështilla.

KOHA: Mungesa e hapësirave, tekstet me përmbajtje skandaloze, emrat e shkollave dhe problemet me transportin falas, janë disa nga problemet më të mëdha me të cilat përballen nxënësit shqiptar. Mediat shkruajnë, populli e flet këtë problem, kuadri shqiptar në MASH, përse nuk vepron. Kush ua ka "zënë" rrugën?

SULEJMANI: Ministria e Arsimit çdo vit përpilon programet për

investime kapitale qofshin ato për ndërtim apo rekonstruim të shkollave dhe varësisht nga ajo se në cilat shkolla është gjendja më e rëndë, vendosen prioritetet se ku do të rekonstruohet gjegjësisht ndërtohet. Problemet lidhur me tekstet shkollore besoj se do të tejkalohen, edhe pse me vonesë. Po bëhen ndryshime edhe në ligjin për tekstet shkollore për arsimin fillor dhe të mesëm dhe në mënyrë më precize do të përkufizohen ato nene që u jepnin komoditet shtëpive botuese si bartës të të drejtave autoriale të vendosin se a do të bëjnë përthimin e teksteve të caktuar ose jo, varësisht nga leverdia e tyre. Do të kërkohet edhe përgjegjësi më e madhe edhe për përkthimet e bëra. Sa i përket transportit të nxënësve, me procesin e decentralizimit organizimi i transportit për nxënësit në arsimin fillor dhe atë të mesëm është në ingerencat e themeluesve, gjegjësisht komunave, të cilat financohen për mes bllok donacioneve nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Por, nevojitet menaxhim më i mirë nga ana e komunave.

KOHA: Ministria e Arsimit dhe Shkencës është institucion që krijon politikën e arsimit. Çdo projekt që futet nëpër shkolla,

kalon nëpërmjet arsimit dhe Byrosë së arsimit. Zërat janë se programet, librat, nuk përkojnë me nivelin arsimor, ose ndonjë kritikë të ngjashme. Sa janë të pranishëm përfaqësues të institucioneve arsimore, sektori civil, OJQ-të, në krijimin e politikave arsimore, ku edhe mund t'i caktojme saktësisht ku janë problemet, si në tekste, si në program, si në ngarkesën e mësimin, etj?

SULEJMANI: Ministria e Arsimit dhe Shkencës është e hapur për bashkëpunim me të gjithë ata të cilët kanë ide, propozime dhe vizion për avancimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë dhe çdo herë gjatë proceseve reformuese janë të kyçur sektori civil dhe OJQ, sindikata si dhe palët tjera të interesuara. Gjatë përpilimit të draft versionit të Strategjisë për zhvillimin e arsimit 2017-2020 kanë qenë të kyçur shumë institucione, arsimtarë dhe e njëjta ka qenë e hapur për propozime, ide nga të gjitha palët e interesuara. Ndryshimet e Ligjit për arsim fillor dhe të mesëm po ashtu do të bëhen në mënyrë shumë transparente, qoftë përmes kyçjes së drejtpërdrejtë të arsimtarëve, sindikatës, sektorit civil si gjatë procesit të përpilimit të ndryshimeve, qoftë përmes diskutimeve publike.

KOHA: Avancimi i cilësisë në arsim është synim ynë. Pa mësimdhënës të përgatitur mirë, kreativ e të aftë me nxënësit, komunikues me prindërit dhe komunitetin, nuk do të arrijmë të kemi arsimin që dëshirojmë për fëmijët tanë?

SULEJMANI: Më se e vërtetë, një nga parakushtet kryesor për të pasur cilësi në arsim është përgatitja profesionale e mësimdhënësve. Aftësimi i tyre primar për të bërë punën e mësimdhënësit gjatë studimeve si dhe trajnimit dhe ngritja e tyre e vazhdueshme profesionale janë shumë të rëndësishme. Në këtë rast do të kisha shprehë brengën time se kemi mësimdhënës të cilët e bëjnë punën vetëm sa për të kaluar kohën, andaj edhe kemi problem me cilësinë e arsimit. Është fakt se mungon motivimi i mësimdhënësve sidomos i atyre që me shumë përkushtim dhe dashuri e kryejnë këtë mision të shtrenjtë. Sa më parë duhet jetësuar ngritja profesionale dhe zhvillimi në kar-





rierë i mësimdhënësve sipas kriteve të parapara në mënyrë që t'i nxit mësimdhënësit të punojnë me më shumë vullnet. Për nxënësit dhe arsimtarët të cilët i përgatisin nxënësit për pjesëmarrje në gara, ndërkombëtare, olimpiada të ndryshme, gara shtetërore, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ndanë fond të caktuar për ti shpërblyer për rezultatet e arritura duke dashur që në këtë mënyrë sa do pak ti motivoj. Nxënëseve, e kemi obligim t'u sigurojmë arsimim të mirëfilltë dhe cilësor që do t'u mundësojë njohuri të reja, zhvillim të kreativitetit, inovacione, pjesëmarrje të drejt për drejtë në planifikimin dhe realizimin e programit të aktiviteteve të shkollës.

KOHA: Shteti duhet të investojë në arsim, sepse krijimi i një sistemi arsimor cilësor është parakusht edhe për cilin do përshtet të shtetit. Sa do të jetë sfidues arritja e këtij objektiv, meqë vazhdimisht ka pasur akuza për rënie të cilësisë së arsimin në të gjitha nivelet?

SULEJMANI: Ngritja e cilësisë së arsimin është sfidë për çdo njeri që ia mendon të mirën vendit të tij sepse vetëm me popull të arsimuar sipas standardeve dhe nevoja të tregut të punës ne mund të zvogëlojmë papunësinë dhe varfërinë dhe me kuadro cilësor do të mundemi të jemi konkurrent si në vend ashtu edhe në tregun e vendeve të zhvilluara. Andaj edhe për këtë qeveri sfiduese do të jetë rritja e cilësisë në arsim, kuantitet kemi arritur deri në një masë të caktuar por na nevojitet kualitet e atë për ta arritur na nevojiten reforma rrënjësore në të gjitha nivelet arsimore dhe qasje pak më ndryshe. Na nevojitet marrje e përvajave nga vendet që kanë arritur të larta në cilësinë e arsimin por jo copy-past i tyre, por përshtatje dhe gradualisht e jo vetëm sa për të thënë se bëjmë reforma.

KOHA: Znj. Sulejmani, cili është arsimimi juaj dhe në çfarë barriera jeni përballur. Cili është dallimi i sistemit arsimor, shkollës, programet, kur ju keni qenë nxënëse, me këtë të ditëve tona?

SULEJMANI: Kam të kryer fakultetin e fizikës në kuadër të Fakultetit të shkencave matematiko-natyrore në Shkup. Arsimin fillor dhe të mesëm e kam kryer në gjuhën amtare, ndërsa atë të lartë në gjuhën maqedonase, pasi që atë kohë ekzistonte vetëm Akademia Pedagogjike ku mësimi zhvillohej edhe në gjuhën shqipe, ndërsa në fakultete përveç në Katedrën e Albanologjisë, mësimi realizohej vetëm në gjuhën maqedonase. Kjo ishte një sfidë për mua pasi që u ndesha me vështirësi nuk kisha njohuri të mjaftueshme të terminologjisë profesionale në gjuhën maqedonase. Por, me vendosmëri dhe punë sistematike shumë shpejt i tejkalova këto vështirësi. Përndryshe nga viti i dytë e deri në mbarim isha shqiptarja e vetme në degën e fizikës. Sistemi arsimor



ndoshta nuk ka qenë më i mirë por kemi pas tjetër qasje ndaj arsimin e dashuria dhe interesimi për t'u ngritur intelektualisht dhe profesionalisht ka qenë shumë i madhe. Zhvillimi tekniko- teknologjik ka qenë larg nga ajo që është sot, por interesi dhe dëshira për nxënie të dijes ka qenë shumë më i lartë, i jemi qasur punës me më shumë vullnet dhe dashuri. Pozicioni dhe autoriteti i arsimtarit ka qenë në një nivel shumë më të lartë e që sot për fat të keq nuk mund të themi se kemi një situatë të tillë. Sot kemi plane dhe programe të stërngarkuara si në arsimin fillor edhe atë të mesëm, zhvillim teknologjik të lartë që shumë shpejt ndryshon, fëmijët janë më inteligjent dhe shumë më tepër të informuar kështu që edhe roli i mësimdhënësit duhet ndryshuar, ai duhet të nxit interaksion, të jetë kreativ, fleksibil komfor nevojave të nxënëseve dhe rrethanave të krijuara.

KOHA: Fati i mirë ka qenë se në krye të MASH-it gjithnjë ka pasur kuadro shqiptar, nga radhët e PPD-së, PDSH-së, BDI-së... Cilat ishin lehtësimet që u vëre-

jtën me pranimin e ministrit shqiptar..?

SULEJMANI: U bënë 15 vite që jam e punësuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Pata fatin që jem në këtë ministri gjatë periudhave kur ministra ishin kuadro shqiptar. Çdo funksionar gjatë mandatit të tij synon që të realizojë sa më shumë nga ajo që ka paraparë në programin e punës po jo çdo herë mundë ta realizoj të tërën, varësisht nga rrethanat e ndryshme. Por, mund të them se secili prej tyre ka kontribuar në mënyrë të ndryshme për të mirën e arsimin shqip, edhe atë me rritjen e numrit të paraleleve shqipe në shkollat e mesme edhe atëherë kur arsimi i mesëm nuk ishte obligativ, në ndërtimin dhe rekonstruimin e shkollave shqipe, hapjen e universiteteve në gjuhën shqipe etj.

KOHA: Nëse e përshkruani jetën tuaj, të familjes dhe fatin e kombit, çfarë flet?

SULEJMANI: Fati i kombit tim është njëherit edhe fati i familjes time dhe fati im. I mundimshëm, i lodhshëm me plot sfida dhe peripeci, por në fund çdoherë ngad-



hënjimtar. I përkas një kategorie që çdo gjë në jetë kam arritur vetëm me punë dhe mund, asgjë nuk më është servuar nga dikush. Rrjedh nga një familje punëtore, ku çdo herë ka mbizotëruar dëshira e madhe për t'u arsimuar, e edukuar në frymën e modestisë, të përkushtimit në detyrat apo qëllimet e parashtruara, por edhe të gëzuarit për sukseset e arritura si ato personale, të të afërmeve dhe të kombit. Njëzet e një vjet kam punuar si profesore dhe e fizikës në shkolla te mesme, duke u munduar që të kontribuoj në edukimin dhe arsimimin e brezave të ri. Kam përcjellë mjaft nxënës dhe gjenerata, me çka edhe mburrem kur sot i takoj në vende pune, detyra apo pozicione të ndryshme. Është një nga periudhat më të mira të jetës time. Edhe më tej puna ime është e lidhur me arsimin, por tash nga një aspekt tjetër si e punësuar në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës. Mendohej që të jap kontributin tim në çdo kohë dhe mënyrë, me përkushtim i qasem çdo detyrë. Kënaqësia është edhe më e madhe kur sot rreth vetes kam ish nxënësit e mi, tani kolegë të respektuar. Kjo më bën të ndjehem krenare. Në jetën private jam bashkëshorte, nënë, vjehërr dhe gjyshe. Krenohem se në një periudhë bashkëshortore 34 vjeçare, kam pasur një jetë me plot harmoni dhe besim të ndërsjellë, duke mbështetur njeri tjetrin në çdo iniciativë dhe ide të mbarë. Kemi arritur të rrisim e të edukojmë dy djem të mrekullueshëm, që sot janë bërë edhe vet prindër. I kemi

edukuar në frymën e mirësjelljes, ta duan dhe çmojnë punën, çdo angazhimi t'i qasen me përkushtim, të respektojnë gjithkënd, të jen human dhe tolerant. Sot jam e përmbushur se kam familje të shëndoshë e më së shumti i gëzohem rritës dhe lumturisë së mbesës Linës dhe nipit Andit, të cilët janë shpirti im e që më japin elan dhe vullnet për punë dhe jetë. Vendi im i punës shpesh kërkon që të jem në udhëtime zyrtar si në vend ashtu edhe jashtë, për pjesëmarrje në seminare, konferenca të ndryshme, me qëllim të shkëmbimit të përvojave të ndryshme, marrjes së përvojave te reja nga vendet e ndryshme të cilat mendohej t'i përcjell në vend. Kjo nënkupton edhe mungesën time nga shtëpia dhe të afërmit e mi. Do të shfrytëzoj rastin të falënderoj familjen time, posaçërisht bashkëshortin, djemtë dhe nusët që çdo herë më kanë mbështetur pasi që pa përkrahjen e plotë të tyre nuk do t'ia kisha dalë.

KOHA: Si e shihni avancimin e femrës shqiptare dhe a është e gatshme ajo të zë vend në institucione të rëndësishme shtetërore. Cila është këshilla juaj?

SULEJMANI: Femra është shtylla e familjes, gjegjësisht e shoqërisë. Sa më të ngritura që i ka femrat aq më e avancuar është ajo shoqëri. Ajo lind, rrit dhe edukon gjenerata të reja. Sot femrën shqiptare e gjen si amvisë të mirë, mësuese, mjekë, inxhinierë, politologje, deputete, kryetare komune etj. Është dëshmuar se femrat janë organizatore më të mira, janë më tolerante, janë më të përgjegjshme kur i qasen një angazhimi dhe obligimi të marrë. Asnjëherë nuk duhet të presim që dikush të na kryej detyrat tona, të luftoj për të drejtat tona, nëse vet nuk angazhohemi për ta zënë vendin dhe pozitën e duhur në shoqëri. Për t'i realizuar këto synime e patjetërsueshme është mbështetja dhe përkrahja e familjes dhe të afërmeve. Do të kisha apeluar deri te çdo femër që tërë potencialin që ka ta shfrytëzoj për të mirën e vetes, familjes, rrethit dhe shoqërisë e atë do ta bëj vetëm me punë permanente. Duhet të kenë më shumë vetëbesim dhe mos të ngurojnë për të dalë në sipërfaqe.





Në bazë të rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të publikuara online, mund të dihet tashmë se shumica e komunave të mëdha do të shkojnë në balotazh për zgjedhjen e kryetarëve të rinj

Kush me kë shkon në balotazh dhe kush fitoi garën?

Nga 1.890.952 qytetarë me të drejtë votë në Kosovë, të drejtën e tyre për të votuar e shfrytëzuan 819.865 shprehur në përqindje 43.68 për qind

Në bazë të rezultateve preliminare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të publikuara online, mund të dihet tashmë se shumica e komunave të mëdha do të shkojnë në balotazh për zgjedhjen e kryetarëve të rinj. Derisa, në disa komuna, kryetarët janë zgjedhur qysh në raundin e parë të votimeve. Nga të dhënat online, në shumicën e 38 komunave të Kosovës votat e procesuara arrijnë në mbi 90 për qind. Sipas të rezultateve preliminare 19 komuna janë në balotazh, po aq janë fituar në raundin e parë. Në këto zgjedhje morën pjesë 91 subjekte politike, prej tyre një koalicion, 35 parti politike, 30 iniciativa qytetare dhe 25 kandidatë të pavarur (qoftë për kryetarë komune apo për këshilltarë në Kuvendet Komunale).

Komunat dhe kandidatët që shkojnë në balotazh:
Prishtinë: Shpend Ahmeti nga LVV (43,42) dhe Arban Abrashi nga LDK (35,91).
Gjakovë: Ardian Gjini nga AAK (40,77) dhe Mimoza Kusari Lila nga Alternativa (31,48).
Gjilan: Lutfi Haziri nga LDK (43,30) dhe Sami Kurteshi nga LVV. (26,97)
Mitrovica e Jugut: Valdete Idrizi (28,56) nga PDK dhe Agim



Bahtiri nga AKR (27,10).
Prizren: Shaqir Totaj nga PDK (29,66) dhe Mytaher Haskuka nga LVV (22,43).
Ferizaj: Agim Aliu nga PDK (39,18) dhe Muharrem Sfarqa nga LDK (30,00).
Istog: Haki Rugova nga LDK dhe (43,54) Gani Dreshaj nga AAK (37,23).
Obiliq: Xhafer Gashi nga AAK (49,26) dhe Mehmet Krasniqi nga LDK (27,46).
Podujevë: Agim Veliu nga LDK (48,37) dhe Ajet Potetra nga LVV (29,99).
Klinë: Sokol Bashota nga PDK (36,60) dhe Besim Hoti nga LDK (23,69).
Kaçanik: Besim Ilazi nga PDK (40,38) dhe Basri Kodra nga LVV. (21,26)
Kamenicë: Qëndron Kastarati nga LVV (34,22) dhe Shaip Surdulli nga LDK (28,04).
Rahovec: Smajl Latifi nga AAK

(33,40) dhe Ibrahim Kryeziu nga LDK (20,45).
Shtime: Naim Ismajli nga PDK (38,15) dhe Fatmir Rashiti - kandidat i pavarur (27,93).
Suharekë: Bali Muahrremaj nga AAK (39,98) dhe Sali Asllanaj nga LDK (33,93).
Vushtrri: Ferit Idrizi nga PDK (33,51) dhe Xhafer Tahiri nga LDK (25,71).
Malishevë: Ragip Begaj nga Nisma (40,67) dhe Mursel Gashi nga PDK (27,26).
Dragash: Selim Kryeziu nga LDK (37,94) dhe Shaban Shabani nga PDK (28,12).
Klokot: Strahinja Spasiç Lista Serbe (48,08) dhe Bozidar Dejanoviç nga GI (37,62).
Sipas rezultateve preliminare të KQZ-së pa balotazh garën për kryetar komune e kanë fituar që në rrethin e parë të votimeve:
Pejë: Gazmend Muhaxhiri nga

LDK (50,35).
Deçan: Bashkim Ramosaj nga AAK (63,91).
Fushë Kosovë: Burim Berisha nga LDK (63,41).
Skenderaj: Bekim Jashari - kandidat i pavarur (85,59).
Drenas: Ramiz Lladrovci nga PDK (59,34).
Han i Elezit: Rufki Suma - kandidat i pavarur (57,32).
Mitrovica e Veriut: Goran Rakiq nga Lista Serbe (66,97).
Leposaviç: Zoran Todiç nga Lista Serbe (62,18).
Lipjan: Imri Ahmeti nga LDK (59,57).
Novobërdë: Svetislav Ivanociq nga Lista Serbe (54,97).
Shtërpçë: Bratislav Nikoliç nga Lista Serbe (74,02).
Viti: Sokol Haliti nga LDK (52,98).
Zubin Potok: Stevan Vuloviç nga Lista Serbe (80,19).
Zveçan : Vuçina Jankoviç nga Lista Serbe (69,26).
Junik: Agron Kuqi nga AAK (58,40).
Mamushë: Abdulhadi Krasniç nga KDTP (53,95).
Graçanicë: Srdjan Popoviç nga Lista Serbe (87,88).
Ranilug: Gradimir Mikiç nga Lista Serbe (77,62).
Partesh: Dragan Petkoviç nga Lista Serbe (58,95).
Nga 1.890.952 qytetarë me të drejtë votë në Kosovë, të drejtën e tyre për të votuar e shfrytëzuan 819.865 shprehur në përqindje 43.68 për qind.



A do të burgosej Thaçi në Serbi

Një ditë para betimit e dekretimit të gjykatësve e prokurorëve serbë për të punuar në Gjyqësorin e Kosovës të paralajmëruar për të martën, medie serbe janë përkujdesur për të publikuar, sërish, tekstin e aktgjykimit ndaj kryetarit të Kosovës Hashim Thaçi, shpallur në mungesë në vitin 1997 nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë e cila atëherë vepronte nën juridiksionin e Serbisë. Me këtë aktvendim Thaçi ishte dënuar me 10 vjet burgim, për siç thuhej, terrorizëm e më pas kundër tij janë ngritur edhe aktakuza të tjera, ndërsa në vitin 2002 Serbia kishte shpallur edhe fletë arrestin ndërkombëtar me dyshimin se ai kishte kryer gjenocid, transmeton Koha.net shkrimin e portalit nga Beogradi "Srpski Telegraf". Siç ishte shkruar në fletë arrestin, përcjell ky portal, MPB e Serbisë, në bazë të urdhërësës së Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, "ndjek terroristin, Hashim Thaçin, të quajtur "Gjarpri" lindur në Brojë nga babai Haxhi". Theksohet se Thaçi është pjesëtar i "bandave terroriste separatiste shqiptare dhe komandant i të ashtuquajturës Drejtori politike e Shtabit kryesor të UÇK-së".

Në fletë arrest shkruan se ai "ka marrë pjesë disa herë në sulmet terroriste ndaj pjesëtarëve të policisë në Gllgovc për ç'shkak nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë në korrikun e vitit 1997 është dënuar me dhjetë vjet burgim. Thaçi, sipas thëniesve të aktakuzës kohë pas kohe lëviz nga nëpër Austri e Zvicër, ndërsa në territorin e Kosovës vjen përmes kalimeve ilegale me Shqipërinë.

Në fletë arrest qëndron ftesa për qytetarët që nëse e njohin, ta paraqesin në stacionin më të afërt të policisë. Aty është edhe vërejtja se ai lëviz i armatosur dhe se është i gatshëm të përdorë armën e zjarrit. Duke u bazuar në këtë fletë arrest, ky portal shkruan se sikur Hashim Thaçi të shkojë në Serbi, ai me siguri do të arrestohet.

Rama: Prokuroria të punojë, të lërë replikat me politikën



Kryeministri ka reaguar ndaj deklaratës së Prokurorisë, ku kjo e fundit tha se Edi Rama sot mori rolin e gjykatësit në mbrojtjen ndaj Saimir Tahirit. Në njoftimin zyrtar thuhet se shefi i qeverisë mbron pikëpamjen se detyra e organit të prokurorisë nuk është as të dëgjojë politikën, as të replikojë me politikën, as të publikojë në media opinionet e saj, për çfarë thotë një politikan a një tjetër. Gjithashtu ai shpreh keqardhjen, që organi i akuzës pretendon se ka konstatuar përpjekje për intimidim në fjalën e mbajtur sot prej tij. "Në fakt, kreu i qeverisë dhe lideri i shumicës parlamentare, vetëm ka dhënë opinionin e grupit parlamentar, bazuar në raportin e Komisionit të Mandateve dhe Rregullores dhe, padyshim, në paraqitjen aspak serioze prokurorisë në seancat publike të atij komisioni". Kryeministri i rikujton

Rritet krimi kibernetik, bëni kujdes me të dhënat bankare

Policia e Shteti njofton qytetarët që të jenë të kujdesshëm nga mashtrimet nëpërmjet internetit. Në një deklaratë zyrtare, thuhet se kohët e fundit ka pasur një rritje të mashtrimeve të kryera nëpërmjet internetit. "Informojmë qytetarët dhe subjektet private se nga strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit për Hetimin e Krimeve Kompjuterike, po merren të gjitha masat për parandalimin e rasteve të ngjashme por dhe evidentimin dhe goditjen e autorëve për rastet e ndodhura. Duke u nisur nga fakti se këto ngjarje kanë si qëllim vjedhjen e fondeve të llogarive bankare nëpërmjet mashtrimit i kërkojmë qytetarëve dhe subjekteve private, të bëjnë kujdes për sa i përket ekspozimit të të dhënave të tyre bankare në mjediset e jetës së përditshme por edhe kur marrin kërkesa të ndryshme gjatë periudhës që ndodhen duke lundruar në internet. Në rast se merrni kërke-



sa për kryerjen e pagesave në llogari bankare të ndryshme nga ato që i kryeni zakonisht, duhet të verifikoni paraprakisht me mjete të tjera komunikimi (telefon, faks etj.) nëse llogaria e re i përket vërtetë partnerit tuaj tregtar. Gjithashtu kujdes duhet të bëhet me dhënie e kodeve të hyrjes për llogaritë e tyre të rrjeteve sociale, postës elektronike si dhe çdo program tjetër i cili mundëson hyrjen nëpërmjet kodeve të sigurisë. Ju bëjmë me dije qytetarëve dhe subjekteve private se Policia e Shtetit është në dispozicion të tyre dhe për çdo paqartësi apo dyshim të drejtohen pranë strukturave të saj. Duke shpresuar se do të gjejmë mbështetje të plotë nga ana e qytetarëve por edhe subjekteve private, sugjerojmë të mos neglizhohet asnjë rast i dyshuar apo evidentuar nga ana e tyre, duke u drejtuar në mënyrë të menjëhershme pranë strukturave tona", thuhet në njoftimin zyrtar.



Pasojat e një opsioni ushtarak mbi gadishull do të jenë dramatike dhe shkatërrimtare për një popull që jeton në mashtrim dhe izoluar

Korea e Veriut vendosi të vetëvritet

"Korea e Jugut është djalli dhe ne do ta mundim, SHBA-të janë djalli dhe ne do t'i mundim, Japonia është djalli dhe ne do ta mundim", këto janë fjalët e përsëritura si një filozofi nga Ri Chun Hee, folësja e televizionit qendror të Koresë së Veriut dhe dëgjohen shpesh nga veshët e koreanëve. Si robotë përthithen dhe përsëriten me një falsitet mahnitës. Këto të ashtuquajtura të vërteta absolute, të cituara nga Chun Hee me zë marshi, e veshur me një kostum me ngjyra piktoreske, me një pineskë me flamurin e kuq e blu, me yllin komunist dhe me një krehje tipike për fytyrën e saj simetrike është i vetmi burim nga e cila marrin informacionin: radio qendrore, televizion qendror, por asgjë më shumë.

Për diktaturën e Kim Jong Un-it interneti është një mëkat i perëndimit. Chun Hee s'do të mundet të shqiptojë të vërtetën e regjimit të Koresë së Veriut, vendi më i izoluar i tokës dhe aq më pak nëse do të fillonte një luftë e përshkallëzuar. Ky vend

ka një popullsi prej 25 milionë banorësh, por vetëm 5000 prej tyre gëzojnë kënaqësitë e një elite qeverisëse mes të cilëve burokratë dhe gjeneralë. Kjo kastë partiake, ushtarake dhe ekonomike e di mjaft mirë se popullsia nuk do t'i mbijetojë një luftë konvencionale dhe aq më pak një konflikti bërthamor. Pjesa tjetër e qytetarëve të shpërndarë mes kryeqytetit Peniang dhe fshatit vuan pasojat e një regjimi diktatorial mbytyës për shkak të një obsesioni të udhëheqësit, atë të zhvillimit raketor me kapacitete bërthamore. Shembujt e pasojave janë të qarta dhe dramatike. Zhvillimi bërthamor në vend ka bërë që fëmijët koreano-veriorë të vuajnë nga çrregullime dhe kequshqyerje, për afërsisht një fëmijë 5-vjeçar është në gjatësi 9 cm më i shkurtër se i njëjti moshatar në jug. Zhvillimi fizik dhe mendor lidhet direkt me vështirësitë e ushqyerjes dhe me pamundësinë e aksesit për një varietet të gjerë të përbërësve krahasuar me popullsinë më pak të zhvilluar të para-

lelit 38. Përpos këtyre deficiteve ushqimore fëmijët do të jenë viktimat e parë të konfliktit të armatosur. Fëmijët nga 0-14 vjeç zënë 20% të popullsisë koreano-veriore, pra janë më shumë se 5.000.000 fëmijë që nuk do të kenë mundësi të strehohen në bunker apo vendstrehime dhe do të jenë shënjestrat e para.

Bunkerët janë të rezervuar për të privilegjuarit që ua mbushin mendjen njerëzve se mund të fitojnë kundër djajve në një luftë bërthamore. Nëse do të vendoset një përshkallëzim luftarak dhe të konkretizohet Peniani do të kthehej në hi. Këtë herë do të duhej vetëm 15 minuta shkatërrim, sipas llogaritjeve nga specialistët ushtarakë, jo si herën e fundit. Nuk është përgjegjësi e vetme e diktatorit ajo çka ndodh aty, por edhe e mijëra koreano-veriorëve të shpërndarë në planet që nuk e ngrënë zërin kundër një regjimi të vjetruar që beson se do të dalë fitimtar në luftën kundër SHBA-së. Këta janë ambasadorët e mashtrimit. Ashtu si gjermanët u

mashtroan gjatë dy luftërave botërore, argjentinast gjatë konfliktit të armatosur për ishujt e Atlantikut të Jugut, kamboxhianët gjatë regjimit të Khmer Rouge dhe kubanët akoma e sot, është detyrë e këtyre koreano-veriorëve në ekzil t'u thonë të vërtetën vëllezërve të tyre. Nëse SHBA do të sulmojë, Korea e Veriut nuk do të mbijetojë.

Koha e shkurtër e shkatërrimit vjen edhe nga diferencat në teknologji dhe ato ushtarake, rezervat me municione, ushqime dhe lëndë plasëse do të zgjasin vetëm 3 javë nëse do të fillonte lufta. Këto janë llogaritjet e bëra nga BBC nga akademiku Bruce Bechtol, i Pentagonit dhe profesori i Universitetit të Teksasit, Angelo State. Nëse konflikti do të zgjaste viktimat mund të numërohen në milionë, produkt i një urie të pashmangshme. Kjo do të ndodhë nëse ajo kastë prej 5000 njerëzish do të vazhdojë të urdhërojë Ri Chun Hee-në t'ua komunikojë atë të vërtetë të triumfit kundër djallit.

Gjenden 65 trupa të civilëve të vrarë nga ISIS-i

Aktivistët sirianë po raportojnë se së paku 65 trupa civilë janë gjetur në një qytet qendror, të rimarrë nga forcat qeveritare siriane nga militantët ekstremistë të Shtetit Islamik. Shumica e viktimave besohet se janë vrarë nga ISIS-i. Vëzhgues sirianë për të drejtat e njeriut me bazë në Britani, thotë se numri i të vrarëve në

provincën qendrore Homs, mund të jetë më i madh. Sipas vëzhguesve, shumica e të vdekurve u vranë gjatë luftimeve tre-javore të grupit militant. Trupat siriane dhe luftëtarët aleatë kanë rimarrë kontrollin e qytetit të shtunën. Militantët ekstremistë të Shtetit Islamik në Siri, kanë pësuar humbje të mëdha në muajt e fundit.

Protestë e budistëve ekstremistë, nuk duan kthimin e muslimanëve në Mianmar



Budistët ekstremistë në Mianmar protestuan kundër kthimit të rreth 600 mijë muslimanëve të Arakanit të cilët janë strehuar në Bangladesh duke ikur nga sulmet e ushtrisë së Mianmarit dhe budistëve fanatikë. Në protestën e organizuar në kryeqytetin e provincës së Arakanit, Sittwe, morën pjesë qindra budistë ekstremistë të djathtë, në mesin të cilëve ndodheshin edhe priftërinjtë. Njëri nga organizatorët e protestës Aung Htay tha se i kanë bërë thirrje Qeverisë së Mianmarit që të mos lejojë kthimin e muslimanëve të Arakanit në vend. Zëdhënësi i Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) Joel Millman, në një konferencë për media në Zyrën e Kombeve të Bashkuara (OKB) në Gjenevë tha se ka arritur në 589 mijë numri i muslimanëve të Arakanit të cilët janë strehuar në

Bangladesh duke ikur nga sulmet e ushtrisë së Mianmarit dhe budistëve fanatikë që nga shpërthimi i dhunës më 25 gusht. Ai bëri të ditur se së bashku me refugjatët e ardhur me herët në kampin në Cox's Bazar të Bangladeshit, numri i këtyre muslimanëve të Arakanit ka arritur në 800 mijë. Operacionet e nisura nga ushtria e Mianmarit pas sulmeve në pikat policore në Arakan vitin e kaluar dhe rrasja e nëntë policëve, shkaktoi që pakica muslimane në këtë vend të përballet me një valë të madhe të dhunës.

Për shkak të operacioneve, qindra mijëra muslimanë të Arakanit u detyruan të braktisnin shtëpitë e tyre. OKB-ja tha se nevojitet një fond emergjence në vlerë prej 434 milionë dollarësh për të përmbushur nevojat themelore njerëzore të muslimanëve të Arakanit.

Fituesi i zgjedhjeve kërkon aleancë kundër refugjatëve

Kryeministri i ardhshëm i Çekisë, Babis ka në plan të krijojë në BE një aleancë kundër refugjatëve. Për këtë ai nuk do të kufizohet vetëm me shtetet e Vishegradit

Pas fitores së partisë së tij populiste ANO në zgjedhjet parlamentare, fituesi i tyre bëri edhe njëherë të qartë se për se do të luftojë. Andrej Babis tha se synimi i tij është një aleancë kundër refugjatëve në Bashkimin Evropian. Ai do të kërkojë mbështetje tek shtetet e tjera të BE për luftën e tij kundër imigrimit, tha kryetari i partisë në një intervistë në Pragë me agjencinë e lajmeve Reuters.

"Duhet të përgatisim fusha tematike, duhet të bëjmë të qartë në Këshillin Evropian atë që duam të ndryshojmë". Ashtu si Viktor Orbani në Hungari dhe Jaroslav Kaczynski në Poloni miliarderi Babis kërkon mbylljen e kufijve evropianë dhe paralajmëron për rrezikun e terrorizmit nga emigrantët. Por në iniciativat e tij ai nuk do të përqendrohet në shtetet e Vishegradit, ku krahas Çekisë bën pjesë edhe Polonia, Hungaria dhe Sllovakia. Te fituesi konservator i zgjedhjeve në Austri Sebastian Kurz ai sheh një aleat në politikën e anti-imigrimit, tha Babis. "Grupi i Vishegradit ka nevojë për aleatë të tjerë, na duhet Austria dhe shtete të tjera në Bal-



lkan, Sllovakia, Kroacia e ndoshta të tjerë". Këtë qëndrim e kritikon kryeministri çek socialdemokrat në largim, Bohuslav Sobotka. Ai u shpreh i tmerruar për zhvendosjen djathtas të elektoratit. Edhe ministri i Jashtëm i Luksemburgut, Jean Asselborn i kritikoi

shprehjet e Babisit kundër emigrantëve. "Në vitin 1968 ne në shumë vende të BE, edhe në Luksemburg qemë krenarë që t'u jepnin një shans për një jetë të re refugjatëve të Çekoslovakisë së atëherëshme", tha Asselborn për gazetën Tagesspiegel. Partia ANO do të jetë në të

ardhmen forca më e madhe politike në parlament, me 78 nga 200 mandate në parlamentin çek. Në të njëjtën kohë, miliarderi Babis ndodhet para një formimi të vështirë të qeverisë. Gjithsej në parlamentin e ri hynë nëntë parti. Kryeministri i deritashëm socialdemokrat Sobotka dhe kristian-demokratët, të cilët patën ndërmtuar së fundi një koalicion me ANO deklaruan që tani se nuk duan të hyjnë në një koalicion nën ANO-n. Partia e protestës ANO, e themeluar nga personi që zë vendin e dytë për nga pasuria në Çeki, mblodhi mbështetës si në kampin e majtë, ashtu edhe në atë të djathtë. Para së gjithash pakënaqësia për klasën poli-

tike ia siguroi asaj sipas analistëve fitoren. ANO premtan se do të ulë taksat, do të largojë nga pushteti politikanë të korruptuar dhe se do të mbyllë kufijtë evropianë, në mënyrë që në Çeki të mos hyjë asnjë refugjat i vetëm. Politologu çek Jiri Pehe ndërkohë nuk sheh te Babis një nacionalist të tipit të Jaroslav Kaczynskit në Poloni ose të Viktor Orbani në Hungari. 63 vjeçari nuk ka bindje të forta apo ide, ai do më tepër të shtojë pasurinë e tij, i tha Pehe agjencisë së lajmeve DPA. Më shumë ai i ngjan Presidentit amerikan Donald Trump ose ish-kryeministrit italian Silvio Berlusconi, se sa zotërinjëve të grupit të Vishegradit.



Rusvelti ishte në dijeni të armiqësive së Japonisë dhe në vitin 1941 uli furnizimet amerikane të naftës në Japoni, duke vazhduar diplomatikisht negociatat. Megjithatë, më 7 dhjetor, 1941, Japonia sulmoi Pearl Harburin, gjendja shpirtërore e vendit ndryshoi krejtësisht dhe Rusvelti tani kishte mbështetjen e plotë

Xherardo NIKJARI

Kur Japonia bombardoi Pearl Harbour më 7 dhjetor 1941, Franklin Delano Rusvelt ishte duke shërbyer në mandatin e tij të tretë presidencial si president i SH.B.A-së – i vetmi president që shërbeu më shumë se dy mandate.

Ai kishte fituar popullaritetin si njeriu që nxori SHBA-në nga Depresioni; ai udhëhoqi SH.B.A-në përgjatë Luftës së Dytë Botërore, duke luajtur kështu një rol të madh në mposhtjen fuqive të Boshtit dhe përcaktimin e fatit të botës pas luftës.

Franklin Delano Rusvelt lindi më 30 janar 1882 në një familje të pasur të Nju Jorkut dhe ishte kushëriri i Teodor Rusvelt. Në 1903 pasi kishte mbaruar studimet për histori në Harvard ai filloi studimet për drejtësi në Universitetin e Kolumbias.

Gjithmonë një demokrat, Rusvelti hyri në politikë në vitin 1910, kur fitoi një vend në Senatin e Shtetit të Nju Jorkut. Ai dha mbështetjen e tij për Uodrrou Uillson, i cili, si president i SH.B.A-së, e emëroi Rusveltin si Ndihmës Sekretar të Marinës.

Ky post i dha Rosevelt përvojë të vlefshme detare dhe administrative, dhe gjatë Luftës së Parë Botërore ai fitoi edhe më shumë përvojë në planifikimit detar ushtarak.

Në vitin 1921 Rosvelti u diagnostikua me poliomielit dhe u bë plotësisht i paralizuar. Ai bëri një shërim të ngadaltë por kurrë nuk rifitoi përdorimin e këmbëve të tij. I Inkurajuar dhe asistuar nga gruaja e tij, Eleanor, ai luftoi për të rifilluar karrierën e tij politike dhe në vitin 1928 u zgjodh Guvernatori i Nju Jorkut.


Një vit më pas Wall Street Crash shënoi fillimin e një kohe të gjatë depresioni ekonomik në SH.B.A, dhe botë. Rosevelt vrapoi si kandidat Demokratik presidencial, duke premtuar një program intervenues i "lehtësimit, shërimt dhe reformës". Zgjedhur në vitin 1932, ai paraqiti një legjislacion progresiv, i njohur si Kursi i Ri, i cili mundësoi shumë nevojën sociale të mirëqenies.

Ai gjithashtu inicioi të famshmen "Fatside chats", ku ai foli direkt me kombin nëpërmjet transmetimeve radiofonike. Nga tani ai dispononte një popullaritet të jashtëzakonshëm, Rusvelti u sh-

Profile: Franklin Delano Rusvelt



Kampioni i demokracisë në karrige me rrota...



përblje me një fitore të dytë në 1936.

Nga fundi i viteve 1930, me Depresionin që pothuajse po zhdukej, politika e jashtme u bë çështje më e madhe në SH.B.A... Rusvelti gjithmonë kishte mbrojtur një politikë e gatishmërisë ushtarake dhe ai e pa qartë kërcënimin e paraqitur nga Gjermania Naziste dhe Japonia.

Mirëpo, qëndrimi i vendit, që nga 1920, ishte izolacionist, dhe Kongresi kishte kaluar Aktin e Neutralitetit në vitin 1935, një akt që i kushtojë neu-

tralitetit të plotë të për SH.B.A-së.

Megjithatë, kur Britania deklaroi luftë kundër Gjermanisë në vitin 1939, Rusvelti deklaroi se edhe pse SH.B.A mund të mbetet neutrale, nuk mund të mbetet joaktive.

Ai e bindi Kongresin të mbështesnin përpjekjet e aleatëve me parullën "të gjithë në ndihmë të luftës", ndërsa në të njëjtën kohë forcohej mbrojtja e SH.B.A.-së. Rusvelti shtoi kontributin e SHBA nga duke ofruar luftanije në këmbim të bazave detare, dhe në një nga fireside

chats i kërkonte publikut amerikan të merrte në konsideratë përfshirje të mëtejshme.

Një nga lëvizjet e para të Rusveltin në mandatin e tij të tretë historik si president ishte për të kaluar aktin e huazimit (Lend-Lease Act), i cili i lejoi Shtetet e Bashkuara tu jepnin ndihmë ushtarake Britanisë, Kinës, dhe Bashkimit Sovjetik. Në gusht të 1941 Rusvelti u takua me Kryeministrin britanik Uinston Çerçill në të parin nga shumë takime ndërmjet tyre përgjatë luftës.

Ata firmosën Kartën e Atlantikut një kartë prej 8 pikash e me synimet për botën e pasluftës. Ata gjithashtu iu zotua vendeve të tyre se "do të shihnin shkatërrimin e plotë të tiranisë naziste".

Shumë amerikanë e panë Luftën e Dytë Botërore si një çështje evropiane, por kishte një tjetër kërcënim për neutralitetin amerikan – Japonia. Në vitin 1940 Japonia u bashkua me fuqitë e Boshtit dhe rrjedhimisht marrëdhëniet midis Japonisë dhe Shteteve të Bashkuara u

përkeqësuan.

Rusvelti ishte në dijeni të armiqësive së Japonisë dhe në vitin 1941 uli furnizimet amerikane të naftës në Japoni, duke vazhduar diplomatikisht negociatat. Megjithatë, më 7 dhjetor, 1941, Japonia sulmoi Pearl Harburin, gjendja shpirtërore e vendit ndryshoi krejtësisht dhe Rusvelti tani kishte mbështetjen e plotë.

Ditën tjetër në një fjalim në Kongres, ai përkrahu 7 Dhjetor e famshëm si një "ditë e turpshme" dhe deklaroi luftë ndaj Japonisë. Pak ditë më vonë Gjermania dhe Italia i shpallin luftë Shteteve të Bashkuara.

Me SH.B.A tani në luftë, Rusvelti menjëherë u bë një Komandant i Përgjithshëm shumë aktiv, emëroi komandantët ushtarakë dhe punoi me strategji. Përkundër sulmit në Pearl Harbur, Rusvelti priorizoi humbjen e Gjermanisë duke përqendruar kështu fitoren në Evropë dhe, emëroi Gjeneralin MekArtur për të drejtuar luftën e Paqësorit.

Për të realizuar këtë objektiv ai mbajti një seri takimesh me Uinston Çerçillin dhe udhëheqësit e tjerë aleatë, në Kajro, Teheran dhe Kasablanka, në të cilat u vendos progresi i luftës. Teksa lufta po favorizohej nga aleatët, Çerçilli dhe Rusvelti diskutuan planet për pushtimin e Francës.

Të dy burrat ishin jo gjithmonë në marrëveshje: Rusvelti favorizoi një pushtim të drejtpërdrejtë të Francës; Çerçilli preferonte një më të tërthortë nga Mesdheu. Por në fund ishin planet e Rusveltit që u miratuan dhe ai emëroi gjeneral Duajt D. Ajsenhauerin për të udhëhequr komandën aleate.

Për këtë qëllim ai mbajti një aleancë të ngushtë me të gjitha kombet aleate, duke punuar edhe me udhëheqësin sovjetik Josef Stalin dhe udhëheqësin kinez Çang Kai-Shi.

Që në dhjetor 1941 Rusvelti po planifikonte për botën e pasluftës, dhe në Deklaratën e Kombet të Bashkuara u hodhën themelet për Kombet e Bashkuara moderne, të cilat u ngritën në vitin 1946. Edhe pas vdekjes së Franklin Rusvelt Eleanor Rusvelt e vazhdoi punën e të shoqit duke hartuar Deklaratën e OKB-së së të drejtave të njeriut.

Lufta po i mundonte shumë Rusveltin dhe deri në vitin 1944 shëndeti i tij u përkeqësua shpejt. Megjithatë, ai ishte në shëndet të mirë për të siguruar një mandat të katërt në zyrën e presidentit amerikan, dhe ndoqi Konferencën e Jaltës në vitin 1945 ku "The Big Three" (Tre të Mëdhejtë) vendosën Europën e pasluftës.




Me këtë kohë ai ishte i rraskapitur dhe vuante nga arterioskleroza e avancuar. Franklin Delano Rusvelt vdiq më 12 prill 1945, më pak se një muaj para se gjermanët të dorëzoheshin dhe fitorja të arrihej në Europë.



Për këtë listë jemi fokusuar tek veprat e Shekspir, të cilat janë shkruar për t'u vënë më pas në skenë dhe jo nga e gjithë bibliografia e tij. Gjithashtu, ne po e bazojmë këtë listë jo vetëm nga mendimi ynë për veprat më të mira, por edhe nga jetëgjatësia e tyre ndër vite dhe influenca që kanë pasur te shkrimtarë të tjerë modernë dhe në audiencë.

Pas perdeve të skenës së teatrit

DETAJET E 10 KRYEVEPRAVE TË SHEKSPIRIT



Tregtari i Venecias

E shkruar rreth viteve 1596-1598, kjo komedi e hershme e Shekspir, bazohet në borxhin e një tregtari venecian kundrejt një huadhënësi hebre dhe kauzën e tij për të rimarrë paratë që i takojnë. Ndërsa studiuesit modernë diskutojnë për potencialin e prezantimit të



William Shakespeare

antisemitizmit, kanë rënë dakord njëzëri se kjo vepër e shekullit të XI prek tema të forta të interesit personal kundrejt dashurisë, të fjalëve kundra ligjeve dhe cilësinë e mëshirës. Prandaj, "Tregtari i Venecias" vazhdon të jetë një zgjedhje shumë e kërkuar e produksioneve teatrale dhe është përshatur në qindra filma.

Shumë zhurmë për asgjë

Mos u gënjeni nga titulli pasi "Asgjë" është totalisht e kundërta e asaj që do të sjellë shumë zhurmë këtu. Shekspiri, i cili njihet për lojën e tij me fjalët, me "asgjë" ai tregohet homofon, pra përdor një fjalë, por që ka kuptimin tjetër, atë të zhurmës. E konsideruar si një nga komeditë më të mira dhe më depërtuese të tij, "Shumë zhurmë për asgjë", ngjalli shumë të qeshura, por në një kohë trajtoi dhe tema klasike si ndershmëria, mashtrimi dhe qëndrimi i publikut tek i cili edhe publiku modern i sotëm e gjen veten.

Otello

E shkruar rreth vitit 1603, kjo vepër u bazua në tregimin e novelistit italian Cinzio me titull "Kapiteni zeshkan" dhe tregon ngjarjet tragjike të një gjenerali zeshkan, i cili u martua me një grua veneciane. Me një gamë të gjerë temash të cilat nuk kanë kohë, si racizmi, xhelozia, tradhtia dhe hakmarrja, Otello mbetet një performancë e preferuar për audiencën. Jashtë përshatjes teatrale, vepra ka inspiruar interpretime të ndryshme muzikale, grafike dhe artistike, duke vërtetuar kështu se të gjithë i duan historitë me tradhti, por asnjëri nuk do të jetë në atë situatë.

Çezari

Duke folur për tradhtinë, ky është tregimi final i këtij zhanri

i cili flet për oficerë të cilët kthehen në konspirues. E shkruar në kohën e duhur, kur Anglia po eksperimentonte frikërat e saj mbi vrasjet konspirative dhe luftën civile, vepra ka qëndruar kaq aktuale me temat e politikës partiotizmit dhe miqësisë. Edhe pse vrasja e Çezarit është dramtuzuar shumë nga Shekspiri, kjo vepër ka rezistuar me kohën, me modernizmin e tij arrin një audiencë të lartë, insipiron histori të ngjashme dhe madje diskutime politike.

Rikardi III

E shkruajtur rreth vitit 1592, Rikardi i III është ndër personazhet e shumta fiktive të Shekspir gjatë monarkive të së kaluarës. Si vepra e tij e dytë më e gjatë, Rikardi i III pati suksesin pasues të 3 paraardhësve të Henrit VI duke formuar kështu tetralogjinë e parë në dramaturgji. Me karakterin prej udhëheqësi dhe duke qenë antiheroi më i rëndësishëm dhe i imituar në literaturë, historia dhe karakteri i Rikardit III ka frymëzuar histori të tjera moderne në çdo cep të kulturave pop.

Mbreti Lear

Imagjinoni të humbni toruan duke u përpjekur të ndani pasurinë në një rreth trashëgimtarësh agresivë. E shkruar në periudhën e vonë të jetës së tij, Mbreti Lear pati perceptime mikse nga bashkëkohësit e Shekspir për tonet e dëshpërues që kishte kjo vepër dhe për sugjerimet që përcillte në lidhje me strukturën familjare. Pas rivendosi angleze u urdhërua të vihej në skenë një version me fund të lumtur. Megjithatë, pas viteve 1800 ai u rikthye në skenë me lavdinë e tij të zymtë dhe që atëherë pati përshtatje të ndryshme duke e riimagjinuar e duke e sjelle në formë të ndryshme, siç është dhe ajo e hitit në Fox Drama "Empire".

Ëndrra e një nate vere

E di që ke një shkrimtar të përkryer kur arrin të bashkojë fantazinë, romancën dhe farsën të gjitha në një. Ëndrra e një nate vere ka qenë vazhdimisht e quajtur si vepra më qesharake dhe absurde e Shekspir, por jo në kuptimin e keq. Është pikërisht futja e elementeve të përrallës në këtë komedi si zana, pluhurat magjike të dashurisë, gomerët, të cilët e bëjnë këtë vepër kaq të bukur për t'u luajtur në skenë. Ja pse dhe kjo mënyrë e çmendur e të përzierit të gjërave vazhdon të korrë sukses për tregimin jokonvencional të historisë dhe trajtimit të temave që i përkasin dashurisë, natyrës së ëndrrave dhe linjave të paqarta mes reales dhe joreales.

Romeo dhe Zhuljeta





Të gjithë e dimë që dashuria fiton mbi gjithçka. Përveçse në këtë vepër. E konsideruar si vepra më me shumë influencë në histori, lidhja e dy personazheve kryesore, pavarësisht marrëdhënies të familjeve të tyre, ka qenë një frymëzim për shumë mendje krijuese e zemra adoleshentësh. Edhe pse fillimisht u gjykua si dështim nga kritikët e asaj kohe, kjo tragjedi u bë e pavdekshme duke qenë ndër të paktat vepra që përfshijnë si të rinjtë dhe të moshuarit. Deri sot kjo mbetet vepra më e pëlqyer e tij, duke patur numrin më të madh të risjelljeve në skenë në krahasim me të tjerat.

Makbethi

E konsideruar si vepra më tronditëse e Shekspir, tragjedia e Makbethit ndjek personazhin kryesor, i cili është një gjeneral skocez, i cili vret gjatë rrugës së tij për fronin, dhe mbushet me paranoja e ndjenja faji. Duke patur një tregim kaq të errët, shumë produksione teatrale dhe sidomos aktorët në skenë mendojnë që kjo vepër është e mallkuar prandaj i referohen asaj me titullin "Vepra skoceze". Megjithatë Makbeth mbetet një ndër veprat klasike më të bukura në rrethin e audiencës, studiuesve dhe artistëve. Pati dhe nga ata të famshëm të ekranit që filluan karrierën e tyre pikërisht me këtë rol, si Sir Laurence Olivier, Orson Welles, Sir Ian McKellen. Përpara se të ngremë perden për të prezantuar numrin 1, do të përmendim disa vepra të tjera të Shekspir: Stuhia, Tregimi i dimrit, Henri V, Nata e 12 ose si të doni ju, Zbutja e kryeneçes.

Hamleti

Duke marrë nderimin më të lartë në listën tonë është tragjedia e një princi të ri danez, i cili kërkon të marrë hak për vrasjen e babait të tij. Edhe pse është vepra më e gjatë e tij, Hamleti ose princi i Danimarkës, është një vepër pa kohë dhe më një influencë të madhe për shkrim-



tarë të mëdhenj si Çarls Dickens dhe Xhejms Xhois, por edhe klasikë të tjerë bashkëkohor si përralla madhështore Mbreti Luan. E konsideruar si vepra më e mirë e jetës së tij, Hamleti është bërë vepra e preferuar për t'u vënë në skenë dhe tematika e preferuar e studiuesve, audiencës dhe aktorëve duke përfshirë dhe trupën teatrale të "Shakespeare Royal Company".



Ekspozitë

Hungaria nderon Mbretëreshën Geraldinë



Për shumë kohë Kontesha Geraldinë, për shkak të zotërimit të dijeve enciklopedike dhe gjuhëve të huaja të shumta, mbuloi detyrën e kryecicerones pranë Muzeut Kombëtar të Hungarisë

Nuk është hera e parë që Hungaria, vendi i origjinës i mbretëreshës Geraldinë nderon kujtimin e saj. Tashmë është Muzeu Kombëtar në Budapest, i cili ka organizuar një ekspozitë në nder të Mbretëreshës Geraldinë, Trëndafil të bardhë të Hungarisë, ku merrte pjesë dhe princ Leka. "Falënderoj Muzeun dhe Ambasadën Shqiptare në Hungari për këtë super organizim, pjesëmarrjen e personaliteteve të nderuar dhe pritjen dinjitoze që bënë!", thotë Princ Leka. Në rininë e saj para se të njihet me mbretin Zog me të cilin lidhi kurorë, falë

njohurive të saj në art, ka punuar pranë këtij muzeu. Mbretëresha Geraldinë rrjedh nga një familje shumë e njohur hungareze. Origjina e damiljes së saj daton e dokumentuar qysh nga periudha e Mesjetës, kur Hungaria u pushtua nga Arpadët në vitin 894, dhe kjo familje ishte pjesëmarrëse në krijimin e monarkisë hungareze, nën dinastinë Arpadiane. Në historinë mijërvjeçare të Hungarisë, nuk ka ngjarje të rëndësishme ku familja Appony të mos ketë luajtur rol tejet të rëndësishëm.

Në periudhën e fundit të dinastisë Arpadine, në 1280, u shfaq emri Chevalier d'Appony për herë të parë, si zotërues i një ferme shumë të madhe, për të cilën konfirmohet me dokumente arkivore se mbante emrin "Nagy Appony", e që ishte dhe mbeti deri vonë pronë e kësaj familjeje. Të gjithë paraardhësit e Familjes Appony kanë pasur karriere shumë të suksesshme

politike dhe kanë mbuluar detyra nga më të rëndësishmet shtetërore në Perandorinë Austriake, në të cilën kanë gëzuar tituj të rëndësishëm fisnikërie, sikundër: baron, kont, etj..Kushëriri i parë i Mbretëreshës Geraldinë, Konti Albert Appony, kryesoi delegacionin hungarez në Konferencën e Paqes së Versajës dhe më pas përfaqësoi Hungarinë në Lidhjen e Kombeve. Ndërsa gjyshi i saj, Konti Lajosh Appony, mbajti funksionet më të larta honorifike të Perandorisë Austriake: si Këshilltar intim dhe shambellan i perandorit Franc Jozef dhe Mareshal i Madh i Oborrit të Perandorit Franc Jozef. Gjyshja e saj ishte një aristokrate prusiane dhe njëkohësisht edhe vajza e Kontit Herman Roger de Seherr Tos, pasardhës i Princit Ernest - Joakim d' Anhalt, prej të cilit kanë rrjedhur shumica e dinastive mbretërore evropiane, çka më pas u bë shkas për të marrë nofkën e merituar Babai i mbretërve".

Atdheu i tyre, Hungaria, u copëtua dhe në bazë të Traktatit të Trianonit të vitit 1919, një pjesë e madhe e territorit hungarez, krahas 3.5 milionë hungarezëve, mbetën jashtë kufijve shtetërorë dhe së bashku me to edhe pronat e familjes Appony, të cilët u përfshinë nën administrimin e Sllovakisë. Familja Appony ka lidhje gjaku me të gjitha mbretëritë e Europës. Gjyshi nga nëna i Mbretëreshës Geraldinë ishte Xhon Herri Steëart, i cili rridhte nga një familje fisnikësh skocezë, të emigruar në SHBA në shekullin XVII, dhe ishte diplomat i suksesshëm. Ndërsa gjyshja e saj nga nëna ishte pinjolle e Familjes Hardingun, pronarë të mëdhenj tokash në Karolinën e Veriut. Ajo ishte e bija e kontit Gyula Appony dhe e konteshës Glays Virginia Stewart, e cila ishte një shtetase amerikane shumë e pasur nga shteti i Marylendit, babai i së cilës ka qenë emëruar si

Konsull i Përgjithshëm i Amerikës në Hollandë. Përveç vajzës së madhe Geraldinë, çifti Appony kishte edhe një vajzë tjetër të quajtur Virxhinia, si dhe një djalë të quajtur Xhula. Pas vdekjes së gjyshes së tyre, për Geraldinën dhe motrën e saj Virxhinia u kujdes motra e babait të tyre, kontesha Fanny Karolyi, e cila zotëronte një nga kështjellat më të famshme dhe më te bukura të Hungarisë në Zebegeny. Vajzat që kalonin verën në kështjellën e Zebegeny-it, kishin marrë nga një emër luleje. Për shkak të bukurisë së Saj dhe bardhësisë natyrale të lëkurës dhe veshjes me rroba po të të njëjtës ngjyrë, Geraldina u quajt meritueshëm "Trëndafil i Bardhë i Hungarisë".

Geraldina tashmë e rritur, na shfaqet si një europiane autentike që kish trashëguar shumë virtyte dhe vlera morale nga jeta intensive e brendshme e Seher Tesëve, nga bujaria dhe kultura e

rafinuar e Aponyve, nga dinamizmi i Steëartëve, nga sensi i përshtatjes dhe i kurajës përballë fatkeqësive prej Hardingëve. E mbetur jetime qysh në moshë të vogël, nën përkujdesjen e gjyshërve Appony, Kontesha Geraldinë u dërgua në një shkollë angleze në Menton të Francës. Më pas gjyshërit e Saj Appony, e dërguan në kolegjin "Sacred Heart" të Pressbaum, afër Vjenës në Austri, ku mbaroi fakultetin e shkencave shoqërore dhe financiare. Kontesha Geraldinë iu përkushtua me gjithë shpirt stenografisë, sociologjisë, historisë, letërsisë, etj.Një ndihmesë në edukimin e saj jepte edhe biblioteka e familjes, e cila ishte shumë e pasur, me rreth 30.000 libra. Për shumë kohë Kontesha Geraldinë, për shkak të zotërimit të dijeve enciklopedike dhe gjuhëve të huaja të shumta, mbuloi detyrën e kryecicerones pranë Muzeut Kombëtar të Hungarisë. (gazeta shqip)






Vincenzo Montella i është dhënë edhe një mundësi, pra një javë tjetër për të treguar se meriton të jetë në krye të kuqezinjve. Sipas "Corriere dello Sport", ndeshja ndaj Kievos do të jetë vendimtare, në rast të një barazimi apo humbje, do të thoshte lamtumirë

Dhjetëra futbollistë të ekipeve spanjolle kanë shënuar më shumë gola se portugezi në nëntë xhirot e para të kampionatit spanjoll. Një ndër ta është edhe shkupjani Enis Bardhi. Mesfushori i Levantes ka shënuar tre gola këtë sezon në La Liga, dy më shumë se sulmuesi i Real Madridit

Bardhi ka shënuar më shumë gola se Ronaldo



Kristiano Ronaldo është një prej golashënuesve më të mëdhenj të futbollit. Ylli i Real Madridit gjithnjë ka qenë efikas para golit duke regjistruar statistika impresive, jo vetëm në Spanjë, por edhe sa luante për Manchester Junajtedin në Angli. Por, këtë sezon Ronaldo nuk e ka filluar mirë me klubin madrilen. Katër herë fituesi i 'Topit të Artë' ka shënuar vetëm një gol në pesë paraqitje për Re-



alin në kuadër të La Ligas, duke përfshirë ndeshjen e fundit kundër Eibarit në stadiumin "Santiago Bernabeu", ku 'galaktikët' fituan 3-0. Dhjetëra futbollistë të ekipeve spanjolle kanë shënuar më shumë gola se portugezi në nëntë xhirot e para të kampionatit spanjoll. Një ndër ta është edhe shkupjani Enis Bardhi. Mesfushori i Levantes ka shënuar tre gola këtë sezon në La Liga, dy më shumë se sulmuesi i

E NDJEK SANDERLENDI

Enis Bardhi pas paraqitjeve të mira ka nxitur interesimin e skuadrave të Premier Ligës në Angli. Skuadra e Sanderlendit ka shkuar një hap më tej dhe ka dërguar skaut që të monitorojnë lojën e Bardhit, i cili në fundjavë ishte nismëtar i aksionit të shënimit të golit ndaj Getafes. Në tribunat e stadiumit në Valencia, ishte i dërguari special i afërt i trajnerit të Sanderlendit, Simon Grejson. Sipas asaj që arritëm të kuptojmë, skuadra angleze gjatë kohë monitoron mesfushorin shkupjan, të cilin ka filluar të përcjell pas paraqitjeve në Evropianin në Poloni për moshat e reja. Ndërkohë, mediat britanike spekulojnë se Bardhi është nën vëzhjim të PSZH-së, Anderlechtit dhe Interit.

Real Madridit. 22 vjeçari i lindur në Shkup golin e parë në Spanjë e shënoi kundër Deportivo La Korunjas nga gjuajtja e lirë. Goli i dytë i Bardhit për Levanten pati vlerën e një pike, pasi erdhi në barazimin 1-1 me Valencian. Bardhi shënoi gol edhe katër ditë më vonë, në ndeshjen Levante - Sociedad, që vendasit e fituan 3-0. Me këta tre gola, Bardhi është golashënuesi më i mirë i Levantes, por këtë pozitë e ndan me

sulmuesin Josr Luis Morales, i cili gjithashtu ka numër të njëjtë të golave këtë edicion. Derisa, Levante gjendet në pozitën e 12 në La Liga, me dy fitore, pesë barazime e dy humbje. Kujtojmë, klubi spanjoll e kishte blerë Bardhin këtë verë nga hungarezët e Ujpesht për 1.5 milionë euro dëmshpërblim. Ai përfaqëson Maqedoninë në nivel të përfaqësueseve, ku ka regjistruar 10 paraqitje dhe ka shënuar një gol.



Fundjavë shqiptarësh

10 gola të shënuar nga gjashtë shqiptarë gjatë kësaj fundjave në kampionatet e vendeve të Evropës dhe Australisë. Hamdi Salih i pa diskutueshëm këtë fundjavë duke shënuar katër gola për ekipin e tij Viener Neusdadt në ligën e dytë të Austrisë. Dy gola me penallti dhe dy të tjerë me aksion jo vetëm i dhanë fitoren ekipit të Neusdadt, por njëkohësisht Salih është përkohehësisht dhe shënuesi më i mirë në ligën e dytë austriake.

Migjen Basha gjithashtu u bë protagonist i ekipit të Barit në Itali, duke shënuar dy gola në ndeshjen kundër Cittadella. Ekipi i Bashës fitoi ndeshjen dhe u ngjiti në vendin e tretë në klasifikim dhe tashmë kërkon të bëjë hapa para drejt ngjitjes në Serinë A.

Besart Berisha, ish-sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, shënoi golin e parë sezonal për ekipin e tij Melburn Viktori në Australi. Edhe pse ekipi i shqiptarit nga Kosova barazoi, sërish goli i Berishës ishte shumë i rëndësishëm për ekipin.

Vetëm pak orë para ndeshjes gazetaret kroate e cilësuan si "lojtarin e derbit" dhe ashtu rezultoi të ishte dhe në ndeshjen e fundit. Eros Grezda shënoi golin e parë kundër Rijekës, të cilën ekipi i Osijek e mundi. Sulmuesi i krahut i ekipit kuqez, shënoi sërish duke konfirmuar se është një talent i padiskutueshëm dhe një zbulim me shumë vlerë për Kombëtaren e Shqipërisë. Milot Rashica nuk zhgënjoi më, ai konfirmoi këtë ditë si një talent në futbollin evropian. Heerneeve ishte viktimja e radhës e kosovarit, që shënoi golin e parë në fitoren e thellë të Vitesse. Tashmë Igli Tare duhet të jetë bindur plotësisht se talenti i Rashicës është më shumë se i rëndësishëm për Lacion.

Kristian Panuçi u duk disi i dëshpëruar kur u pyet për të ardhmen e Alban Ajetit, vëllait të Arlind Ajetit. Me të drejtë ishte dëshpërimi i teknikut të kombëtares, pasi Zvicra mund ta ketë bërë ftesën gati për talentin shqiptar që vijon serinë e golave me Bazelin. Nëse Alban Ajeti do të bashkohet ekipit kombëtar shqiptar, së bashku me Eros Grezden mund të përbëjnë një sulm të frikshëm.

Haradinaj takohet me Majlinda Kelmendin

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka pritur xhudistin më të mirë në Botë për vitin 2017, Majlinda Kelmendin. Kreu i qeverisë i ka garantuar "të artës" kosovare mbështetje për të dhe për sportin në përgjithësi. "Është për çdo admirim puna e ekipit, Majlinda Kelmendi, Driton dhe Agron Kuka, që kaluan të gjitha sfidat për të lënë shenjë të pashlyeshme në historinë e sportit kosovar duke e nxjerrë Kosovën ashtu siç kemi dëshirë të jemi



në të gjitha aspektet tjera. Puna ekipore dhe vendosmëria gjithmonë paguhen dhe të gjithë mund të mësojmë nga kjo. Ma-

jilinda, vajza e artë, është dhe do të mbetet përgjithmonë heroina jonë dhe fitoret e saja do të vazhdojnë të frymëzojnë sportistët shqiptarë për gjenerata të tëra. I sigurova, që Qeveria që unë drejtoj, do të angazhohet që të gjithë sportistët tanë të trajtohen me dinjitet, duke ju siguruar atyre kushtet e nevojshme që t'i sjellin fitore të reja Kosovës dhe të vazhdojnë të na bëjnë të gjithëve krenarë", ka shkruar në postimin e tij në "Facebook" Ramush Haradinaj.



Lenjani e Kukeli mbeten pa trajner

Rezultatet negative këtë sezon e kishin lëkundur seriozisht bankinën e Paolo Tramezzanit të Sioni, por vetëm këtë fundjavë, drejtuesit morën vendimin e vështirë për të shkarkuar trajnerin italian. Ish-numri dy i bankinës së Shqipërisë, nën drejtimin e De Biasit, largohet nga stoli i skuadrës zvicerane pas ndalesës 2-2 ndaj Luganos në javën e 12. Tramezzani shkoi me një plan të qartë të Sioni, për ta çuar sërish ekipin në pjesëmarrjen në Kupat e Evropës, por kontrata e tij u ndërpre para fundit dhe aventura zgjati vetëm 16 ndeshje. Ndryshe, të Sioni luajnë edhe dy futbollistë të Kombëtares shqiptare, Ermir Lenjani dhe Burim Kukeli, të dy të afruar nga Tramezzani gjatë kësaj merkatoje verore. Fati i tyre mbetet për t'u parë në muajt në vijim. Cekim, Sioni mbetet në vendin e 7 në renditje, me vetëm 13 pikë të grumbulluara, në 12 javë të kampionatit helvet.

KB Shkupi pëson disfatën e tretë me radhë

Shkup, 23 tetor – Ka vazhduar seria e humbjeve e basketbollistëve të KB Shkupi. Në tre xhirot e para, bardhekaltërit pësuan po aq disfata, ndërsa së fundmi humbën nga skuadra e "Blokotehna" me rezultatin e thellë 115:83. Trajneri i ekipit Enver Miftari, pohon se fillimi i ndeshjes ishte shumë i dobët duke e lejuar kundërshtarët të bëjnë diferencën, që në vazhdim ishte vështirësi të rikthehen në lojë. "Kishim ndoshta fillimin më të dobët ku i lejuam



kundërshtarit që në pjesën e parë të krijon një epërsi prej 37:13. Por, në dhjetë minutat e dyta konsoliduam radhët tonë

dhe epërsinë e madhe arritëm ta ulim në dhjetë pikë, ndërsa në pushim të gjatë shkuam me rezultat 53:42. Por, për fat të keq në pjesën e dytë ndodhi e njëjta si në pjesën e parë, ku diferenca vetëm sa shkonte e u thellonte dhe në fund pësuan me rezultatin 83:115, apo 32 pika diferencë. Një fitore me plotë meritë e basketbollistëve të 'Blokotehna', deklaroi Miftari. Ndërkohë, te KB Shkupi më efikas ishte përsëri Haris me 27 pikë të shënuara.

Pas Shqipërisë, Cana nderohet edhe në Francë



Të dielën e 22 tetorit, në orën 21:00, Xhibril Cisse dhe Lorik Cana kanë startuar me goditjen e topit të parë ndeshjen e javës së 10-të të Ligue 1, Olimpik Marseit dhe PSZH. Të dy ish-lojtarët "olympians" kanë shënuar kundër klubit të

kryeqytetit. Në një lidhje të drejtpërdrejtë me emisionin "Zona Gol" në "Super Sport", Lorik Cana foli për emocionet e lamtumirës së futbollit në një ndeshje të veçantë me ish-skuadrën e tij, ku ka qenë edhe kapiten. "Unë kam luajtur për të dyja këto skuadra dhe ruaj kujtime shumë të mira. Kam qenë fillimisht pjesë e PSZH-së, ku fitova Kupën e Francës dhe iu afrova shumë titullit kampion. Edhe te Marsei kam qenë shumë pranë fitimit të kampionatit. Pas lënies së futbollit të luajtur dua të bëhem drejtues i një skuadre të rëndë-

sishme, pse jo edhe te Marsei. Do të ishte diçka e bukur. Po të më jepet mundësia, do ta bëja më kënaqësi. Shembulli më i mirë për ne është Igli Tare, si drejtor sportiv i Lacios. Është njëloj "busulle" për të gjithë futbollistët e kombëtares shqiptare, që dëshirojnë të punojnë në pozicione drejtuese. A do t'i ndjekë djali gjurmët e mia në futboll? Më shumë se me këmbë i pëlqen ta kapë topin me duar. Dëshira ime është të bëhet një tenist profesionist dhe të përfaqësojë Shqipërinë në arenën ndërkombëtare", deklaroi Cana.



“Urime skuadrës për fitoren. Ky vit ka qenë i pabesueshëm. Kemi punuar të gjithë si skuadër dhe jam krenar për këtë. Sidomos për faktin që makina ka pasur shumë ndryshime”, u shpreh pas garës Hamilton

Formula 1 - Hamilton “pushton” Amerikën

Festa e titullit shtyhet për në Meksikë

Luis Hamilton ka fituar Çmimin e Madh të Amerikës duke siguruar titullin e konstruktorëve dhe duke iu afruar akoma më shumë titullit kampion. Në podium bashkë me të janë ngjitur Fettel dhe Raikkonen. Në përfundim të Çmimit të Madh të Amerikës, ku e kaloi i pari vijën e finishit, piloti britanik u shpreh: “Urime skuadrës për fitoren. Ky vit ka qenë i pabesueshëm. Kemi punuar të gjithë si skuadër dhe jam krenar për këtë. Sidomos për faktin që makina ka patur shumë ndryshime”, tha Hamilton. Hamilton e konsideroi një fitore të mrekulueshme suksesin në Austin, por nuk harroi të përgëzonte edhe rivalin e Ferrarit, Vettel, për garën e zhvilluar. “Ishte një garë e madhe, një nga më të mëdhatë. Sebastian e nisi shumë mirë, por unë e dija që mund ta parakaloja. Arrita të ruaja ritmin dhe ta lija pas, janë pikërisht këto momente për të cilat jetoj. Më surprizoi Fettel, sepse u tregua shumë korrekt. Mendoj se ishte një fitore e jashtëzakonshme edhe për të gjithë miqtë e mi që kishin ardhur për të më ndjekur”, deklaroi britaniku. Nga ana tjetër, Fettel e pranoi se e kishte të pamundur të ndalte Hamiltonin dhe kjo ndodhi për problemet e Ferrarit. Gjithsesi, gjermani i “Kokëkuqes” u shpreh i bindur se e ardhmja i përket skuadrës italiane.



Ndërkohë, sa i përket garës, starti ishte spektakolar teksa Fettel arriti të parakalojë kryesuesin Hamilton në kthesën e parë pas një starti ëndërrash. Gjermani merr kryesimin e garës me Hamilton që i qëndron shumë pranë duke regjistruar xhiron më të shpejtë. Si përfundim, në xhiron e gjashtë anglezi

arrin të rimarrë kryesimin e garës. Ndërkohë në pistë bie në sy shpejtësia e Verstappen i cili fiton duel pas dueli duke u futur në zonën e pikëve. Në xhiron e 13-të pas një prekje me Bottas, Rikardo ndalon dy xhiro më pas duke u thënë inxhinierëve se motori ka mbaruar. Fettel futet në bokse në xhiron e 17-të ndërsa Hamilton në

xhiron e 20-të, të dy me goma të buta, ai del nga bokset i treti ndërsa Fettel është direkt pas tij duke pritur mundësinë e tij. Gjermani arrin të regjistrojë xhiron më të shpejtë dhe mundohet ta parakalojë kryesuesin por nuk ia arrin. Pit stopi i dytë për Fettel vjen në xhiron e 35-të, i cili del në pozicionin katërt. Ndërkohë Raikkonen pas shtatë xhiros përpjekje ka parakaluar Bottas në xhiron e 43-të duke dalë i dyti dhe 12 sekonda larg kryesuesit Hamilton. Pas disa xhiros edhe Fettel i afrohet Bottas, Ferrari mund të dalë në podium pasi vendi i parë nuk diskutohet nga Hamilton. Në xhiron e 52-të ndodh skena e garës teksa Fettel ka parakaluar në mënyrë spektakolare Bottas, i cili një xhiro më pas parakalohet edhe nga Verstappen, i cili e prek në kthesë duke detyruar finlandezin të shkojë në bokse. Raikkonen i hap rrugën Fettel pak më pas pasi gjermani akoma ka shpresa të fitojë titullin.



Nadal e ka merituar kryesimin

Rogier Federer do të debutojë nesër në turneun e Bazelit, në turneun e shtëpisë, teksa në raundin e dytë do të luajë ndaj amerikanit Frances Tifoe. “Ndihem mirë fizikisht dhe jam stërvitur mirë. Dua të bëj një paraqitje të mirë në turneun e shtëpisë, para publikut tim. Asnjëherë nuk është e lehtë kur kalon nga një turne në tjetrin, pasi çdo sipërfaqe ka veçoritë e saj. Por nuk jam i lodhur dhe jam gati për këtë sfidë të radhës, ku synoj fitoren”, u shpreh Federer për mediat. Zvicerani ndodhet në vendin e dytë të klasifikimit dhe para tij është vetëm Rafael Nadal, miku e rivali i tij i përjetshëm dhe në rast se do të fitojë në Bazel, do ta ngushtojë në 1,460 pikë diferencën. “Numri 1 në botë nuk është për momentin prioritet për mua, pasi jam larg atij objektivit. Unë synoj të fitoj në Bazel e më pas në Londër, në finale të Çampionship, se çfarë do të ndodhë më pas të shohim. Nadal e ka merituar atë kryesim dhe për mua do të jetë e vështirë ta kaloj”, tha Federer.

NBA

Minnesota fiton në sekondën e fundit



Tri ndeshje të luajtura në NBA, ka spikatur fitorja 115-113 e Minnesota ndaj Oklahomas, ndeshje e vendosur në sekondën e fundit.

Një trepikësh në sekondën e fundit i Viggins i dha fitoren ekipit mik, që korri fitoren e dytë sezonale, duke befasuar vendasit. Të pestë titullarët e Minnesota realizuan mbi 10 pikë, me Viggins dhe Touns që re-

alizuan nga 27 pikë secili, duke i bërë të pavlefshme 32 pikët e 10 asistime të Uestbruk dhe 23 të Entoni. Për Thunder kjo është humbja e parë sezonale, një dështim i papritur. Fiton edhe ekipi i Nju Orleans, që mposhti 119-112 Lejkers në Los Anxhelos, në një ndeshje me rivalitet deri në fund. Ky është sukses i parë sezonal për miqtë, që triumfuan falë

27 pikëve e 17 kërcime të Davis dhe 22 pikëve e 11 kërcime të Kousins, një dyshe që bëri diferencën në parket.

Bruklin mundi 116-104 Atlanta, ndeshje e dominuar nga skuadra vendase, që ishte gjatë gjithë kohës në epërsi, duke triumfuar falë 20 pikëve të Krabbe, që e nisi ndeshjen nga stoli (52 pikë i realizuan lojtarët e stolit).

Publicitet

Në bazë të nenit 289 të Statutit të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” nga Shkupi dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” nga Shkupi (numër 173/2011), Këshilli shkencor i UKIM Instituti për blegtori Shkup ka sjellë Vendim që të publikojë:

KONKURS

Për zgjedhje punëtorit shkencor në të gjitha titujt shkencor

- Një punëtor shkencor në të gjitha titujt shkencorë në sferën shkencore shpendari
- Një punëtor shkencor në të gjitha titujt shkencorë në sferën shkencore ruajtja e dheneve dhe ruajtja e dhive.

Kandidati duhet të përmbushë kushtet e parapara me Ligjin për veprimtari shkencore-hulumtuese (Gazeta Zyrtare e RM nr. 46/08).

Fletëparaqitjet së bashku me dokumentacionin e nevojshëm (Diplomë për arsim të mbaruar sipëror, Diplomë për studime të mbaruara postdiplomike të ciklit të dytë dhe të tretë, biografi të shkurtër, listë të punimeve të publikuara dhe nga një kopje prej tyre), kandidatët duhet ti dorëzojnë deri në Këshillin shkencor të UKIM Instituti për blegtori Shkup në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e publikimit të konkursit në adresë: UKIM Instituti për blegtori, bul. Ilinden 92A, F. P 207, 1000 Shkup.

Drejtor,

Prof. D-r. Rodne Nastova

Tifozi ndërron jetë në tribunë, shtyhet ndeshja e volejbollit

Në kohën që spikeri i ndeshjes do të niste publikimin e emrave të dy skuadrave që do të luanin në një ndeshje volejboli në kampionatin italian të meshkujve mes Civitanova dhe Ravenna, ka ndodhur një dramë në shkallët e stadiumit. Një person 61-vjeçar që në ato momente po ngjiste shkallët për t'u ulur për të parë ndeshjen, është rrëzuar papritur në tokë pa ndjenja. Disa persona shkuan për të ndihmuar dhe më pas edhe stafi mjekësor që ishte në stadium shkoi për t'i dhënë ndihmën e



parë, por e kotë. Gjuseppe Konstantino, 61 vjeç ndërroi jetë në stadium, pak minuta para se të niste ndeshja e volejbollit, duke detyruar organizatorët të mos e zhvillonin takimin.

Publiku dhe lojtarët në fushë përjetuan një dramë të vërtetë dhe nuk ishin më në gjendje të luanin, ndaj dhe u vendos që ajo të shtyhej, në respekt të viktimës.



Kam luajtur në klubet më të mëdha të botës si Real Madridi, Interi dhe Milani. Nëse do të kisha një kokë tjetër do të luaja në Mars. Do të isha si Lione Messi, Neymar dhe disa të tjerë

Ne jemi duke e ndjekur situatën, jemi në kontakt me Federatën dhe me Barcelonën. Natyrisht ekziston mundësia që të marrim kërkesë nga Katalonja një ditë për t'u bërë pjesë e UEFA-s, njëjtë siç e kishim marrë nga Kosova. Ekuacioni është i thjeshtë: ne i njohim vendet që janë të pranuar nga pjesa dërrmuese e vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara", është shprehur numri një i futbollit evropian

Katalonja mund ta ndjekë rrugën e Kosovës për t'u pranuar në të ardhmen në Federatën Evropiane të Futbollit (UEFA) dhe në atë Ndërkombëtare të Futbollit (FIFA). Një mundësi të tillë e ka pranuar edhe presidenti i ri i UEFA-s, Aleksander Čeferin, i cili është shprehur se katalonjasit një ditë mund t'i bashkohen këtij institucioni, i cili do ta përsëriste atë që e ka bërë edhe me Kosovën. "Ne jemi duke e ndjekur situatën, jemi në kontakt me Federatën dhe me Barcelonën. Natyrisht ekziston mundësia që të marrim kërkesë nga Katalonja një ditë për t'u bërë pjesë e UEFA-s, njëjtë siç e kishim marrë nga Kosova. Ekuacioni është i thjeshtë: ne i njohim vendet që janë të pranuar nga pjesa dër-

Katalonja si Kosova



rmuese e vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara", është shprehur numri një i futbollit evropian për të përditshmen sillovene "Veçer". Katalonja së fundmi e ka shprehur vendosmërinë që ta shpallë pavarësinë e saj nga Spanja. Rrjedhimisht kjo krahinë momentale e Spanjës do ta ketë edhe përfaqësue-

sen e saj zyrtare dhe do ta kërkojë pranimin në të gjitha instancat e futbollit në UEFA e në FIFA për ta pasur mundësinë që të luajë me Përfaqësuesen dhe klubet e saj në Evropë. Dilemë është nëse Barcelona, gjigant evropian, do të vazhdojë të luajë apo jo në ligën spanjolle - La Liga. Gjithsesi, UEFA

dhe FIFA shprehen të brengosura me atë që po ndodh në Spanjë pas kërkesës së Katalonjës për ndarje nga ky shtet dhe dy institucionet më të larta të futbollit botëror e presin një përsëritje të skenarit të Kosovës, së cilës megjithatë i është stërzgjiatur rruga deri tek pranimi në UEFA e në FIFA.



Ibra do të punojë për mua!

Mino Raiola-Zlatan Ibrahimović, një marrëdhënie e qëndrueshme prej shumë vitesh, nga e cila kanë përfituar shumë të dy. Kushedi së çfarë do të ketë menduar gjiganti suedez i Mançeser Junajted nga batutat e menaxherit të tij italian, që, mes shakasë dhe seriozes, u shpreh: "Duhet të luajë akoma për 5 ose 6 vjet. Nuk do ta lë të heqë dorë kaq shpejt, kam punuar me të për shumë vjet tani është radha e tij të punojë për mua. Fëmijët e mi janë rritur dhe kanë nevojë për para. Kemi rëndë dakord që për 5 vitet e ardhshme të punojë vetëm për mua", u shpreh Raiola. Por çfarë do të ndodhë me Zlatanin kur të heqë dorë nga futbollit? "Do të jetë gjithmonë në jetën time, si futbollist, sipërmarrës, drejtues sportiv ose trajner, nuk ka rëndësi. Shpresoj që një ditë të bëhet trajner, sepse jam kurioz të shoh futbollistët tek i thonë Zlatanit që nuk e kuptojnë se për çfarë po flet. Do të doja të kisha një telekamera të fshehtë për të parë reagimin e tij kur ndonjë lojtar t'i thotë se është më i mirë se ai", deklaroi Raiola. Raiola theksoi edhe një herë se futbollit italian mbetet 50 vite, pas sidomos për shkak të diskriminimit të lojtarëve me ngjyrë.

Mund të isha bërë si Messi

Antonio Cassano beson se do të mund të ishte bërë si ylli i Barcelonës, Lionel Messi, por thotë se e shkatërroi vetveten. Sulmuesi nuk është teknikisht i pensionuar, por nuk ka luajtur për pothuajse një vit pas një periudhe të shkurtër te Hellas Verona, pres së cilës u largua gjatë verës. "Jam një djalë problematik sepse kurrë nuk e di se me çfarë humori do të zgjohem në mëngjes", u shpreh ish-reprezentuesi italian. "Mund të kisha luajtur në një planet tjetër, por kisha një problem që nuk i doja stërvitjet dhe doja të



haja siç doja unë dhe e shkatërrova veten", shtoi ai. "Kam luajtur në klubet më të mëdha të botës si Real Madridi, Interi dhe Milani. Nëse do të kisha një kokë tjetër do të luaja në Mars. Do të isha si Lione Messi, Neymar dhe disa të tjerë", deklaroi Kasano.

Valencia planifikon transferimin e talentit të Valencias



Mançeser Junajted është rreshtuar për një lëvizje befasese të janarit për mesfushorin e talentuar të Valencias, spanjollin Karlos Soler. Trajneri Hoze Murinjo është i etur për ta përfunduar skuadrën e tij për vazhdimin e kampionatit, por edhe garave evropiane pasi është në rrugë të mirë në këtë fillim

sezoni. Pasi kanë dështuar gjatë verës për të transferuar yllin kroat të Interit, Ivan Perishiç, "Djajtë e Kuq" kanë kthyer shikimin dika tjetër. Sipas tabloidit britanik "Daily Mail", Junajted po përpjetë përfundojë një marrëveshje me talentin e Valencias, Soler. "Djajtë e Kuq" po mendojnë të ofrojnë 30 milionë

funte për reprezentuesin e Spanjës U-21 dhe ta përfundojnë marrëveshjen përpara se të hapet dritarja e transferimit të verës. Junajtedi ka nisur bisedimet me klubin e Solerit, Valencian, me të cilin skuadra nga La Liga nuk ka gjasa të mbajë klauzolën e largimit të lojtarit prej 75 milionë funtesh për shkak të çështjeve financiare. Pas një sërë transferimesh zhgënjyese pas largimit të Sir Aleks Ferguson, Junajted beson se aftësia e tyre për të përfunduar transferimet e Romelu Lukaku dhe Nemanja Matić në korrik ka ndihmuar fillimin e tyre mbresëlënës në sezonin aktual. Skuadra nga "Old Trafford" janë të etur të bëjnë biznesin e tyre herët edhe për Solerit dhe t'ju tregojnë kundërshtarëve që do të jetë rival serioz në çdo garë.

Shkurt

Evertoni shkarkon trajnerin Kuman

Trajneri i Evertonit, Ronald Kuman është shkarkuar nga posti i trajnerit. Klubi nga qyteti i Liverpulit, Everton, e ka marrë një vendim drastik. Lajmi është konfirmuar nga faqja zyrtare e Evertonit. Kuman u shkarkua pas humbjes 5:2 ndaj Arsenalit në shtëpi. Kjo ishte ndeshja e fundit ku Kuman mund të ruante postin e tij të trajnerit. Klubi do të njoftojë së shpejti për emrin e trajnerit të ri. Ndryshe, Evertoni ka bërë një nisje katastrofale të kampionatit. Skuadra "e kaltër" radhitet në fund të klasifikimit në Premier ligë. Momentalisht Evertoni është në pozitën e 18 me 8 pikë, duke rrezikuar edhe rënien. Jozyrtarisht thuhet se Dejvid Mojs mund të rikthehet në krye të skuadrës së Evertonit, pasi ai e një mirë ambientin për faktin se e ka drejtuar Evertonin gjatë viteve 2002-2013.

Gabi edhe një sezon te Atletiko

Pjesë e Atletiko Madrid që nga vitit 2011, Gabriel Fernandez Arenas, i njohur ndryshe si Gabi, do të vazhdojë të qëndrojë te "Los Colchoneros" të paktën edhe për një sezon tjetër. Kontrata aktuale e 34-vjeçarit skadon në 2018-ën, por sipas mediave spanjolle, kapiteni ka arritur marrëveshjen me drejtuesit e klubit dhe pritet të firmosë deri në qershor të vitit 2019. Zyrtarizimi i kontratës së re me shumë mundësi të bëhet gjatë javës në vazhdim. Gabi është një futbollist i rritur në akademinë e Atletikos, por u shkëput për 5 sezone nga "bardhekuqtë" duke u huazuar fillimisht te Getafe dhe transferuar me pas në 2007-ën te Zaragoza. Prej më shumë se 7 sezonesh është shndërruar lojtar shumë i rëndësishëm për "Los Colchoneros", ku dëshiron të mbyllë karrierën.

Bonuçi humbe sfidën ndaj Juventusit?

Vazhdon momenti jo për Leonardo Bonučin që nga periudha që është bërë pjesë e Milanit. Goditja me bërryl që i dha kundërshtarit të tij Rosi në sfidën ndaj Xhenoas do t'i kushtojë rëndë mbrojtësit të kombëtares italiane i cili sipas të gjitha gjasave do të humbasë duelin e fundjavës së ardhshme ndaj ish skuadrës së tij Juventusit. Seria A do të zhvillojë javën e 10-të në mesjavë dhe fundjavën e ardhshme është në program raundi i 11-të që sjell në skenë superpërballjen Milan-Juventus. Por për Bonučin nuk do të ketë një përballje si ish pasi gjykatësi sportiv për gjestin ndaj Rossit do ta skualifikojë minimalisht me dy ndeshje 30-vjeçarin.

Ançeloti drejt një kthimi të bujshëm

Nga Anglia ka ardhur një lajm që mund të përmbysë të gjithë skenarët e futbollit evropian. Sipas të përditshmes "Daily Express", Karlo Ançeloti është kandidati numër një për të marrë vendin e Antonio Konte në drejtim të Çellsit, nëse ish-trajneri i Italisë do të largohet nga drejtuesit e klubit londinez. Për Ançelotin do të bëhej fjalë për një kthim, duke parë se i ka drejtuar "Blutë" drejt "Double" (kampionat dhe Kupën e Anglisë) në sezonin 2009/10. Ndërkohë, nga Italia mësohet se Milani është interesuar përsëri për të kuptuar nëse Konte ka dëshirë të kthehet në kampionatin italian.



Milani ka kontaktuar me trajnerin e Çellsit, Antonio Conte, raportojnë mediat italiane. Kërret e 'Rossonerëve' publikisht i kanë dhënë mbështetje Vincenzo Montellas, megjithatë, Conte vazhdon të jetë i lidhur emërimin në krye te gjigantit italian

Kin tejkalon Ronaldon



Kin ka shënuar 86 gola në 125 ndeshje në Premier Ligë, që nga debutimi i tij në vitin 2014, ndërsa Ronaldo e mbylli eksperiencën e vet në "Old Trafford" me 84 gola në 196 ndeshjet e luajtura me "Djajtë e Kuq" (2003-2009)



Mbappe, fituesi i "Golden Boy 2017"

Gjërat duket se kanë marrë vetëm më mirë për adoleshentin francez. Sulmuesi 18-vjeçar i PSZH është bërë marrësi i fundit i çmimit prestigjioz "Golden Boy", i dhuruar çdo vit për lojtarin më të rëndësishëm në futbollin botëror. Fituesit e mëparshëm të "Golden Boy" përfshijnë Lionel Messi, Uejn Runi, Pol Pogba, Isko, Sergio Aguero, Anderson etj. Mbappe ishte në listën e tre kandidatëve finalistë, së bashku me sulmuesin brazilian të Manchester Siti, Gabriel Jesus, dhe atë të Barcelonës, djaloshin e ri, Ousmane Dembele, por, sipas edicionit të sotëm të "TuttoSport", talenti francez e ka fituar çmimin. Kylian Mbappe shënoi 26 gola në 44 paraqitje për Monakon, sezonin e kaluar, në rrugën për fitimin e titullit kampion të Ligue 1. Ai pastaj u bashkua me PSG-në për një lëvizje të gjatë huazimi gjatë këtij sezoni, por janë të gjitha gjasat që të bëhet i përhershëm në fund të sezonit 2017-2018 për afërsisht 160 milionë euro. Adoloshenti ka shënuar katër herë në tetë ndeshje për parisienët deri më tani.

BRAJANT DHE MARADONA, DY TIFOZËT E RINJ TË TOTENHEMIT

Dy fytyra të famshme kanë qenë të pranishme në fitoren 4-1 të Totenhemit ndaj Liverpulit në "Wembley". Legjenda argentinase Diego Armando Maradona dhe ish-ylli i NBA Kobi Brajant janë kënaqur nga paraqitja e paskrupullt e të besuarve të Poketinos ndaj të Kuqve. Sulmuesi i Anglisë Harry Kin shënoi dy gola pas një bisede që pati me Maradonan në prag të sfidës dhe më pas i dhuroi Brajant fanellën e tij teksta legjenda e Los Angeles Lejkers u takua me lojtarët pas ndeshjes. Maradona është prezantuar për publikun gjatë pushimit të pjesës së parë dhe kishte një fanellë të personalizuar që ka kënaqur së tepërmi tifozët e Totenhemit.



Çdo ndeshje që konkurron, Harry Kin i rrit numrat e tij dhe ulet në mesin e skenarëve të mëdhenj botërorë. "Është e mahnitshme për t'i kënaqur tifozët, ne mund të kishim shënuar më shumë gola", - tha sulmuesi anglez pas fitores (4-1) të Totenhemit kundër Liverpulit, ndeshje në të cilën ai ka

nënshkruar një dopietë. Dy gola, me të cilat ai tejkalon Kristiano Ronaldon në Premier Ligë. "Kristiano është një prej lojtarëve më të mirë. Kin, gjithashtu. Ai është i ri dhe vazhdimisht kërkon të përmirësohet", - tha trajneri Mauricio Poketino. Në Premier Ligë, sulmuesi i Totenhemit e ka

tejkualuar tashmë lojtarin e Real Madridit. Kin ka shënuar 86 gola në 125 ndeshje në Premier Ligë, që nga debutimi i tij në vitin 2014, ndërsa Ronaldo e mbylli eksperiencën e vet në "Old Trafford" me 84 gola në 196 ndeshjet e luajtura me "Djajtë e Kuq" (2003-2009). Në moshën 24-vjeçare, sul-



Immobile: Për titullin e lehtë të ëndërrorjme

Çiro Immobile u shfaq edhe një herë vendimtar për Lacion, duke shënuar dy herë në fitoren 3-0 ndaj Kaljarit. Vetëm 24 orë para këtij takimi, drejtuesit "bardheklatër" zyrtarizuan rinovimin e kontratës së tij deri në vitin 2022. "Unë përjetë te Lacio? Jam krenar që do ta mbaj veshur këtë uniformë deri në vitin 2022", u shpreh Immobile. Më pas, sulmuesi italian foli për ecurinë pozitive të Lacios, që vijoi me suksesin ndaj Kaljarit. "Ishte shumë e rëndësishme që të merrnim fitoren e radhës. Duhet të falënderoj shokët e skuadrës për asistimet, por edhe publikun e mrekullueshëm, që më shtyn të bëj më të mirën për këtë skuadër. Titulli? Është e lehtë të ëndërrorsh. Duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë, për të marrë atë që mundemi", deklaroi Immobile. Një tjetër lajm pozitiv te Lacio ka të bëjë me rinovimin e kontratës së Stefan de Vrij. Mbrojtësi holandez deklaroi se dëshira e tij është të vijojë karrierën te skuadra kryeqytetase, por në futboll nuk i dihet kurrë.

Kartoni i kuq ishte i ekzagjeruar

Ylli i PSZH-së, Neymar, ndjen se kartoni i kuq kundër tij, në ndeshjen e mbrëmshme ndaj Olimpik Marsej, ishte e ekzagjeruar, duke thënë se ai kishte shenja të shumta në trupin e tij për të treguar se çfarë kishte hequr në këtë "Le Classique". Sulmuesi nga Brazili u dërgua në minutën e 87-të të barazimit 2-2 të së dielës jashtë fushe me kartonin e dytë të verdhë, pas përplasjes me Lukas Okamos. Neymar ishte shkelur pesë herë, më shumë se çdo lojtar tjetër, gjatë ndeshjes, në të cilën PSG mori një pikë nga goditja e lirë e Edinson Kavani. 25-vjeçari i pakënaqur me nxjerrjen e tij jashtë loje me karton të kuq, duke kritikuar gjyqtarin Ruddy Buquet. "Unë mendoj se ishte e ekzagjeruar, por dhe e padrejtë. E kalova gjithë ndeshjen duke u goditur, kam shumë shenja në trupin tim, - tha Neymar për "Esporte Interativo". - Ishte një lëvizje që u përpoqa ta vazh-



doja pas një vuajtjeje të keqe. Isha i mërzitur nga goditja nga prapa. Arbitri bëri atë që donte, ndërsa me vendimet e tij nuk më mori në mbrojtje gjatë lojës së ashpër të kundër-

shtarit ndaj meje". PSG është katër pikë të qarta në krye të Ligue 1, pas barazimit në "Velodrome", me Neymarin që do të humbasë përplasjen e së premtes, kundër Nica.

Myler do të mungojë pesë deri në gjashtë javë



Tomas Myler alarmon Bajerin! Nëse në fillim dëmtimi i tij u raportua si diçka e thjeshtë, situata ka ndryshuar me lajmet e mbrëmjes së të dielës. "Sport Bild" raporton se mesfushori do të mungojë për 5-6 javë pas goditjes që mori në kofshë të shtunën në Hamburg. Lojtari i cili i gëzohet këtij lajmi është Hames Rodriguez. Ai i cili vendosi me çdo kusht afrimin e tij në "Al-

lianzen Arena" ishte trajneri Karlo Ançeloti, por italiani është shkarkuar dhe kapiteni i Kolumbisë duket sikur "ka ngelur thatë". Me sistemin 4-2-3-1, Hames do të fitojë shansin duke formuar një treshe ofensive me anësorët Arjen Robben dhe Kingsley Komán. Sigurisht, ai duhet ta meritojë vendin në 11-sh, sepse trajneri Jup Hejnkes nuk bën ndere, por vlerëson formën e lojtarëve.

DASHI (20/III-20/IV)



Dashuria do t'iu paraqes pikë të ndritshme, por në një situatë të tensionuar as qetësia emocionale nuk do të ndihmojë që të përmbaheni nga reagimi i pakontrolluar. Do t'iu godet shumë sëmundja e një familjari apo keqkuptimi nga ana e një miku.

DEMI (21/IV-20/V)



Ndryshimet e mira në jetën e dashurisë do t'ua kthejnë paqen e brendshme. Shumë më lehtë do të barteni me sfidat e jetës dhe problemet. Do të dalloheni me kujtesë të mirë, duar të shpjeta dhe gjithëanshmëri andaj njëkohësisht do të arrini t'i kryeni disa punë.

BINJAKËT (21/V-20/VI)



Nëse po kërkon punë të re, është mirë të hidheni në aksion sa më shpejtë. Mos sillni vendime të shpjeta dhe të pamenduara, por nëse intuita iu flet diçka, ndoshta do të duhej ta dëgjoni. Vetëbesimi dhe kthjelltësia juaj do të jenë magnet për persona me mendime të ngjashme.

GAFORRIA (21/VI-22/VII)



Do t'iu ofrohet rasti që të shtoni përfitimet, por s'do të jeni të sigurt se a do ta pranoni sepse do t'iu dukej pak e pasigurt. Nëse del ndonjë problem me familjar, mos bëni panik, por përpiqni që sa më qetë t'i haseni zgjidhjes.

LUANI (23/VII-22/VIII)



Dëshirën për sukses dhe dallim nuk do fshihni, por meqë potencialet krijuese do të jenë të theksuara, këtë s'do t'ua zë për të madhe askush. Në jetën private mund të ndodhin keqkuptimet shkaku i ikjes së përgjegjësive nga disa obligime familjare.

VIRGJËRESHA (23/VIII-22/IX)



Do të dalloheni me qetësi, tolerancë dhe gatishmëri për këmbim idesh andaj në rrethin e punës do të hasni në përkrahje të pandarë. Kurrsesi mos e anuloni udhëtimin e planifikuar, takimin apo provimin sepse ka gjasë të mëdha që të jeni të kënaqur me rezultate.

PESHORJA (23/IX-22/X)



Në aspektin emocional do të keni më pak siguri dhe optimizëm. Heshnja e partnerit dhe distanca do t'iu luhat me qëllim që të bisedoni për problemet që ditëve të fundit po e prishin lidhjen tuaj. Shumë brengë do t'iu japin edhe prindërit, sidomos nëna.

AKREPI (22/X-21/XII)



Do t'iu përmbaheni qëndrimeve tuaja. Nëse një dalje e mbrëmjes do t'iu sjell dëshpërim, do të shkoni shpejtë pavarësisht nga pakënaqësia e partnerit tuaj apo miqve. Por për të arritur kënaqësinë e dëshiruar në dashuri, duhet të përshtateni pak.

SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Do të merreni me çështje financiare. Do t'iu duhej të paguani shumë fatura që rastësisht i keni parashkuar, dënimet apo shpenzime gjyqësore. Përmbajuni vetëkontrollit dhe mos lejoni që t'iu qesin nga takti personat të cilët kanë pak apo fare rëndësi për ju.

BRICJAPI (22/XII-20/I)



Në obligimet e punës do të qaseni me shumë vëmendje dhe kujdes. Por nëse keni punë më bashkëpunëtorë me të cilët nuk pajtoheni, mund të ndodhin edhe lëshimet e caktuara. Duhet të jeni aktiv fizikisht, t'i ikni alkoolit dhe shumë kafe.

UJORI (20/I-19/II)



Në momentin e fundit shefat tuaj do ta ndërrojnë orarin, duke iu lënë shumë pak kohë që të përshtateni. Ndonëse do të përpiqeni që ta qetësoni hidhërimin, do të jetë e qartë se mezi po përmbaheni. Imuniteti është në rënie andaj ikni nga personat e sëmurë.

PESHQIT (20/II-19/III)



Mund të keni probleme shkaku i prishjes së kushteve të punës, paralajmërimet për uljen e pagës apo paaftësisë së disa bashkëpunëtorëve. Rrethi harmonik familjar do të ndikojë në optimizmin dhe vetëbesimin tuaj andaj në shtëpinë tuaj mos hapni tema që mund të iniciojnë grindje.



Mensur Mamuti	AKTORJA SHQIPTARO-AMERIKANE NË FOTO	KËNGËTARJA OKSA	FILM ME AKTOREN NË FOTO (THE LAST VAMPIRE)	VENDOSJA NË NJË VEND TË HUAJ PËR TË JETUAR
KALTËR				
EMRI I VJETËR I VIETNAMIT				
NJËRI NGA FRASHËRIT				
IMPULSI		PASKUALINA GRUDA QENGJ I BUTË		
PRIJËS I EMIRATIT				
TË QENËT LARA-LARA, LARMI				
MBAJTJA E NJË ANE				

KOHA	LUMË NË AMERIKËN JUGORE	KRYEQYTETI I MAROKUT	IRIDIUMI	LLOJ KAFSHE UJORE	QË PESHON ME OKE	QYTET NË ÇAD	QË U PËRKET ARIANEVE
ISH TRAJNERI ITALIAN, SAKI						QYTET NË TURQI AUTORJA AMERIKANE, JONG	
QYTET NË MAROK							UNIONI REPUBLIKAN GJIMNASTJA RUMUNE, BAN
SHKRONJAT E PARA			MBRETI NË EGJIPTIN E LASHTË GIGA-OKTET				
ZONË NË RRETHIN E GJIROKASTRES (PASHQ)							UJDHESË (TURQ) INDIUMI
I VOGLI I BUJALLICËS					PLUHUR QË NXIRRET NGA LËVORJA E DRURIT TË KINËS METRI		
NIKELI			SUBSTANCAT E FITUARA NGA EMANACIONI				

ZGJIDHJET: MAVI, ANAM, SAMI, I PG, EMIR, LARI, ANIM, LAI, ARIGO, URF, MARAKESH, UR, AB, FARAONI, ZAGORI, ADA, KOTORR, KININ, NI, EMANATE.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

	7	5			1		8	7		2			
3	9			8	7	5		6		2		8	
	6			3		4		3	4		1		
	8					7				6			
			7					9	3	5	8		
7	5				3	2	6	7		2		4	5
	4		8			9		4	5		8	2	
1		5	9			4				9			6
	9				1	5		8			5		3

Shumë i lehtë: 478592316, 319648725, 562713849, 286359174, 931274568, 754186932, 647835291, 125967483, 893421657. Mesatar: 847513296, 561792438, 239486157, 352864971, 194375682, 6781229345, 415638729, 723951864, 986247513.



Cila është marka e makinave më e shitur në botë?

Cila është marka e makinave më e shitur në botë? Është gjermane. Bëhet fjalë për Volkswagen. Pavarësisht skandalit të lëshimeve në atmosferë, që në vitin 2015 përfshiu gjigandët gjermanë, kompania e Volksburgut ka shitur 10 milionë e 312 mijë modele në vitin 2016. Në vend të dytë është Toyota, me 100 mijë makina më pak të shitura. Të dyja markat kanë regjistruar



një rritje të shitjeve në krahasim me vitin paraardhës. Cila është makina më e shitur? Është Corolla e Toyotas, me më shumë se 1 milionë vetura të shitura në gjithë botën. Në vendin e dytë është Ford F-Series dhe në vendin e tretë Volkswagen Golf. Në klasifikimin e Top 100, ndër makinat italiane është vetëm Fiat 500, në vendin e fundit me 205 mijë makina të shitura.

KALENDARI HISTORIK 24 TETOR

1492 - 24 hebrenj digjen në turmë drush në Mecklenburg të Gjermanisë.
1648 - Njihet pavarësia e Zvicrës.
1656 - Traktati i Vilniusit: Rusia dhe Polonia nënshkruajnë marrëveshje kundër Suedisë.
1851 - William Lassell zbulon Ariel dhe Umbriel, satelitët e Uranit.
1931 - Gangsteri Al Capone dënohet me 11 vjet burg për fshehje të tatimeve.
1935 - Italia pushton Etiopinë.
1946 - Holanda dhe Indonezia nënshkruajnë armëpushim.



1973 - John Lennon paditë qeverinë amerikane se FBI përgjon telefonin e tij.
1984 - Steffi Graf luan lojën e saj të parë si profesioniste.
2003 - Concorde bën fluturimin e tij të fundit komercial.

A E DINI SE... ?

Në Izrael të gjithë njerëzit janë të barabartë. Besimi i tyre në Zot, zhvillimi i shkencës dhe teknologjisë, tregon qartë lidhjet e forta midis tyre. Në bankat vendore dhe ato komerciale, kreditë që marrin populli vendas, nuk ekzistojnë as edhe një përqindje e vogël e kamatës. Ndërsa për një individ që është jo hebre, kamatat janë më të larta se 10%.



Nëse dhembjet e shpinës dhe shpatullave, vendet ku ndjehet dhembja, i lyejmë me mjaltë e mbi të vëmë biber pluhur, të shtypur, dhembjet menjëherë largohet. Nëse sasi e caktuar e mjaltit përzihet me vishnje dhe shpërlahet fyti disa here në ditë era e keqe nga goja menjëherë do të largohet.



BARSOLETA



BIONDJA DHE PLAKA

Biondja e ulur në autobus kur i afrohet një plakë, e cila po qëndronte në këmbë dhe e pyet:
- Oj vajzë e mirë a mund t'i ndërrojmë vendet?
- Çka, unë të bëhem plakë a? - i përgjigjet biondja.

THËNIA E DITËS

Ajo që dimë është një pikë. Ajo që injorojmë është një oqean.
(Isak Njuton)



A quhen më xhinse?!

Është mjaft e vështirë për disenjuesit që të ndërhyjnë në modellet e xhinseve, por një japonez ka shkruar më tej se sa një ndërhyrje të thjeshtë. Një palë "xhinse" janë prezantuar në Javën e Modës në Tokio, me thujtë të gjithë pjesët e xhinseve të prera duke lënë fare pak materiale, sa për të mbuluar pak pjesë të trupit. Një palë xhinse për të cilat do të duhej shumë guxim për të dalë në rrugë me to veshur.



Ja pse fëmijët nuk i duan perimet

Shumica prej prindërve, i kanë parë fëmijët e tyre tek tundin kokën kur u duhet të hanë brokoli ose lakër. Mirëpo, çuditërisht të paktën 1 në 5 fëmijë që janë 2 vjeçar kurrë nuk i kanë provuar perimet, thotë një studim i ri. Studimi ka konkluduar se disa prindër janë lodhur aq shumë me betejën e përditshme për t'i ushqyer fëmijët me perime, sa që kanë ndaluar



së provuari. Si rezultat i kësaj, del se më shumë se 30,000 fëmijë në Britaninë e Madhe nuk hanë

perime. Studimi thotë se nëse ky problem i fëmijëve është i përkohshëm, nuk ka ndonjë dëm nga kjo punë.

Mirëpo, nëse refuzimi i tyre për të ngrënë kalcium, proteina, vitamina e minerale, mund të ketë rrezik që ai fëmijë të mos zhvillohet. Mungesa e kalciumit, që ndodhet në qumësht dhe perime të gjelbra, mund të pengojë zhvillimin dhe forcimin e eshtrave.